



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.66

14 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 125
datë 11.5.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave, Alpha Bank A.E. E Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si rregullues, institucioneve financiare, të listuara si huadhënësit fillestarë dhe Alpha Bank A.E., dega e Londrës, si agjent, për financimin e shpenzimeve kapitale për vitin 2009, në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë”

2941

LIGJ
Nr.10 125, datë 11.5.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE, QË VEPRON NËPËRMJET MINISTRIT TË FINANCIVE, ALPHA BANK A.E. E DEUTSCHE BANK AG, DEGA E LONDRËS, SI RREGULLUES, INSTITUCIONEVE FINANCIARE, TË LISTUARA SI HUADHËNËSIT FILLESTARË DHE ALPHA BANK A.E., DEGA E LONDRËS, SI AGJENT, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE KAPITALE PËR VITIN 2009, NË PËRPUTHJE ME STRATEGJINË KOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN DHE INTEGRIMIN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që vepron nëpërmjet Ministrit të Financave, Alpha Bank A.E. e Deutsche Bank A.G., dega e Londrës, si rregullues, institucioneve financiare, të listuara si huadhënësit fillestarë dhe Alpha Bank A.E., dega e Londrës, si agjent, për financimin e shpenzimeve kapitale për vitin 2009, në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.6166, datë 13.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE HUAJE

Kjo Marrëveshje e datës [●] 2009 dhe e lidhur ndërmjet

- 1) Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave), si Huamarrës (“Huamarrësi”);
- 2) ALPHA BANK A.E. dhe DEUTSCHE BANK AG, LONDON BRANCH si rregullues kryesorë të mandatuar (qoftë nëse vepronë individualisht ose bashkërisht të referuar si “Rregulluesi”);
- 3) INSTITUCIONEVE FINANCIARE të renditura në Programin 1 (Huadhënësit Fillestarë) si huadhënës (Huadhënësit Fillestarë); dhe
- 4) Alpha Bank A.E. Dega e Londrës si Agjente e Palëve të tjera Financuese (Agjenti).

Bihet dakord si më poshtë:

SEKSIONI 1 INTERPRETIMI

1. Përkufizimet dhe Interpretimi

1.1 Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje:

Norma e Kostove Shtesë ka kuptimin që i është dhënë në Programin 4 (Formula e Kostos së Detyrueshme).

Filial nënkupton, në lidhje me një person, një Ndhmës të atij personi ose Kompani Aksionere të atij personi ose ndonjë Ndhmës tjetër të asaj Kompanie Aksionere.

Autorizim nënkupton një autorizim, miratim, aprovim, rezolutë, liçencë, përjashtim, depozitim, noterizim ose regjistrim.

Periudha e Disponueshmërisë nënkupton

a) në lidhje me Shërbimin A, periudhën nga dhe përfshirë datën e kësaj Marrëveshjeje dhe përfshirë datën që bie dyzet e pesë (45) ditë më pas; dhe

b) në lidhje me Shërbimin B, periudhën nga dhe përfshirë Datën e Detyrimit Financiar të Shërbimit B deri dhe duke përfshirë datën që bie pesëmbëdhjetë (15) ditë më pas.

Detyrim financiar i Disponueshëm nënkupton në lidhje me një Shërbim Detyrimin Financiar të një Huadhënësi sipas atij Shërbimi minus:

a) Shumën e kontributit të tij në një Hua të papaguar sipas atij Shërbimi; dhe

b) Në lidhje me ndonjë Shfrytëzim të propozuar, shumën e kontributit të tij në Hua që janë të kërkueshme për t'u dhënë sipas atij Shërbimi në ose para Datës së propozuar të Shfrytëzimit.

Shërbim i Disponueshëm nënkupton në lidhje me një Shërbim shumën e përgjithshme për kohën në vazhdim të Detyrimit Financiar të Disponueshëm të çdo Huadhënësi në lidhje me atë Shërbim.

Shpenzimet për Shlyerjen e Parakohshme nënkuptojnë shumën (nëse ka) nga e cila:

a) Interesi që një Huadhënës duhet të ketë marrë për periudhën nga data e marrjes së të gjithë ose një pjese të kontributit të tij në një Hua ose Shumë të Papaguar deri në ditën e fundit të Periudhës aktuale të Interesit në lidhje me atë Hua ose Shumë të Papaguar, që kishte shumën principale ose Shumën e Papaguar të marrë të paguar në ditën e fundit të asaj Periudhe Interesi;

tejkalon:

b) Shumën që ai Huadhënës do të ishte i aftë të merrte duke vendosur një shumë të barabartë me shumën principale ose Shumën e Papaguar të marrë nga ai në depozitë me një bankë kryesore në Tregun Ndërbankar Përkatës për një periudhë që fillon në Ditën e Punës pas marrjes ose kthimit dhe që përfundon në ditën e fundit të Periudhës aktuale të Interesit.

Huamarrës është Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të Financave);

Ditë Pune është një ditë (përveç të shtunës dhe të dielës) në të cilën bankat janë të hapura për punë në Londër (dhe Tiranë) dhe që është ditë TARGET

Detyrim Financiar nënkupton: një Detyrim Financiar të Shërbimit A ose një Detyrim Financiar të Shërbimit B

Këshilli i Ministrave është “organi më i lartë ekzekutiv i Shtetit” që përmendet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr 9000, datë 13 janar 2003 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;

Mosplotësim i Detyrimeve është çdo Ngjarje e Mosplotësimit të Detyrimeve ose çdo ngjarje ose rrethanë e specifikuar në Klauzolën 20 (Ngjarje të Mosplotësimit të Detyrimeve) që, me dhënien e një njoftimi dhe/ose kalimit të afatit përkatës dhe/ose përbushjen e një kushti tjetër sipas Dokumentave të Financimit ose ndonjë kombinim të elementëve të mësipërm do të përbënin një Ngjarje të Mosplotësimit të Detyrimeve;

Ngjarje Ndërhyrëse nënkupton secilën ose të dyja sa më poshtë:

a) Një ndërhyrje materiale ndaj atyre pagesave ose sistemeve të komunikimit ose atyre tregjeve financiare që, në çdo rast, kërkohen të operojnë me qëllim që pagesat të bëhen në lidhje me Shërbimet (ose ndryshe, me qëllim që të kryhet tranzaksioni i parashikuar nga Dokumentat e Financimit) mosfunksionimi i të cilit nuk është shkaktuar nga dhe është përtej kontrollit të ndonjë prej Palëve; ose

b) Ndodhja e ndonjë ngjarjeje tjeër që çon në avari (të një natyre teknike ose në lidhje me sistemet) në operacionet e thesarit ose pagesave të një Pale duke e penguar atë ose ndonjë Palë tjetër:

i) Të përbushin detyrimet e tyre të pagesës sipas Dokumentave të Financimit; ose

ii) Të komunikojnë me Palët e tjera, në përputhje me kushtet e Dokumentave të Financimit,

Dhe që (në secilin prej këtyre rasteve) nuk shkaktohet nga dhe është përtej kontrollit të Palës operacionet e të cilës janë ndërprerë.

EURIBOR” nënkupton, në lidhje me Huanë:

a) Normën Zyrtare të zbatuar, ose

b) nëse nuk ka Normë Zyrtare për periudhën e interesit të asaj Huaje), mesataren aritmetike të normave (të rumbullakosura deri në katër pjesë dhjetore për lart) që i jepet Agjentit me kërkesë të tij, të kuotuar nga Bankat e Referencës për bankat kryesore në tregun ndër-bankar European,

Që nga Koha e Specifikuar në Ditën e Kuotimit për ofrimin e depozitës në Euro për një periudhë të krahasueshme me Periudhën e Interesit të Huasë përkatëse.

euro, eurot dhe €nënkuptojnë monedhën e vetme të Shteteve Anëtare Pjesëmarrëse dhe në lidhje me të gjitha pagesat që duhet të bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje në euro, nënkuptojnë fonde të vëna menjëherë në dispozicion, lirisht të transferueshme.

Ngjarje e Mosplotësimit të Detyrimeve është një prej ngjarjeve ose rrethanave të parashtruara në klauzolën 20 (Ngjarjet e Mosplotësimit të Detyrimeve).

Data e Maturimit të Shtyrë nënkupton kur Huamarrësi ushtron opsionin e shtyrjes sipas Klauzolës 0 (Opsioni i Shtyrjes), datën që bie njëzet e katër (24) muaj pas Datës së Maturimit.

Kërkesa për Shtyrje nënkupton një njoftim kryesisht në formën e përcaktuar në Pjesën 2 të Programit 1 (Kërkesa për Shtyrje).

Njoftimi për Përgjigjen për Shtyrje nënkupton një njoftim në formën e përcaktuar në Pjesën 3 të Programit 1 (Njoftim i Përgjigjes për Shtyrje).

Qenia në Borxh të Jashtëm” janë Para të marra Hua që (a) caktohen ose paguhën sipas opsionit të debitorit ose kreditorit në një monedhë të ndryshme nga leku shqiptar ose (b) që i janë marrë hua një personi që nuk është rezident, ose zyra kryesore hua-dhënëse e të cilit ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë

Shërbim nënkupton Shërbimin A ose Shërbimin B.

Shërbimi A nënkupton shërbimin e huasë me afat të vënë në dispozicion sipas kësaj Marrëveshjeje, siç përshkruhet në Klauzolën 2 (Shërbimet).

Detyrim Financiar i Shërbimit A nënkupton:

a) në lidhje me një Huadhënës Fillestar, shumën e caktuar kundrejt emrit të tij sipas titullit “ Detyrimi Financiar i Shërbimit A” në Programin 1 (Huadhënësit Fillestarë) dhe shumën e ndonjë Detyrimit tjetër Financiar të Shërbimit A të transferuar atij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) në lidhje me ndonjë Huadhënës tjetër, shumën e ndonjë Detyrimi Financiar të Shërbimit A të transferuar atij sipas kësaj Marrëveshjeje,

në shkallën që nuk i anulohen, zvogëlohen ose transferohen atij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huadhënës i Shërbimit A nënkupton:

a) një Huadhënës Fillestar me një Detyrim Financiar të Shërbimit A; dhe

b) çdo bankë, institucion financiar, trust ose subjekt tjetër që është bërë palë si Huadhënës i Shërbimit A, në përputhje me Klauzolën 21 (Ndryshime tek Huadhënësit),

që në çdo rast, nuk ka pushuar së qënuri Palë si Huadhënës i Shërbimit A, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Hua e Shërbimit A nënkupton një hua të dhënë ose që duhet të jepet sipas Shërbimit A ose shuma e principalit të papaguar për kohën në vazhdim të asaj Huaje.

Shërbimi B nënkupton shërbimin e huasë me afat të vënë në dispozicion sipas kësaj Marrëveshjeje, siç përshkruhet në Klauzolën 2 (Shërbimet).

Detyrimi Financiar i Shërbimit B nënkupton, pas njoftimit nga Agjenti sipas Klauzolës 2.2.6:

a) në lidhje me një Huadhënës Fillestar të Shërbimit B, shumën në euro të parashtruar në paragrafin 2 të Detyrimit Financiar përkatës të Shërbimit B dhe Letrës së Pranimit dhe shumën e ndonjë Detyrimi tjetër Financiar të Shërbimit B të transferuar atij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) në lidhje me ndonjë Huadhënës tjetër, shumën e ndonjë Detyrimi Financiar të Shërbimit B të transferuar atij sipas kësaj Marrëveshjeje.

në shkallën që nuk i anulohet, zvogëlohet ose transferohet atij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe Letra e Pranimit nënkuptojnë një letër kryesisht në formën e përcaktuar në Programin 9 (Detyrimi Financiar i Shërbimit B dhe Letra e Pranimit) të dorëzuar nga Huamarrësi për Agjentin në përputhje me Klauzolën 2.2 (Shërbimi B).

Data e Detyrimit Financiar të Shërbimit B nënkupton datën (që është Data e Pranimit të Huadhënësit të Shërbimit B për të gjithë Huadhënësit e Propozuar të Shërbimit B) në të cilën Detyrimi Financiar i Shërbimit B të të gjithë Huadhënësve të Shërbimit B është përdorur me egzekutimin në atë datë nga Agjenti dhe Rregulluesit e të gjitha Detyrimeve Financiare të Shërbimit B dhe Letrave të Pranimit për të gjithë Huadhënësit e Propozuar të Shërbimit B, në përputhje me Klauzolën 2.2 (Shërbimi B).

Huadhënësi i Shërbimit B nënkupton:

a) një Huadhënës ose ndonjë bankë ose institucion tjetër financiar që identifikohet si i tillë dhe është bërë Palë në bazë të një Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit, në përputhje me Klauzolën 2.2 (Shërbimi B); dhe

b) çdo bankë, institucion tjetër financiar, trust, fond ose subjekt tjetër që është bërë Palë si Huadhënës i Shërbimit B, në përputhje me Klauzolën 21 (Ndryshime tek Huadhënësit),

që, në çdo rast, nuk ka pushuar së qënuri Palë si Huadhënës i Shërbimit B, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Data e Pranimit të Huadhënësit të Shërbimit B nënkupton, në lidhje me një Huadhënës të propozuar të Shërbimit B, më të fundit e:

a) Datës së Pranimit të Huadhënësit të Shërbimit B, të specifikuar në një Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit; dhe

b) Datës në të cilën Agjenti dhe Rregulluesit egzekutojnë Detyrimin Financiar përkatës të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit për atë Huadhënës të Shërbimit B.

Huaja e Shërbimit B nënkupton një hua të dhënë ose që duhet të jepet sipas Shërbimit B ose shuma e principalit të papaguar për kohën në vazhdim të asaj Huaje.

Zyra e Shërbimit nënkupton zyrën ose zyrat e njoftuara me shkrim nga një Huadhënës për Agjentin në ose para datës kur ai bëhet Huadhënës (ose, pas asaj date, jo më pak se pesë ditë pune nga njoftimi me shkrim) si zyrë ose zyra përmes të cilave do të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Letër Tarifore nënkupton një letër ose letra të datës së kësaj Marrëveshjeje ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Rregulluesit dhe Huamarrësit (ose Agjentit dhe Huamarrësit) që përcaktojnë ndonjë prej tarifave të përmendura në Klauzolën 11 (Tarifat).

Dokument Financiar nënkupton Marrëveshjen, një Kërkesë për Shtyrje, çdo Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit, çdo Letër Tarifore dhe çdo dokument tjetër të përmendur si të tillë nga Agjenti dhe Huamarrësi.

Palë Financuese nënkuptojnë Agjentin, Rregulluesin ose Huadhënësin.

Qënia në Borxh Financiar nënkupton çdo qënie në borxh për ose në lidhje me:

a) Paratë e marra hua;

b) Çdo shumë të mbledhur nga pranimit sipas ndonjë shërbimi kredie pranimit ose ekuivalenti të ç'materializuar;

c) Çdo shumë të mbledhur sipas ndonjë shërbimi të njoftimit të blerjes ose lëshimi i obligacioneve, dëftesave, dëftesave të borxhit, fondi huaje ose ndonjë instrumenti të ngjashëm;

d) Shumën e e ndonjë detyrimi në lidhje me ndonjë qira ose kontrate blerjeje me këstet e qirasë, që në përputhje me IFRS, do të trajtohej si një kontratë qiraje financiare ose kapitali;

e) Shumat financiare të pritshme të shitura ose të zbritura (të ndryshme nga ndonjë shumë financiare e pritshme në shkallën që ato shiten mbi bazë mospërdorimi);

f) çdo shumë të mbledhur sipas ndonjë tranzaksioni tjetër (duke përfshirë çdo marrëveshje të mundshme shitjeje ose blerjeje) që ka efektin tregtarl të një huamarrjeje;

g) çdo tranzaksion të prejardhur të lidhur mbi mbrojtjen nga ose përfitimin nga luhatja në ndonjë normë ose çmim (dhe kur llogaritet vlera e ndonjë tranzaksioni të prejardhur, vetëm ai i treguar me vlerën e tregut do të merret në konsideratë);

h) çdo detyrim kundërzhdëmtimi në lidhje me një garanci, zhdëmtim, obligacion, rezervë ose letër dokumentuese kredie ose ndonjë instrument tjetër të lëshuar nga një bankë ose institucion financiar; dhe

i) shumën e ndonjë detyrimi mbi ndonjë garanci ose zhdëmtim për ndonjë prej pikave të përmendura në paragrafët (a) deri (h) më sipër.

Kompani Aksionere nënkupton, në lidhje me një kompani ose korporatë, çdo kompani ose korporatë tjetër në lidhje me të cilën ajo është Ndihmëse.

IFRS nënkupton “Standardet Ndërkombëtare të Llogaritjes” dhe interpretime të ngjashme që amendohen, plotësohen, lëshohen ose miratohen herë pas here nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Llogaritjes.

Periudhë Interesi” është, në lidhje me një Hua, çdo periudhë e përcaktuar në pajtim me klauzolën 9 (Periudhat e Interesit) dhe në lidhje me një Shumë të Papaguar, çdo periudhë të përcaktuar në përputhje me Klauzolën 8.3 (Kamatvonesa).

Gjykata LCIA nënkupton Gjykatën Londineze të Arbitrazhit Ndërkombëtar.

Huadhënës nënkupton:

çdo Huadhënës Fillestar (duke përfshire Huadhenesit e Sherbimit A);

cdo Huadhenes te Sherbimit B; dhe

çdo bankë, institucion financiar, trust, fond ose subjekt tjetër që është bërë Palë në përputhje me Klauzolën 0 (Ndryshime ndaj Huadhënësve),

që në çdo rast nuk ka pushuar së qënuri Palë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Hua nënkupton një Hua të Shërbimit A ose një Hua të Shërbimit B.

LMA nënkupton Shoqërinë e Tregut të Huave.

Huadhënësit e Shumicës nënkuptojnë

a) nëse nuk ka Hua në atë kohë të papaguara, një Huadhënës ose Huadhënës detyrimet financiare të të cilëve tejkalojnë 662/3% të Detyrimeve të Përgjithshme Financiare (ose nëse Detyrimet e Përgjithshme Financiare janë reduktuar në zero, të mbledhura në total më shumë se 662/3% të Detyrimeve të Përgjithshme Financiare menjëherë para reduktimit); ose

b) në çdo kohë tjetër, një Huadhënës ose Huadhënës kontributet e të cilëve në Hua në atë kohë të papaguara përbëjnë më shumë se 662/3% të të gjitha Huave në atë kohë të papaguara.

Për qëllim të përkufizimit të Huadhënësit të Shumicës, me efekt në dhe nga Data e Detyrimit Financiar të Shërbimit B, Agjenti do të përfshijë në llogaritjet e tij çdo Detyrim Financiar të Shërbimit B që është përdorur në përputhje me këtë Marrëveshje.

Kosto e Detyrueshme nënkupton normën e përqindjes në vit të llogaritur nga Agjenti në përputhje me Programin 2 (Formula e Kostos së Detyrueshme).

Marzh nënkupton:

a) në bazë të paragrafit (b) nëntë pikë gjashtëdhjet e pesë përqind (9.65 %) në vit ose

b) nga (dhe duke përfshire) data kur Shërbimi i Investitorëve të Moody, Inc klasifikon Qënien në Borxh të Jashtëm të rritur afatgjatë, të pasiguar dhe pa kredi të Republikës së Shqipërisë, nën “B2”, dhe në çdo kohë më pas, dhjetë pikë gjashtëdhjet e pesë për qind (10.65 %) në vit.

Ndikim Material Negativ nënkupton një ndikim material negativ në:

a) asetet ose gjendjen financiare ose perspektivat e Republikës së Shqipërisë; ose

b) vlefshmërinë ose egzekutueshmërinë e një Dokumenti Financimi ose të drejtat ose kompensimet e një Pale Financuese sipas një Dokumenti Financimi; ose

c) hua ndërkombëtare ose hua përkatëse të brendshme nga disa huadhënës, kapital ose treg financiar në përgjithësi që, sipas mendimit të Rregulluesit ose Huadhënësve të Shumicës, mund të cënonin vazhdimin e Shërbimit në bazë të kushteve që zbatohen për të në datën e kësaj Marrëveshjeje.

Datë Maturimi nënkupton datën që bie tridhjet e gjashtë (36) muaj pas Datës së parë të Shfrytëzimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Muaj nënkupton periudhën që fillon në një ditë të një muaji kalendarik dhe përfundon në ditën korrespondente numerike të muajit pasardhës kalendarik, me përjashtim:

a) (në bazë të paragrafit (c) më poshtë) nëse dita korresponduese numerikisht nuk është Ditë Pune, ajo periudhë përfundon në Ditën pasuese të Punës në atë muaj Kalendarik në të cilin ajo periudhë duhet të mbarojë, nëse ka, ose nëse nuk ka, në ditën që paraprind menjëherë Ditën e Punës

b) Nëse nuk ka ditë korresponduese numerikisht në muajin kalendarik në të cilin ajo periudhë duhet të mbarojë, ajo periudhë do të mbarojë në Ditën e fundit të punës në atë muaj kalendarik; dhe

c) Nëse një Periudhë Interesi fillon në Ditën e fundit të Punës të një muaji kalendarik, ajo Periudhë Interesi do të përfundojë në Ditën e fundit të Punës në muajin kalendarik në të cilin ajo Periudhë Interesi duhet të përfundojë.

Rregullat e mësipërme do të zbatohen vetëm për muajin e fundit të një periudhe.

Shtet Anëtar Pjesëmarrës nënkupton çdo shtet anëtar të Komuniteteve Europiane që miraton ose ka miratuar Euron si monedhën e tij të ligjshme në përputhje me legjislacionin e Komunitetit Europian në lidhje me Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Palë nënkupton një palë të kësaj Marrëveshjeje.

Huadhënës Kualifikues ka kuptimin e dhënë atij në Klauzolën 0 (Shuma shtesë e taksave dhe zhdëmtimet).

Datë Kuotimi” është, në lidhje me një Periudhë për të cilën duhet të përcaktohet Interesi, dy ditë TARGET para ditës së parë të asaj periudhe, nëse praktika e tregut nuk ndryshon në Tregun Përkatës Ndërbankar dhe në këtë rast Data e Kuotimit do të përcaktohet nga Agjenti në përputhje me praktikën e tregut në Tregun Përkatës Ndërbankar (dhe nëse kuotimet do të jepeshin normalisht nga bankat kryesore në Tregun Përkatës Ndërbankar në më shumë se një ditë, Data e Kuotimit do të jetë e fundit e atyre ditëve).

Bankat e Referencës” nënkupton zyrën kryesore në Londër të Deutsche Bank AG, JP Morgan dhe Citibank ose banka të tjera të tilla që mund të caktohen nga Agjenti në konsultim me Huamarrësin.

Tregu Përkatës Ndërbankar nënkupton tregun ndërbankar europian.

Përfaqësimi Përsëritës nënkuptojnë secilin prej përfaqësimeve të parashtuara në Klauzolën 0 (Përfaqësimet) me përjashtim të Klauzolës 0 (asnjë procedim i mbartur ose i synuar) dhe 0 (asnjë ndryshim material negativ).

Norma zyrtare” është norma e përqindjes në vit e përcaktuar nga Federata Bankare e Bashkimit Europian për periudhën përkatëse, e treguar në faqen e duhur të ekranit Reuters. Nëse faqja e rënë dakord zëvendësohet ose shërbimi ndërpritet, Agjenti mund të përcaktohet një faqe ose shërbim tjetër që tregon normën përkatëse pas konsultimit me Huamarrësin dhe Huadhënësit.

Garanci nënkupton një hipotekë, detyrim, peng, garanci pagese ose interes garancie tjetër që siguron detyrim të ndonjë personi ose marrëveshje apo masë tjetër që ka ndikim të ngjashëm.

Kohë e Specifikuar nënkupton një kohë të përcaktuar në përputhje me (Grafikët Kohore).

Subjekt shtetëror nënkupton një nën-ndarje politike, ekonomike ose administrative, ministri, departament, agjenci, autoritet publik, korporatë bordi ose ligjore e Huamarrësit (duke përfshirë, pa kufizim, Bankën e Shqipërisë), dhe çdo shoqëri ose subjekt që kontrollohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga Huamarrësi (me përjashtim të bashkive) ku për këtë qëllim “kontroll” do të thotë pronësi prej më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të kapitalit aksioner me të drejtë vote (ose të drejtën ekuivalente të pronësisë) të kësaj shoqërie ose subjekti ose kompetenca për të drejtuar politikën dhe menaxhimin e saj, nëpërmjet kontratës apo në ndonjë formë tjetër.

Ndihmës nënkupton një ndihmës brenda kuptimit të seksionit 736 të Ligjit të Shoqërive 1985.

TARGET2 nënkupton sistemin e pagesës së Transferimit Ekspres të Shlyerjes Bruto në Kohë Reale Automatike Transeuropiane që përdor një platformë të përbashkët të vetme dhe që filloi më 19 nëntor 2007.

Ditë TARGET nënkupton çdo ditë në të cilën TARGET2 është e hapur për shlyerjen e pagesave në euro.

Taksa përfshin të gjitha taksat, tatimet, tarifat, detyrimet ose mbajtjet e një natyre të ngjashme (duke përfshirë çdo gjobë ose interes të pagueshëm në lidhje me një paftësi paguese ose vonesë në pagimin e një tarife) dhe Taksat do të interpretohen në mënyrën e duhur

Detyrime të Përgjithshme Financiare nënkuptojnë shumën e përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit A dhe shumën e përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit B.

Detyrimet Financiare të Përgjithshme të Shërbimit A nënkuptojnë shumën e përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit A që janë [...] euro në datën e kësaj Marrëveshjeje.

Detyrimet Financiare të Përgjithshme të Shërbimit B nënkuptojnë shumën e përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit B që janë zero [0] në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe pas njoftimit nga Agjenti sipas Klauzolës 2.2.6, një shumë e përgjithshme që nuk tejkalon [...] Euro.

Çertifikatë Transferimi nënkupton një çertifikatë kryesisht në formën e përcaktuar në 0 (Formulari i çertifikatës së Transferimit) ose ndonjë formular tjetër i rënë dakord ndërmjet Agjentit dhe Huamarrësit.

Data e Transferimit nënkupton, në lidhje me një transferim, më të vonshmen e:

a) Datës së propozuar të Transferimit të specifikuar në Çertifikatën e Transferimit; dhe

b) Datën në të cilën Agjenti egzekuton Çertifikatën e Transferimit.

Shumë e Papaguar nënkupton çdo shumë të kërkueshme dhe të pagueshme por të papaguar nga Huamarrësi sipas Dokumentave të Financimit.

Shfrytëzim nënkupton një shfrytëzim të një Shërbimi.

Datë Shfrytëzimi nënkupton datën e një Shfrytëzimi që është data në të cilën duhet të jepet Huaja përkatëse.

Kërkesë Shfrytëzimi nënkupton një njoftim kryesisht në formën e përcaktuar në Pjesën 1 të Programit 1 (Kërkesë Shfrytëzimi) të egzekutuar në mënyrën e duhur nga Ministri i Financave të Huamarrësit (ose nga ndonjë person tjetër i autorizuar rregullisht nga Ministri i Financave të Huamarrësit për ta egzekutuar atë).

TVSH nënkupton taksën e vlerës së shtuar që parashikohet në Ligjin mbi Taksën e Vlerës së Shtuar të vitit 1994 dhe çdo taksë tjetër të një natyre të ngjashme.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Nëse nuk shfaqet një tregues i kundërt, çdo referencë në këtë Marrëveshje ndaj:

a) Agjentit, Rregulluesit, çdo Pale Financuese, Huamarrësit ose ndonjë Pale do të interpretohet në mënyrë që të përfshijë pasardhësit e saj në titull, drejtëdhënësit e lejuar dhe drejtëmarrësit e lejuar;

b) Sendet pasurore përfshijnë prona të tashme dhe të ardhshme, të ardhura dhe të drejta të çdo përshkrimi;

c) një Dokument Financiar ose çdo marrëveshje apo instrument tjetër është një referencë ndaj atij Dokumenti Financimi ose marrëveshjeje apo instrumenti tjetër që amendohet, shtyhet, plotësohet, zgjerohet ose parashtrohet përsëri;

d) qënia në borxh përfshin çdo detyrim (qoftë të shkaktuar si principal ose si sigurim) për shlyerjen e parave, qoftë të tashme ose të ardhshme, faktike ose të mundshme;

e) një person përfshin çdo individ, firmë, kompani, korporatë, qeveri, shtet ose agjenci të një shteti ose shoqërie, trust, ndërmarrje e përbashkët, konsorcium ose ortakëri (nëse kanë apo jo personalitet të ndarë juridik);

f) një rregullore përfshin çdo rregullore, rregull, direktivë zyrtare, kërkesë ose udhëzim (qoftë nëse ka apo jo forcën e ligjit) të ndonjë organi qeveritar, ndërqeveritar ose supranacional, agjenci, department, ose autoritet rregullator, vetërregullator ose autoritet apo organizatë tjetër;

g) një dispozitë ligji është një referencë ndaj asaj dispozite që amendohet ose sillet përsëri në fuqi; dhe

h) një kohë e ditës është referencë ndaj kohës së Londrës.

1.2.2 Seksioni, klauzola dhe titujt e grafikeve janë vetëm për lehtësi reference.

1.2.3 Nëse nuk shfaqet një tregues i kundërt, një term i përdorur në një Dokument tjetër Financiar ose në një njoftim të dhënë sipas ose në lidhje me një Dokument Financimi ka të njëjtin kuptim në atë Dokument Financiar ose njoftim si në këtë Marrëveshjeje.

1.2.4 Një Mosplotësim Detyrimi (ndryshe nga një Ngjarje e Moplotësimit të Detyrimeve) është i vazhdueshëm nëse nuk kompensohet ose hiqet dorë dhe një Ngjarje e Mosplotësimit të Detyrimeve është e vazhdueshme nëse nuk është hequr dorë.

1.3 Të drejtat e palëve të treta

1.3.1 Nëse nuk parashikohet shprehimisht për të kundërtën në një Dokument Financimi, një person i cili nuk është Palë nuk ka asnjë të drejtë sipas Kontratave (të Drejtat e Palëve të Treta), Ligjit 1999 (Ligji i Palëve të Treta) për të zbatuar ose gëzuar përfitimin e ndonjë kushti të kësaj Marrëveshjeje.

1.3.2 Pavarësisht ndonjë kushti të një Dokumenti Financimi, miratimi i një personi i cili nuk është Palë, nuk kërkohet për të shfuqizuar ose ndryshuar këtë Marrëveshje në çdo kohë.

SEKSIONI 2 SHËRBIMET

2. Shërbimet

2.1 Shërbimet

Në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje:

2.1.1 Huadhënësit e Shërbimit A vënë në dispozicion të Huamarrësit një shërbim huaje me afat në Euro në një shumë të përgjithshme të barabartë me Detyrimet e Përgjithshme Financiare të Shërbimit A; dhe

2.1.2 me kusht që të vihet në dispozicion sipas Klauzolës 2.2 (Shërbimi B), Huadhënësit e Shërbimit B vënë në dispozicion të Huamarrësit një shërbim huaje me afat në euro në një shumë të përgjithshme të barabartë me Detyrimet Financiare të Përgjithshme të Shërbimit B.

2.2 Shërbimi B

2.2.1 Në çdo kohë pas datës së kësaj Marrëveshjeje deri në (dhe përfshirë) datën 12 qershor 2009, Huamarrësi mund të konfirmojë se një nga Huadhënësit ose ndonjë bankë ose institucion tjetër financiar (ose trust, fond ose subjekt tjetër që është i angazhuar rregullisht ose krijuar për qëllim të bërjes, blerjes ose investimit në hua, rëndime barrësore ose asete të tjera financiare) (secili një Huadhënës i Propozuar i Shërbimit B) ka rënë dakord të vërë në dispozicion Detyrimet Financiare të Shërbimit B (ose ndonjë pjesë të tyre) duke i dorëzuar Agjentit dhe Rregulluesve një Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letër Pranimit të egzekutuar rregullisht për çdo Huadhënës të Propozuar të Shërbimit B, secili i egzekutuar rregullisht nga Ministri i Financave të Huamarrësit (ose nga ndonjë person tjetër i autorizuar rregullisht nga Ministri i Financave të Huamarrësit për ta egzekutuar atë) dhe nga Huadhënësi përkatës i Propozuar i Shërbimit B. Nuk ka kufizime në numrin e Detyrimeve Financiare të Shërbimit B dhe Letrat e Pranimit mund të dorëzohen nga Huamarrësi për Agjentin dhe Rregulluesit por Huamarrësi do të kërkojë që Data e Pranimit të Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B të jetë e njëjta datë për çdo Huadhënës të Propozuar të Shërbimit B.

2.2.2 Shuma maksimale e principalit e Detyrimeve të Përgjithshme Financiare të Shërbimit B nuk duhet të tejkalojë [...] Euro në çdo kohë dhe shumën maksimale e principalit e Detyrimeve të Përgjithshme Financiare nuk duhet të tejkalojë 250,000,000 Euro në çdo kohë.

2.2.3 Çdo Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe Letër Pranimit është i pakthyesëm dhe nuk do të konsiderohet sikur të jetë përfunduar rregullisht nëse nuk specifikon:

a) Emrin e Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B;

b) Datën e Pranimit të Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B që është data në të cilën duhet të përdoret Shërbimi B dhe që duhet të jetë e njëjta datë si Data e Pranimit të Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B për të gjithë Huadhënësit e tjerë të propozuar të Shërbimit B.

c) shumën e Detyrimit Financiar të Shërbimit B të alokuar Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B të përmendur në Detyrimin Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit.

d) monedhën që duhet të jetë euro; dhe

e) që nuk po vazhdon asnjë Mosplotësim Detyrimesh ose që do të rezultonte nga Shërbimi B i kërkuar që vihet në dispozicion mbi bazë përdorimi.

2.2.4 Asnjë Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe Letër Pranimit nuk mund të dorëzohen nga Huamarrësi më herët se tre (3) Ditë Pune para Datës së Shfrytëzimit në lidhje me Shërbimin B.

2.2.5 Çdo Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe çdo Letër Pranimit duhet të egzekutohen rregullisht nga Huadhënësi përkatës i Propozuar i Shërbimit B në të cilin Detyrimi Financiar i Shërbimit B alokohet si më poshtë.

2.2.6 Në bazë të Klauzolës 2.2.7, 2.2.8 dhe 2.2.9 më poshtë, sa më parë që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, pas marrjes nga ana e tyre të një Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe një Letre Pranimit të egzekutuar rregullisht që shfaqet përkrah, për t'u pajtuar me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe dorëzuar në përputhje me kushtet e kësaj Klauzole 2.2, secili prej Agjentit dhe Rregulluesve do të egzekutojnë Detyrimin Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit dhe menjëherë më pas Agjenti do të japë njoftim me shkrim për emrin e Huadhënësve të Shërbimit B dhe shumën e përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit B, të përdorura në përputhje me këtë Marrëveshje për Huamarrësin dhe Palët e tjera Financiare.

2.2.7 Agjenti nuk do të jetë i detyruar të egzekutojë një Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe një Letër Pranimit të dorëzuar atij nga Huamarrësi derisa të sigurohet që është egzekutuar rregullisht nga Huamarrësi dhe Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B ka përbushur të gjitha kontrollet ose procedurat e nevojshme “ njihni klientin tuaj” ose kontrolle të tjera të ngjashme sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në lidhje me pranimin e Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B.

2.2.8 Agjenti dhe Rregulluesit:

a) nuk do të egzekutojnë një Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letër Pranimit nëse ky detyrim dhe të gjitha Detyrimet e tjera Financiare të Shërbimit B dhe Letrat e Pranimit nuk specifikojnë të njëjtën datë si Datën e tyre përkatëse të Pranimit të Huadhënësit të Shërbimit B; dhe

b) nuk do të jenë të detyruar të egzekutojnë të gjitha Detyrimet Financiare të Shërbimit B dhe Letrat e Pranimit në të njëjtën datë.

2.2.9 Një Huadhënës i Propozuar i Shërbimit B mund të marrë përsipër vetëm një Detyrim Financiar të Shërbimit B me efekt nga data kur Agjenti dhe Rregulluesit kundërfirmosin Detyrimin Financiar përkatës të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit.

2.2.10 Në Datën e Pranimit të Huadhënësit të Shërbimit B:

a) Huamarrësi, Agjenti, Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B, Huadhënësit e tjerë dhe Palët e tjera Financuese do të kenë të njëjtat të drejta dhe do të marrin përsipër të njëjtat detyrime midis tyre sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumentave të tjera Financiare që ata do të kishin patur dhe marrë përsipër nëse Huadhënësi pranues i Propozuar i Shërbimit B do të kishte qënë Huadhënës Fillestar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumentave të tjera Financiare; dhe

b) Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B do të bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo Dokumenti përkatës Financiar si Huadhënës i Shërbimit B dhe do të marrë përsipër Detyrimin Financiar të Shërbimit B, të parashtruar në Detyrimin Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit.

2.2.11 Nëse një person duhet të bëhet Huadhënës i Shërbimit B sipas ndonjë transferimi ose kalimi të drejtash nga një Huadhënës egzistues i Shërbimit B, do të zbatohen dispozitat e Klauzolës 21 (Ndryshime tek Huadhënësit).

2.2.12 Asnjë Palë Financuese nuk do të jetë e detyruar të dorëzojë ose sigurojë ndonjë shumë në lidhje me Shërbimin B dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj Huamarrësit ose një personi tjetër në lidhje me të dhe ndonjë detyrim financiar ose marrëveshje për të dorëzuar herë pas here ndonjë pjesë të Shërbimit B nga ndonjë Huadhënës, nuk do të detyrojë ndonjë Huadhënës tjetër të angazhohet në detyrime financiare ose marrëveshje të ngjashme si më poshtë.

2.2.13 Çdo Palë (e ndryshme nga Huamarrësi, Rregulluesit dhe Huadhënësi përkatës i Propozuar i Shërbimit B) autorizon në mënyrë të pakthyeshme Agjentin të egzekutojë çdo Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe çdo Letër Pranimit të dorëzuar në përputhje me këtë Klauzolë 2.2 (Shërbimi B) në emër të tij, pa ndonjë miratim të mëtejshëm ose konsulencë të kësaj Pale.

2.3 Të drejtat dhe detyrimet e Palëve Financuese

2.3.1 Detyrimet e çdo Pale Financuese sipas Dokumentave të Financimit janë individuale. Dështimi nga një Palë Financuese për të përbushur detyrimet e saj sipas Dokumentave të Financimit nuk çënon detyrimet e një Pale tjetër sipas Dokumentave të Financimit. Asnjë Palë Financiare nuk është përgjegjëse për detyrimet e një Pale tjetër Financuese sipas Dokumentave të Financimit.

2.3.2 Të drejtat e secilës Palë Financuese sipas ose në lidhje me Dokumentat e Financimit janë të ndara dhe të drejtat e pavarura dhe çdo borxh që lind sipas Dokumentave të Financimit ndaj një Pale Financuese nga Huamarrësi do të jetë një borxh i ndarë dhe i pavarur.

2.3.3 Me përjashtim të rasteve kur deklarohet ndryshe në Dokumentat e Financimit, Pala Financuese mund të zbatojë veçmas të drejtat e saj sipas Dokumentave të Financimit.

3 Qëllimi

3.1 Qëllimi

Huamarrësi do të aplikojë të gjitha shumat e marra hua nga ai sipas çdo Shërbimi ndaj:

3.1.1 Financimit [nevojat për shpenzime kapitale të planifikuara të Këshillit të Ministrave për vitin 2009 (i cili përfshin përfundimin e seksionit Rrëshen-Kalimash të autostradës Durrës-Morinë në Shqipëri)], në një mënyrë që është e pajtueshme dhe në përputhje me prioritetet e përcaktuara në “Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin e [Republikës së Shqipërisë]”; dhe

3.1.2 Pagesës së tarifave dhe shpenzimeve të pagueshme ndaj Palëve Financuese sipas Dokumentave të Financimit.

3.2 Monitorimi

Asnjë Palë Financuese nuk ka detyrimin të monitorojë ose verifikojë aplikimin e ndonjë shume të marrë hua sipas kësaj Marrëveshjeje.

4 Kushtet e Shfrytëzimit

4.1 Kushtet fillestare paraprake

Huamarrësi mund të mos dorëzojë një Kërkesë Shfrytëzimi nëse Agjenti nuk ka marrë të gjitha dokumentat dhe provat e tjera të renditura në 0 (Kushtet paraprake) në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Agjentin. Agjenti do të njoftojë Huamarrësin dhe Huadhënësit menjëherë pas miratimit.

Kushte të mëtejshme paraprake

Huadhënësit do të jenë të detyruar të pajtohen vetëm me Klauzolën 0 (Kontributet e Huadhënësve) nëse në datën e Kërkesës për Shfrytëzim dhe në Datën e propozuar për Shfrytëzim:

4.2.1 Nuk vazhdon asnjë Mosploitësim Detyrimi ose që do të rridhte nga Huaja e propozuar; dhe

4.2.2 Përfaqësimet Përsëritëse që duhet të bëhen nga Huamarrësi janë të vërteta në të gjitha aspektet materiale.

4.3 Numri maksimal i Huave

Huamarrësi mund të mos dorëzojë një Kërkesë Shfrytëzimi nëse si rezultat i Shfrytëzimit të propozuar:

4.3.1 më shumë se një (1) Hua e Shërbimit A do të ishte e papaguar; ose

4.3.2 më shumë se një (1) Hua e Shërbimit B do të ishte e papaguar.

SEKSIONI 3 SHFRYTËZIMI

5 Shfrytëzimi

5.1 Dorëzimi i një Kërkesë Shfrytëzimi

Huamarrësi mund të përdorë një Shërbim duke i dorëzuar Agjentit një Kërkesë Shfrytëzimi të përfunduar siç duhet, jo më vonë se Koha e Specifikuar.

5.2 Përfundimi i një Kërkesë Shfrytëzimi

5.2.1 Çdo Kërkesë Shfrytëzimi është e pakthyeshme dhe nuk do të konsiderohet sikur të ishte përfunduar siç duhet, nëse:

a) Identifikon Shërbimin që duhet të shfrytëzohet

b) Data e propozuar e Shfrytëzimit nuk është Ditë Pune brenda Periudhës së Disponueshmërisë të zbatueshme për atë Shërbim;

c) Monedha dhe shuma e Shfrytëzimit pajtohen me Klauzolën 0 (Monedha dhe shuma); dhe

d) Periudha e propozuar e Interesit pajtohet me Klauzolën 9 (Periudhat e Interesit).

5.2.2 Vetëm një Hua mund të kërkohet në secilën Kërkesë Shfrytëzimi.

5.3 Monedha dhe shuma

5.3.1 Monedha e specifikuar në një Kërkesë Shfrytëzimi duhet të jetë Euro.

5.3.2 Shuma e Huasë së propozuar duhet të jetë një shumë që nuk është më shumë se Shërbimi përkatës në dispozicion dhe që është një shumë minimale prej €10,000,000 ose më pak, Shërbimi përkatës në dispozicion.

5.4 Kontributi i Huadhënësve

5.4.1 Nëse kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje plotësohen, çdo Huadhënës duhet të japë kontributin e e tij në secilën Hua të disponueshme deri në Datën e Shfrytëzimit nëpërmjet Zyrës së tij të Shërbimit.

5.4.2 Shuma e kontributit të secilit Huadhënës në çdo Hua është e barabartë me raportin e nxjerrë nga Kontributi i tij i Disponueshëm ndaj Shërbimit të Disponueshëm menjëherë para dhënies së Huasë.

5.4.3 Agjenti do të njoftojë çdo Huamarrës për shumën e secilës Hua dhe shumën e kontributit të tij në atë Hua deri në Kohën e Specifikuar.

5.5 Anullimi i Detyrimeve Financiare

5.5.1 Nëse Shërbimi A nuk shfrytëzohet deri në datën që bie dyzet e pesë (45) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, atëherë në atë datë Shërbimi A do të anulohet automatikisht dhe Detyrimet e Përgjithshme Financiare të Shërbimit A do të anulohen menjëherë dhe automatikisht.

5.5.2 Nëse Shërbimi B nuk shfrytëzohet deri në datën që bie pesëmbëdhjetë (15) ditë pas Datës

së Detyrimit Financiar të Shërbimit B, atëherë, në këtë datë Shërbimi B do të anulohet automatikisht dhe Detyrimet e Përgjithshme Financiare të Shërbimit B do të anulohen menjëherë dhe automatikisht.

SEKSIONI 4 SHLYERJA, PARAPAGIMI DHE ANULLIMI

6 Shlyerja

6.1 Shlyerja e Huave

Shlyerja

Huamarrësi e shlyen Huanë plotësisht në Datën e Maturimit ose në rast se Huamarrësi ushtron opsionin e shtyrjes sipas dhe në bazë të kushteve të Klauzolës 6.2 (Opsioni i Shtyrjes), në Datën e Maturimit të Shtyrë.

6.2 Opsioni i Shtyrjes

6.2.1 Data e Maturimit mund të shtyhet deri njëzet e katër (24) muaj nëse:

a) Huamarrësi e kërkon këtë në një Kërkesë për Shtyrje të egzekutuar rregullisht nga Ministri i Financave i Huamarrësit (ose nga ndonjë person tjetër i autorizuar rregullisht nga Ministri i Financave të Huamarrësit (për ta egzekutuar atë) dhe të marrë nga Agjenti jo më shumë se 60 ditë dhe jo më pak se dyzet (40) ditë para Datës së Maturimit;

b) Jo më vonë se njëzet (20) ditë para Datës së Maturimit (Data e Skadimit të Kërkesës për Shtyrje), një ose më shumë Huadhënës (Huadhënësit Shtyrës) kanë rënë dakord për këtë shtyrje me shkrim duke i dorëzuar Agjentit dhe Huamarrësit një Njoftim për Përgjigje ndaj Shtyrjes që përmban marrëveshja e tyre ndaj shtyrjes së mësipërme me të njëjtën normë interesi dhe kushte të tjera në atë kohë të zbatueshme për Huatë (dhe pa kërkesë për tarifa shtesë) dhe duke këshilluar gjithashtu për shumën e kontributit të tyre në Huatë që ata bien dakord të shlyhen në Datën e Shtyrë të Maturimit në vend të Datës së Maturimit; dhe

c) Jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para Datës së Maturimit, Agjenti ka njoftuar formalisht Huamarrësin me shkrim se cilët prej Huadhënësve janë Huadhënës Shtyrës dhe kanë rënë dakord për atë Kërkesë për Shtyrje dhe në cilat shuma.

6.2.2 Agjenti do të njoftojë menjëherë çdo Huadhënës për ndonjë Kërkesë për Shtyrje.

6.2.3 Një Huadhënës do të konsiderohet të ketë refuzuar pëlqimin e tij për të gjithë kontributin në të gjitha Huatë (një Huadhënës kundërshtues), nëse nuk ka dorëzuar një Njoftim për Përgjigjen e Shtyrjes deri në Datën e Skadimit të Kërkesës për Shtyrje.

6.2.4 Palët bien dakord dhe egzekutojnë çdo amendim të kësaj Marrëveshjeje dhe të çdo dokumenti tjetër që Agjenti mund të çmojë të nevojshëm si rezultat i operimit të kësaj Klauzole 0.

6.2.5 Në Datën e Maturimit, Huamarrësi do të shlyejë:

a) Pjesën e Huave të kërkueshme për çdo Huadhënës kundërshtues; dhe
b) Atë pjesë të Huave të kërkueshme për secilin Huadhënës Shtyrës që Huadhënësi përkatës Shtyrës nuk miraton të shtyhet në përputhje me Njoftimin e saj të Përgjigjes për Shtyrje, dhe në këtë datë, shuma e Huave do të parapaguhet dhe Detyrimet e Përgjithshme Financiare do të zvogëlohen nga një shumë korresponduese.

6.2.6 Një Kërkesë për Shtyrje sipas kësaj Klauzole 0 është e pakthyeshme.

6.2.7 Mund të ketë vetëm një shtyrje të Datës së Maturimit si rezultat i një Kërkesë për Shtyrje sipas kësaj Klauzole 0.

6.3 Ri-marrja hua

Huamarrësi mund të ri-marrë hua çdo pjesë të Shërbimit që shlyhet.

7 Parapagimi dhe anulimi

7.1 Paligjshmëria

Nëse bëhet e paligjshme për Huadhënësin në ndonjë juridiksion të zbatueshëm për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve që merret përsipër prej tij në bazë të kësaj marrëveshjeje ose për të financuar, ose për të ruajtur kontributin e tij në një Hua:

7.1.1 Ai Huadhënës do të njoftojë menjëherë Agjentin pasi të vihet në dijeni për atë ngjarje;

7.1.2 Pasi Agjenti të njoftojë Huamarrësin, Detyrimi Financiar i atij Huadhënësi sipas të dyja Shërbimeve do të anulohet menjëherë; dhe

7.1.3 Huamarrësi do të shlyejë kontributin e atij Huadhënësi në Huatë ditën e fundit të Periudhës së Interesit për secilën Hua që ndodh pasi Agjenti të ketë njoftuar Huamarrësin ose, nëse ndodh më herët, në datën e specifikuar nga Huadhënësi në njoftimin e dorëzuar Agjentit (që nuk duhet të jetë më parë se dita e fundit e ndonjë periudhe të zbatueshme të shtyrjes së afatit, të lejuar me ligj).

7.2 Anullimi vullnetar

Huamarrësi nuk do të ketë të drejtë të anulojë Shërbimin e vënë në Dispozicion ose ndonjë pjesë të tij.

7.3 Parapagimi vullnetar i Huave

7.3.1 Nëse i jep Agjentit një njoftim paraprak jo më pak se tridhjet (30) Ditë Pune (ose një periudhë të tillë më të shkurtër që Huadhënësit e Shumicës mund të bien dakord), Huamarrësi mund të parapaguajë të gjithë ose ndonjë pjesë të të gjitha Huave (por nëse parapaguan pjesërisht, të jetë një shumë që zvogëlon të gjitha Huatë me një shumë minimale të barabartë me 15 % të të gjitha Huave).

7.3.2 Një Hua mund të parapaguhet vetëm pas datës që bie dymbëdhjetë (12) muaj pas Datës së parë të Shfrytëzimit.

7.4 E drejta e shlyerjes dhe anulimit në lidhje me një Huadhënësi të vetëm

7.4.1 Nëse:

a) Çdo shumë e pagueshme për një Huadhënësi nga Huamarrësi kërkohet të rritet sipas Klauzolës 0 (Shuma Shtesë e Taksave); ose

b) Një Huadhënësi kërkon zhdëmtim nga Huamarrësi sipas Klauzolës 0 (zhdëmtimi i Taksës) ose Klauzolës 0 (Kostot e Rritura),

Huamarrësi, ndërsa rrethana që shkakton kërkesën për zhdëmtim vazhdon, Huamarrësi mund t'i japë Agjentit njoftim mbi anulimin e Detyrimit Financiar të atij Huadhënësi sipas të dyja Shërbimeve dhe synimin e tij për të kërkuar shlyerjen e kontributit të atij Huadhënësi në Hua.

7.4.2 Me marrjen e një njoftimi të përmendur në Klauzolën 0 më sipër, Detyrimi Financiar i atij Huadhënësi sipas të dyja Shërbimeve do të reduktohet menjëherë në zero.

7.4.3 Në ditën e fundit të secilës Periudhë Interesi që përfundon pasi Huamarrësi të ketë dhënë njoftim sipas Klauzolës 0 (ose, nëse ndodh më herët, në datën e specifikuar nga Huamarrësi në atë njoftim), Huamarrësi do të shlyejë kontributin e atij Huadhënësi në Hua.

7.5 Kufizimet

7.5.1 Çdo njoftim për anulim ose parapagim i dhënë nga ndonjë Palë sipas kësaj Klauzole 0 (Parapagimi dhe anulimi) do të jetë i pakthyeshem dhe, nëse nuk shfaqet tregues për të kundërtën në këtë Marrëveshje, do të specifikojë datën ose datat në të cilat duhet të bëhen anulimi ose parapagesat përkatëse dhe shumën e atij anulimi ose parapagimi.

7.5.2 Çdo parapagim i ndonjë pjese të Huave sipas Klauzolës 7.3 (Parapagimi Vullnetar i Huave) do të aplikohet kundrejt Huave të të dyja Shërbimeve në mënyrë proporcionale.

7.5.3 Çdo parapagim sipas kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet së bashku me interesin e shtuar mbi shumën e parapaguar dhe në bazë të ndonjë Shpenzimi për Shlyerjen e Parakohshme, pa premie ose gjobë.

7.5.4 Huamarrësi mund të mos ri-marrë hua ndonjë pjesë të një Shërbimi që është parapaguar.

7.5.5 Huamarrësi nuk do të shlyejë ose parapaguajë të gjithë ose një pjesë të Huave ose nuk do të anulojë të gjithë ose një pjesë të Detyrimeve Financiare, me përjashtim të rasteve dhe në mënyrën e lejuar shprehimisht dhe të parashikuar në këtë Marrëveshje.

7.5.6 Asnjë shumë e Detyrimeve të Përgjithshme Financiare të anuluar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk mund të rivendoset më pas.

7.5.7 Nëse Agjenti merr një njoftim sipas kësaj Klauzole 0 (Parapagimi dhe Anullimi) sipas rastit, ai do t'i paraqesë menjëherë një kopje të atij njoftimi ose Huamarrësit, ose Huadhënësit të cënuar.

SEKSIONI 5 KOSTOT E SHFRYTËZIMIT

8 Interesi

8.1 Llogaritja e interesit

Norma e interesit mbi çdo Hua për secilën Periudhë Interesi është norma e përqindjes në vit që është shuma e përgjithshme e:

8.1.1 Marzhit dhe;

8.1.2 EURIBOR-it

8.2 Pagesa e Interesit

Huamarrësi do të paguajë interes të shtuar mbi secilën Hua në ditën e fundit të çdo Periudhë Interesi.

8.3 Kamatvonesa

8.3.1 Nëse Huamarrësi nuk paguan një shumë të pagueshme nga ai sipas një Dokumenti Financimi në datën e kërkueshme për pagesë, Huadhënësi paguan interes për këtë shumë nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës faktike (si para ashtu edhe pas vendimit) me një normë interesi që, në bazë të Klauzolës 0 më poshtë, është dy për qind (2%) më e lartë sesa norma që do të kishte qënë e pagueshme nëse gjatë periudhës së mospagesës, shuma e vonuar kishte përbërë Hua në monedhën e shumës së vonuar për Periudha të mëtejshme Interesi, secila me një kohëzgjatje të përzgjedhur nga Agjenti (që vepron në mënyrë të arsyeshme). Çdo interes që rritet sipas kësaj Klauzole 8.3 do të jetë menjëherë i pagueshëm nga Huamarrësi me kërkesë të Agjentit.

8.3.2 Nëse një shumë e vonuar përbëhet nga të gjitha ose pjesë të një Huaje që bëhet e kërkueshme në ditën që nuk ishte dita e fundit e një Periudhë Interesi në lidhje me atë Hua:

a) Periudha e parë e Interesit për atë shumë të vonuar do të ketë një kohëzgjatje të barabartë me pjesën e paskaduar të Periudhës aktuale të Interesit në lidhje me atë Hua; dhe

b) Norma e interesit që zbatohet për shumën e vonuar gjatë Periudhës së parë të Interesit do të jetë dy për qind (2%) më e lartë sesa norma që do të ishte zbatuar nëse shuma e vonuar nuk do të ishte bërë e kërkueshme.

8.3.3 Interesi i pagesës së vonuar (nëse është e papaguar) që lind mbi një shumë të vonuar do të rritej në përpjesëtim me shumën e vonuar në fund të secilës Periudhë Interesi të zbatueshme për atë shumë të vonuar por do të mbesë menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme.

8.3.4 Periudha fillestare e Interesit për një Hua të Shërbimit B do të përfundojë në ditën e fundit të Periudhës në atë kohë aktuale të Interesit për Huatë egzistuese të Shërbimit A dhe më pas, të gjitha Huatë sipas të dyja Shërbimeve do të kenë gjatë gjithë kohës të njëjtat Periudha Interesi.

8.4 Njoftimi i normave të interesit

Agjenti njofton menjëherë Huadhënësit dhe Huamarrësin për përcaktimin e çdo norme interesi sipas kësaj Marrëveshjeje.

9 Periudhat e Interesit

9.1 Përzgjedhja e Periudhave të Interesit

9.1.1 Në bazë të dispozitave të tjera të kësaj Klauzole 0, çdo Periudhë Interesi do të jetë gjashtë (6) muaj.

9.1.2 Një periudhë Interesi për një Hua nuk do të shtyhet më vonë se Data e Maturimit ose, nëse Huamarrësi ka ushtruar opsionin e tij të shtyrjes sipas Klauzolës 0 (Opsioni i Shtyrjes), më vonë se Data e Shtyrë e Maturimit.

9.1.3 Çdo Periudhë Interesi për një Hua fillon në Datën e Shfrytëzimit ose (nëse tashmë është bërë) në ditën e fundit të Periudhës së saj pararendëse të Interesit.

9.1.4 Periudha fillestare e interesit për Huane e Shërbimit B do të përfundojë ditën e fundit të Periudhës së Interesit aktual për Huane Ekzistuese të Shërbimit A dhe më pas, të gjitha huatë të të dyja shërbimeve do të kenë të njëjtat Periudha Interesi për gjithë kohën.

9.2 Ditë Jo-Pune

Nëse një Periudhë Interesi do të bëhet ndryshe e kërkueshme në një ditë që nuk është Ditë Pune, data e kërkueshme për pagesën shtyhet në Ditën Pasuese të Punës në atë muaj kalendarik (nëse ka) ose Ditën e Punës pararendëse (nëse nuk ka).

10 Ndryshime në llogaritjen e interesit

10.1 Mungesa e kuotimeve

Në bazë të Klauzolës 0 (Ç'organizimi i Tregut), nëse EURIBOR duhet të përcaktohet duke iu referuar Bankave të Referencës por një Bankë Reference nuk jep kuotim nga Koha e Specifikuar në Datën e Kuotimit, EURIBOR-i i zbatueshëm do të përcaktohet mbi bazën e kuotimeve të Bankave të mbetura të Referencës.

10.2 Ç'rregullimi i tregut

10.2.1 Nëse ndodh një Ngjarje e Ç'organizimit të Tregut në lidhje me një Hua për një Periudhë Interesi, atëherë norma e interesit mbi aksionin e asaj Huaje të çdo Huadhënësi për Periudhën e Interesit do të jetë norma e përqindjes në vit e cila është shuma e:

a) Marzhit dhe;

b) Norma e njoftuar Agjentit nga ai Huadhënës sa më parë që të jetë e mundur dhe në çdo rast para se interesi të jetë i kërkueshëm për t'u paguar në lidhje me atë Periudhë Interesi, të jetë ajo që shpreh si normë përqindjeje në vit koston për atë Huadhënës të financimit të kontributit të tij në atë Hua nga cilido burim që mund të përzgjedhë në mënyrë të arsyeshme.

10.2.2 Në këtë Marrëveshje, Ngjarje e Ç'organizimit të Tregut nënkupton:

a) Në mesditë ose rreth mesditës në Datën e Kuotimit për Periudhën përkatëse të Interesit, Norma Zyrtare nuk është e disponueshme dhe asnjë ose vetëm një nga Bankat e Referencës ofron një normë për Agjentin për të përcaktuar EURIBOR-in për Euro për Periudhën përkatëse të Interesit; ose

b) Para mbylljes së orarit zyrtar në Londër në Datën e Kuotimit për Periudhën përkatëse të Interesit, Agjenti merr njoftime nga një Huadhënës ose disa Huadhënës (kontributet e të cilëve në një Hua tejkalojnë 33.33 për qind të asaj Huaje) që kostoja për të ose për ta për sigurimin e depozitave bashkërenduese në Tregun Përkatës Ndërbankar do të ishte më e lartë se EURIBOR-i.

10.3 Baza alternative e interesit ose financimit

10.3.1 Nëse ndodh një Ngjarje e Ç'organizimit të Tregut dhe Agjenti ose Huamarrësi e kërkon këtë, Agjenti dhe Huamarrësi do të hyjnë në bisedime (për një periudhë prej jo më shumë se tridhjet ditë) me synimin për të rënë dakord për një bazë zëvendësuese për përcaktimin e normës së interesit.

10.3.2 Çdo bazë alternative e rënë dakord sipas Klauzolës 0 më sipër, me miratimin paraprak të Huadhënësve dhe Huamarrësit, do të jetë detyruese për të gjitha Palët.

10.4 Shpenzimet për Shlyerjen e Parakohshme

10.4.1 Brenda tre (3) Ditësh Pune nga kërkesa e një Pale Financuese, Huamarrësi do t'i paguajë asaj Pale Financuese Shpenzimet për Shlyerjen e Parakohshme që i atribuohen të gjithë ose një pjese të një Huaje ose një Shume të Papaguar që paguhet nga Huamarrësi në ditën e ndryshme nga dita e fundit e një Periudhe Interesi për atë Hua ose Shumë të Papaguar.

10.4.2 Çdo Huadhënës, sa më parë që të jetë e zbatueshme në mënyrë të arsyeshme, pas një kërkesë nga Agjenti, mund të sigurojë një vërtetim që konfirmon shumën e Shpenzimeve për Shlyerjen e Parakohshme për çdo Periudhë Interesi në të cilën ato rriten.

11 Tarifat

11.1 Tarifa e kontributit

11.1.1 Huamarrësi do t'i paguajë Agjentit (për llogari të secilit Huadhënës) një tarifë të llogaritur në normën e:

a) 0.75 për qind në vit mbi Detyrimin Financiar të vënë në Dispozicion të atij Huadhënësi sipas Shërbimit A për periudhën nga data që bie dhjetë (10) Ditë Pune nga data e kësaj Marrëveshjeje deri në ditën e fundit të Periudhës së Disponueshmërisë, të zbatueshme për Shërbimin A; dhe.

b) 0.75 për qind në vit mbi Detyrimin Financiar të vënë në Dispozicion të atij Huadhënësi sipas Shërbimit B për periudhën nga data që bie pesë (5) Ditë Pune nga data e Detyrimit Financiar të Shërbimit B deri në ditën e fundit të Periudhës së Disponueshmërisë, të zbatueshme për Shërbimin B.

11.1.2 Tarifa e shtuar e detyrimit financiar paguhet në lidhje me çdo Shërbim në ditën me të hershme ndermjet (a) dates se saj teshfrytezimit dhe (b) dites se fundit të Periudhës së Disponueshmërisë dhe, nëse anulohet tërësisht, mbi shumën e anuluar të Detyrimit Financiar të Huadhënësit përkatës në kohën që anulimi hyn në fuqi.

11.2 Tarifat e Rregullimit dhe Bashkërendimit
Huamarrësi do t'i paguajë Rregulluesit tarifat në shumën dhe në kohët e rëna dakord sipas një Letre Tarifore.

11.3 Tarifa e përfaqësimit
Huamarrësi do t'i paguajë Agjentit (për llogarinë e vet) një tarifë përfaqësimi në shumën dhe në kohët e rëna dakord në Letrën Tarifore.

SEKSIONI 6 DETYRIMET E PAGESAVE SHITESË

12 Shuma shtesë e taksave dhe zhdëmtimet

12.1 Përkufizime

12.1.1 Në këtë Marrëveshje:

Palë e Mbrojtur nënkupton një Palë Financuese që i nënshtrohet ose do t'i nënshtrohet një përgjegjësie ose që i kërkohet të bëjë pagesë për ose në llogari të Taksës në lidhje me një shumë të marrë ose të pritshme (ose ndonjë shumë të synuar për qëllimet e Taksës që duhet të merret ose pritët) sipas një Dokumenti Financimi.

Kredi Takse nënkupton një kredi kundrejt zbutjes ose lehtësimit për shlyerjen e një Takse.

Zbritje Takse nënkupton një zbritje ose mbajtje për ose në llogari të taksës nga një pagesë sipas një Dokumenti Financiar.

Pagesë Takse nënkupton ose rritjen në një pagesë të bërë nga Huamarrësi për një Palë Financuese sipas Klauzolës 0 (Shuma shtesë e taksave), ose një pagesë sipas Klauzolës 0 (Zhdëmtimi i Taksës).

12.1.2 Nëse nuk shfaqet një tregues për të kundërtën, në këtë Klauzolë 12 një referencë ndaj përcakton ose përcaktoi nënkupton një përcaktim të bërë sipas zgjedhjes absolute të personit që bën përcaktimin.

12.2 Shuma shtesë e taksave

12.2.1 Huamarrësi do të bëjë të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga ai pa Zbritje Taksash, nëse një Zbritje Takse nuk kërkohet me ligj.

12.2.2 Pas vënies në dijeni që duhet të bëjë një Zbritje Takse (ose që ka ndryshim në normën ose bazën e një Zbritjeje Takse), Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Agjentin në mënyrën e duhur. Gjithashtu, një Huadhënës do të njoftojë Agjentin pasi të vihet në dijeni në lidhje me një pagesë të pagueshme për atë Huadhënës. Nëse Agjenti merr këtë njoftim nga një Huadhënës, ai do të njoftojë Huamarrësin.

12.2.3 Nëse një Zbritje Takse kërkohet me ligj që të bëhet nga Huamarrësi, shuma e pagesës së kërkueshme nga Huamarrësi do të rritet në një shumë që (pas Zbritjes së Taksës) sjell një shumë të barabartë me pagesën që do të kishte qënë e kërkueshme nëse nuk do të ishte kërkuar një Zbritje Takse.

12.2.4 Nëse Huamarrësit i kërkohet të bëjë një Zbritje Takse, Huamarrësi duhet ta bëjë atë Zbritje Takse dhe çdo pagesë të kërkuar në lidhje me atë Zbritje Takse brenda kohës së lejuar dhe në shumën minimale të kërkuar me ligj.

12.2.5 Brenda tridhjet ditëve nga bërja ose e një Zbritjeje Takse, ose e një pagese të kërkuar në lidhje me atë Zbritje Takse, Huamarrësi që bën atë Zbritje Takse, do t'i dorëzojë Agjentit për Palën Financuese që ka të drejtën e pagesës, prova të pranueshme në mënyrë të arsyeshme për atë Palë Financuese që Zbritja e Taksës është bërë ose (sipas rastit) një pagesë të përshtatshme të paguar ndaj autoritetit përkatës taksues.

12.3 Zhdëmtimi i taksës

12.3.1 Huamarrësi (brenda tre (3) Ditësh Pune nga kërkesa e Agjentit), do t'i paguajë një Palë të Mbrojtur një shumë të barabartë me humbjen, detyrimin ose koston që Pala e Mbrojtur përcakton se do të pësohet ose është pësuar (drejtpërdrejt ose jo) për ose në llogari të Taksës nga ajo Palë e Mbrojtur në lidhje me një Dokument Financiar.

12.3.2 Klauzola 0 më sipër nuk do të zbatohet:

a) Në lidhje me një Taksë të vlerësuar mbi një Palë Financuese:

i) Sipas ligjit të juridiksionit në të cilin Pala Financuese është inkuorporuar ose, nëse është e ndryshme, në juridiksionin (ose juridiksionet) në të cilat ajo Palë Financuese është trajtuar si rezidente për qëllime tatimore; ose

ii) Sipas ligjit të juridiksionit në të cilin ndodhet Zyra e Shërbimit të asaj Pale Financuese në lidhje me shumatat e marra ose të pritshme në atë juridiksion,

Nëse ajo Taksë vendoset mbi ose llogaritet duke iu referuar të ardhurave neto të marra ose të pritshme (por jo ndonjë shume që konsiderohet të jetë marrë ose pritur) nga ajo Palë Financuese; ose

b) Në shkallën që një humbje, detyrim ose kosto kompensohet nga një pagesë e rritur sipas Klauzolës 0 (Shuma Shtesë e Taksave).

12.3.3 Një Palë e Mbrojtur që ngre ose synon të ngrejë një pretendim sipas Klauzolës 0 më sipër, do të njoftojë menjëherë Agjentin për ngjarjen që do të shkaktojë ose ka shkakuar pretendimin, pas të cilës Agjenti do të njoftojë Huamarrësin.

12.3.4 Pas marrjes së një pagese nga Huamarrësi sipas kësaj Klauzole 12.3, një Palë e Mbrojtur do të njoftojë Agjentin.

12.4 Kredia e Taksës

Nëse Huamarrësi bën një Pagesë Takse dhe Pala Financuese përkatëse përcakton se:

12.4.1 Një Kredi Takse është e atribueshme ose ndaj një pagese të rritur pjesë e të cilës është ajo Pagesë Takse, ose ndaj asaj Pagese Takse; dhe

12.4.2 Ajo Palë Financiare ka përfutur, shfrytëzuar dhe mbajtur atë Kredi Takse,

Pala Financiare do t'i paguajë një shumë Huamarrësit që ajo Palë Financuese përcakton se do ta lërë atë (pas pagesës) në të njëjtën gjendje që mbetet pas taksave, siç do të kishte qënë nëse Pagesa e Taksës nuk do të ishte kërkuar të bëhej nga Huamarrësi.

12.5 Taksat e pullës

Huamarrësi do të paguajë dhe brenda tre (3) Ditësh Pune nga kërkesa, do të zhdëmtojë çdo Palë Financuese kundrejt çdo kostoje, humbjeje ose detyrimi që Pala Financuese shkakton në lidhje me të gjitha detyrimet e pullave, regjistrimin dhe taksa të ngjashme të pagueshme në lidhje me një Dokument Financiar.

12.6 Taksa mbi vlerën e shtuar

12.6.1 Të gjitha shumatat e përcaktuara ose që shprehen për të qënë të pagueshme sipas një Dokumenti Financiar nga një Palë për një Palë Financuese që (tërësisht ose pjesërisht) përbëhen pagesë për qëllime TVSH-je, do të konsiderohen të jenë ekskluzive për një TVSH që i faturohet atij furnizimi, dhe në mënyrën e duhur, në bazë të Klauzolës 0 më poshtë, nëse TVSH-ja i faturohet ndonjë furnizimi të bërë nga një Palë Financuese ndaj një Pale sipas një Dokumenti Financiar që Pala do t'i paguajë Palës Financuese (si shtesë ndaj dhe njëkohësisht si pagesë e tarifës) një shumë të barabartë me shumën e TVSH-së (dhe kjo Palë Financuese do të japë menjëherë një faturë të përshtatshme TVSH-je për atë Palë).

12.6.2 Nëse TVSH-ja faturohet mbi një furnizim të bërë nga një Palë Financuese (Furnizuesi) ndaj një Pale tjetër Financuese (Marrësi) sipas një Dokumenti Financiar dhe një Palë (Pala Përkatëse) kërkohet në bazë të kushteve të një Dokumenti Financiar, që të paguajë një shumë të barabartë me pagesën për atë furnizim ndaj Furnizuesit (më tepër sesa t'i kërkohet të riimburojë Marrësin në lidhje me atë pagesë), ajo Palë do t'i paguajë gjithashtu Furnizuesit (si shtesë dhe njëkohësisht si pagesë të kësaj shume) një shumë të barabartë me shumën e kësaj TVSH-je. Marrësi do t'i paguajë menjëherë Palës Përkatëse një shumë të barabartë me një kredi ose shlyerje nga autoriteti përkatës tatimor që përcakton në mënyrë të arsyeshme se ka lidhje me TVSH-në e faturueshme mbi atë furnizim.

12.6.3 Kur një Dokument Financiar kërkon që një Palë të riimburojë një Palë Financuese për një kosto ose shpenzim, ajo Palë njëkohësisht do të paguajë dhe zhdëmtojë Palën Financuese kundrejt të gjitha TVSh-ve të shkaktuara nga Pala Financuese në lidhje me kostot ose shpenzimet në shkallën që Pala Financuese përcakton në mënyrë të arsyeshme se as ajo, as ndonjë anëtar i grupit në të cilin është anëtare për qëllime TVSH-je, ka të drejtën e kredisë ose shlyerjes nga autoriteti përkatës tatimor në lidhje me TVSH-në.

13 Kostot e rritura

13.1 Kostot e rritura

13.1.1 Në bazë të Klauzolës 0 (Përfuturimi) Huamarrësi, brenda tre (3) Ditësh Pune nga një kërkesë e Agjentit, do të paguajë për llogari të një Pale Financuese shumën e një Kostoje të Rritur të shkakuar nga ajo Palë Financuese ose një prej Degëve të saj si rezultat i (i) prezantimit, ndonjë ndryshimi në (ose në interpretimin, administrimin ose zbatimin e) një ligji ose rregulloreje ose (ii) pajtueshmëri me një ligj ose rregullore të bërë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

13.1.2 Në këtë Marrëveshje, Kosto të Rritura nënkuptojnë:

- a) Një zbritje në normën e kthimit nga një Shërbim ose mbi kapitalin e përgjithshëm të një Pale Financuese (ose të degës së saj);
- b) Një kosto shtesë ose të rritur; ose
- c) Një zbritje të një shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas ndonjë Dokumenti Financiar, që shkaktohet ose pësohet nga një Palë Financuese ose ndonjë prej Degëve të saj në shkallën që i atribuohet asaj Pale Financuese që është angazhuar në Detyrimin e saj Financiar ose financimin ose përmbushjen e detyrimeve të saj sipas një Dokumenti Financiar.

13.2 Pretendimet e kostove të rritura

13.2.1 Një Palë Financuese që synon të ngrejë një pretendim sipas Klauzolës 0 (Kostot e Rritura) do të njoftojë Agjentin për ngjarjen që shkakton pretendimin, pas të cilës Agjenti do të njoftojë menjëherë Huamarrësin.

13.2.2 Çdo Palë Financuese, sa më parë që të jetë e mundur pas një kërkesë nga Agjenti, do të japë një vërtetim që konfirmon shumën e Kostove të saj të Rritura.

13.3 Përjashtimet

13.3.1 Klauzola 0 (Kostot e Rritura) nuk zbatohet në shkallën që një Kosto e Rritur:

- a) I atribuohet një Zbritjeje Takse të kërkuar me ligj që duhet të bëhet nga Huamarrësi;
- b) Është kompensuar në bazë të Klauzolës 0 (Zhdëmtimi i Taksës) (ose do të kishte qënë kompensuar sipas Klauzolës 0 (Zhdëmtimi i Taksës) por nuk është kompensuar në këtë mënyrë vetëm sepse është zbatuar ndonjë prej përjashtimeve në Klauzolën 0 (Zhdëmtimi i Taksës));
- c) Është kompensuar nga pagesa e Kostos së Detyrueshme sipas Klauzolës 14.4 (zhdëmtimi i pajtueshmërisë së kostos së Bankës Qëndrore); ose
- d) I atribuohet shkeljes me dashje nga Pala Financuese ose Degët e saj të ndonjë ligji ose rregulloreje.

13.3.2 Në këtë Klauzolë 0, një referencë ndaj një Zbritjeje Takse ka të njëjtin kuptim të dhënë termit në Klauzolën 0 (Përkufizimet).

14 Zhdëmtime të tjera

14.1 Zhdëmtimi i monedhës

14.1.1 Nëse një shumë e kërkueshme nga Huamarrësi sipas Dokumentave Financiare (një Shumë) ose një urdhër, gjykim ose vendim i dhënë ose i bërë në lidhje me një Shumë, duhet të konvertohet nga monedha (Monedha e Parë) në të cilën ajo Shumë është e pagueshme në një monedhë tjetër (Monedha e Dytë) për qëllimin e:

- a) ngritjes ose depozitimit të një pretendimi ose prove kundër Huamarrësit;
- b) marrjes ose zbatimit të një urdhri, gjykimi ose vendimi në lidhje me një proces gjyqësor ose procedim arbitrazhi,

Huamarrësi, në kuadrin e një detyrimi të pavarur, brenda tre (3) Ditësh Pune, do të zhdëmtojë çdo Palë Financuese ndaj të cilës Shuma është e kërkueshme kundrejt çdo kostoje, humbjeje ose detyrimi që lind nga ose si rezultat i konvertimit, duke përfshirë çdo mospërputhje midis (A) kursit të këmbimit që përdoret për të konvertuar shumën në fjalë nga monedha e parë në monedhën e dytë dhe (B) normës ose normave të këmbimit në dispozicion të atij personi në kohën e marrjes nga ai të asaj Shume.

14.1.2 Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë në një juridiksion për të paguar ndonjë shumë sipas Dokumentave të Financimit në një monedhë ose njësi monedhe të ndryshme nga ajo në të cilën është shprehur që të jetë e pagueshme.

14.2 Zhdëmtime të tjera

Brenda tre (3) Ditësh Pune nga kërkesa, Huamarrësi do të zhdëmtojë çdo Palë Financuese kundrejt çdo kostoje, humbjeje ose detyrimi të shkakuar nga ajo Palë Financuese si rezultat i:

14.2.1 Ndodhjes së një Ngjarjeje të Mosplotësimit të Detyrimeve;

14.2.2 Një dështimi nga ana e Huamarrësit për të paguar ndonjë shumë të kërkueshme sipas një Dokumenti Financiar në datën e duhur, duke përfshirë pa kufizim, çdo kosto, humbje ose detyrim që lind si rezultat i Klauzolës 0 (Ndarja midis Palëve Financuese);

14.2.3 Financimi ose marrja e masave për të financuar kontributin e tij në një Hua të kërkuar nga Huamarrësi në një Kërkesë Shfrytëzimi por që nuk është bërë për shkak të operimit të ndonjë ose më shumë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje (për arsye të tjera nga mosplotësimi i detyrimeve ose neglizhenca vetëm nga ai Huadhënës); ose

14.2.4 Një Hua (ose pjesë e një Huaje) që nuk po parapaguhet në përputhje me një njoftim parapagimi të dhënë nga Huamarrësi.

14.3 Zhdëmtimi ndaj Agjentit

14.3.1 Huamarrësi do të zhdëmtojë menjëherë Agjentin kundrejt çdo kostoje, humbjeje ose detyrimi të shkaktuar nga Agjenti (që vepron në mënyrë të arsyeshme) si rezultat i:

14.3.2 Hetimit të një ngjarjeje që ai beson në mënyrë të arsyeshme se është Mosplotësim Detyrimi; ose

14.3.3 Veprimit ose mbështetjes në një njoftim, kërkesë ose udhëzim që ai beson në mënyrë të arsyeshme të jetë i vërtetë, i saktë dhe i autorizuar në mënyrën e duhur.

14.4 Zhdëmtimi i pajtueshmërisë së kostos së bankës qëndrore

14.4.1 Sipas kërkesës, Huamarrësi do të dëmshpërblejë menjëherë çdo Huamarrës kundrejt çdo shpenzimi ose humbjeje (duke përfshirë Kosto të Detyrueshme, nëse ka) të shkaktuar nga ai Huamarrës si rezultat i përmbushjes së kërkesave (duke përfshirë kërkesat minimale rezervë) të Bankës Qëndrore Europiane dhe/ose Bankës së Anglisë dhe/ose Autoritetit të Shërbimeve Financiare (ose në çdo rast, çdo autoriteti tjetër që zëvendëson të gjitha ose ndonjë prej funksioneve të tyre përkatëse) dhe/ose në lidhje me ruajtjen e rezervave të kërkuara me bankën përkatëse kombëtare qëndrore, në shkallën që kjo pajtueshmëri ka lidhje me Detyrimin Financiar të atij Huadhënësi sipas ndonjë Shërbimi dhe/ose pjesëmarrjes në Hua ose depozita të përfuara nga ai për të financuar të gjithë ose pjesë të këtij kontributi në Huatë.

14.4.2 Agjenti do të njoftojë Huadhënësit dhe Huamarrësin për përcaktimin e Kostos së Detyrueshme të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në të njëjtën kohë që i njofton ata për një normë interesi sipas Klauzolës 8.4 (Njoftimi i normave të interesit) dhe Agjenti do të ketë të drejtë për të kërkuar pagesën e çdo Kostoje të Detyrueshme në lidhje me çdo Periudhë Interesi, ditën e fundit të Periudhës përkatëse të Interesit.

15 Lehtësimi nga Huadhënësit

15.1 Lehtësimi

15.1.1 Çdo Palë Financuese, në konsultim me Huamarrësin, do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të lehtësuar çdo rrethanë që lind dhe që do të çonte në ndonjë shumë që bëhej e pagueshme sipas ose që do të anullohej sipas Klauzolës 0 (Paligjshmëria) ose Klauzolës 0 (Shuma Shtesë e Taksave dhe zhdëmtimet) ose Klauzolës 0 (Kostot e rritura) ose paragrafit 3 të Programit 4 (Formula e Kostos së Detyrueshme) duke përfshirë (por pa u kufizuar në) transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas Dokumentave Financiare për një Filial ose Zyrë tjetër Shërbimi.

15.1.2 Klauzola 0 më sipër në asnjë lloj mënyre nuk kufizon detyrimet e Huamarrësit sipas Dokumentave Financiare.

15.2 Kufizimi i përgjegjësisë

15.2.1 Huamarrësi do të zhdëmtojë çdo Palë Financuese për të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në mënyrë të arsyeshme nga ajo Palë Financuese si rezultat i masave të marra nga ajo sipas Klauzolës 0 (Lehtësimi).

15.2.2 Një Palë Financuese nuk është e detyruar të marrë ndonjë masë sipas Klauzolës 0 (Lehtësimi) nëse, sipas mendimit të asaj Palë Financuese (që vepron në mënyrë të arsyeshme) kjo mund të jetë e dëmshme për të.

16 Kostot dhe shpenzimet

16.1 Shpenzimet e tranzaksioneve

Sipas kërkesës, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë Agjentit dhe Rregulluesit shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (duke përfshirë tarifatat ligjore) të shkaktuara në mënyrë të arsyeshme nga ndonjë prej tyre dhe të shoqëruara me faturat përkatëse (por në bazë të një kufiri prej €150,000 për tarifatat dhe shpenzimet ligjore dhe një kufi prej €5,000 për shpenzime xhepi si udhëtimi, ndihma financiare, akomodimi dhe shpenzimet e korrierit) në lidhje me negociimin, përgatitjen, publikimin, egzekutimin dhe sigurimin e fondeve të:

16.1.1 Kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë prej dokumentave të tjera të përmendura në këtë Marrëveshje; dhe

16.1.2 Çdo Dokument tjetër Financiar të egzekutuar pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

16.2 Kostot e Amendimit

Nëse (një) Huamarrës kërkon një amendim, heqje dorë ose miratim ose (b) një amendim kërkohet sipas Klauzolës 0 (Ndryshimi i monedhës), Huamarrësi, brenda tre (3) Ditësh Pune nga kërkesa, do të riimburojë Agjentin për shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (duke përfshirë tarifatat ligjore) të shkaktuara në mënyrë të arsyeshme nga Agjenti gjatë reagimit, vlerësimit, negociimit ose pajtueshmërisë me atë kërkesë.

16.3 Kostot e ekzekutimit

Brenda tre (3) Ditësh Pune nga kërkesa, Huamarrësi do t'i paguajë çdo Pale Financuese shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve (duke përfshirë tarifatat ligjore) të shkaktuara nga ajo Palë Financuese në lidhje me ekzekutimin ose mbrojtjen e ndonjë të drejte sipas një Dokumenti Financiar.

SEKSIONI 7 PËRFAQËSIMET, SIPËRMARRJET DHE NGJARJET E MOSPLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE

17 Përfaqësimet

Huamarrësi bën përfaqësimet dhe garanci të parashtruara në këtë Klauzolë 0 për secilën Palë Financuese në datën e kësaj Marrëveshjeje dhe siç parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshjeje.

17.1 Statusi

Republika e Shqipërisë është anëtare e rregullt e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe ka të drejtë të përdorë burimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim.

17.2 Detyrimet detyruese

Në bazë të parimeve të përgjithshme të ligjit që kufizojnë detyrimet e tij që i referohen specifikisht ndonjë mendimi ligjor të dhënë sipas Klauzolës 0 (Kushtet e Shfrytëzimit), detyrimet e shprehura për t'u supozuar nga Huamarrësi në çdo Dokument Financimi, janë detyrime ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

17.3 Besimi i plotë dhe kredia

Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë, duke vepruar në emër të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit, ka kompetencën dhe autoritetin e plotë dhe të pakushtëzuar të Huamarrësit për të marrë përsipër Dokumente Financiare në emër të Huamarrësit dhe shpreh besimin e plotë dhe kredinë e Huamarrësit për përmbushjen e duhur nga Huamarrësi të detyrimeve të tij në bazë të Dokumenteve Financiare

17.4 Mosqënia në konflikt me detyrimet e tjera

Përfundimi dhe përmbushja nga ana e tij e tranzaksioneve sipas, dhe në pajtim me dispozitat e Dokumenteve Financiare nuk janë në konflikt dhe nuk do të jenë në konflikt:

me ndonjë ligj, rregullore apo urdhër gjyqësor ose zyrtar, dekret ose leje të Republikës së Shqipërisë ose ndryshe të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë (duke përfshirë ndonjë kufizim mbi shumën maksimale të një Qënieje në Borxh të Jashtëm ose në një borxh tjetër);

17.4.1

17.4.2 me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

17.4.3 nuk konfliktin me, ose si rezultat i një shkeljeje të një prej kushteve të, ose nuk përbën mosplotësim detyrimi, sipas një traktati, marrëveshjeje ose instrumenti tjetër bilateral ose multilateral tek i cili Huamarrësi është palë, ose së cilës i nënshtrohet ai ose një prej pasurive të tij; ose

17.4.4 nuk rezulton në krijimin ose caktimin, apo nuk detyron Huamarrësin për të krijuar ndonjë rëndim barrësor mbi ndonjë nga sendet pasurore, të drejtat ose të ardhurat e Huamarrësit.

17.5 Kompetenca dhe autoriteti

Huamarrësi ka (ose, para datës së Kërkesës së parë të Shfrytëzimit, do të ketë) kompetencën për t'u angazhuar në, përmbushur dhe dorëzuar dhe ka (ose, para datës së Kërkesës së parë të Shfrytëzimit, do të ketë) marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar angazhimin e saj në, përmbushjen dhe dorëzimin e Dokumentave Financiare dhe tranzaksionet e parashikuara nga Dokumentat Financiare.

17.6 Vlefshmëria dhe pranueshmëria e plotë

Të gjitha Autorizimet e kërkuara:

17.6.1 Për t'a mundësuar Huamarrësin të angazhohet në mënyrë të ligjshme për të ushtruar të drejtat e tij dhe për të përmbushur detyrimet e tij sipas Dokumentave Financiare;

17.6.2 Për të siguruar që detyrimet e shprehura që duhet të supozohen nga Huamarrësi në Dokumentat Financiare janë të ligjshme, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme; dhe

17.6.3 Për të bërë Dokumentat Financiare të pranueshme plotësisht në Republikën e Shqipërisë, Kanë qënë (ose para datës së Kërkesës së parë të Shfrytëzimit, do të kenë qënë) përfutur ose bërë dhe janë (ose, para datës së Kërkesës së parë të Shfrytëzimit, do të jenë) në fuqi dhe efekt të plotë.

17.7 Ligji rregullues dhe zbatimi

Në bazë të ndonjë rezerve specifike në mendimin ligjor të përmendur në paragrafin 0 të 0 (Kushtet Paraprake):

17.7.1 Zgjedhja e ligjit anglez si ligji rregullues i Dokumentave Financiare do të pranohet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë;

17.7.2 Çdo vendim i marrë në gjykatat e Anglisë në lidhje me një Dokument Financiar do të pranohet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë;

17.7.3 Një vendim i Gjykatës LCIA ose ndonjë pasardhëseje të saj në lidhje me një Dokument Financiar do të pranohet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë; dhe

17.7.4 Çdo heqje dorë nga imuniteti nga ana e Huamarrësit në ndonjë Dokument Financiar do të pranohet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

17.8 Zbritja e Taksës

Nuk kërkohet të bëjë zbritje për ose në llogari të Taksës nga ndonjë pagesë që mund të bëjë sipas një Dokumenti Financiar.

17.9 Mosdepozitimi ose taksat e pullës

Sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë, nuk është e nevojshme që Dokumentat Financiare të depozitohen ose regjistrohen pranë një gjykate ose autoriteti tjetër në atë juridiksion ose që ndonjë pullë, regjistrim ose taksë e ngjashme të paguhet mbi ose në lidhje me Dokumentat Financiare ose tranzaksionet e parashikuara nga Dokumentat Financiare.

17.10 Mosplotësimi i detyrimeve

17.10.1 Asnjë Ngjarje e Mosplotësimi të Detyrimeve nuk vazhdon ose mund të pritej në mënyrë të arsyeshme të rezultonte nga kryerja e ndonjë Shfrytëzimi.

17.10.2 Asnjë ngjarje apo rrethanë tjetër nuk është e pezulluar që përbën mosplotësim të detyrimeve sipas ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti tjetër që është detyrues mbi to ose të cilave i nënshtrohen sendet e tyre pasurore që mund të priteshin në mënyrë të arsyeshme të kishin Ndikim Material Negativ.

17.11 Renditja pari passu; detyrimet e drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara

Detyrimet e Huamarrësit sipas Dokumenteve Financiare janë të drejtpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara të Huamarrësit dhe renditen të paktën me të njëjtën preferencë si të gjithë detyrimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguarur dhe jo të varur.

17.12 Mungesa e procedimeve të mbartura ose të synuara

Nuk ka filluar ose synuar kundër tij asnjë proces gjyqësor, arbitrazh ose procedurë administrative ose para një gjykate, organi arbitrazhi ose subjekti (sipas njohurisë dhe besimit të tij më të mirë), që kanë të ngjarë në mënyrë të arsyeshme të ishin përcaktuar me ndikim negativ dhe nëse do të ishin përcaktuar në këtë mënyrë, mund të priteshin në mënyrë të arsyeshme të kishin Ndikim Material Negativ.

17.13 Mungesa e imunitetit, të drejtës private dhe ligjeve tregtare

Me përjashtim të sendeve pasurore që parashikohen në dispozitat e Nenit 11, paragrafi 2 i Kushtetutës Shqiptare dhe në bazë të dispozitave të Ligjit Shqiptar nr 8743, datë 22 shkurt 2001 “Mbi Pasurinë e Paluajtshme Shtetërore” në lidhje me pronën publike dhe regjimin e saj ligjor:

17.13.1 Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil dhe tregtar në lidhje me detyrimet e tij sipas Dokumentave Financiare;

17.13.2 çdo huamarrje nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja e detyrimeve të tij sipas Dokumenteve Financiare nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare të bëra për qëllime private dhe tregtare; dhe

17.13.3 as Huamarrësi dhe asnjë prej sendeve të tij pasurore nuk ka të drejtën e imunitetit për shkaqe të sovranitetit ose ndryshe nga veprimet ose procedimet ligjore (që përfshijnë, pa kufizim, padinë, sigurimin e padisë para vendimit, ekzekutimin apo një përmbushje tjetër ose proces ligjor) të marrë në Angli, Republikën e Shqipërisë ose diku tjetër dhe heqja dorë që parashikohet në klauzolën 18.3 (heqja dorë) e secilës prej këtyre të drejtave të imunitetit është e pakthyeshme dhe detyruese për Huamarrësin.

17.14 Pasqyrat

Pasqyrat e bilanceve të pagesave të Huamarrësit në lidhje me vitin kalendarik që përfundon më 31 dhjetor 2009 që i jepet Agjentit është përgatitur sipas standardit të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe deklarata për përbërjen e zotërimeve të floririt, këmbimit valutor dhe Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes të Huamarrësit në lidhje me vitin kalendarik që përfundon më 31 dhjetor 2008 që i jepet Agjentit, është e vërtetë, e plotë dhe e saktë në të gjitha aspektet.

17.15 Mungesa e ndryshimit material negativ

Nuk ka patur ndryshim material negativ në sendet pasurore, pozicionin financiar ose perspektivat e Huamarrësit nga ai i përcaktuar në pasqyrat e përmendura në klauzolën 17.14.

17.16 Pëlqimet dhe liçencat

çdo pëlqim, autorizim, liçencë ose miratim që kërkohet nga Huamarrësi në lidhje me zhvillimin e biznesit të tij dhe pronësinë, përdorimin, shfrytëzimin ose zënien e pasurive ose sendeve pasurore të tij është marrë dhe është në fuqi dhe efekt të plotë, dhe nuk ka patur mosplotësim detyrimi në lidhje me respektimin e kushteve dhe kufizimeve (sipas rastit) të vendosura, ose, në lidhje me këtë, sipas dijenisë së Huamarrësit nuk ka lindur asnjë rrethanë për shkak të së cilës është i nevojshëm një masë korrigjuese nga, ose me shpenzime të Huamarrësit, sipas ose në pajtim me ligjin ose rregulloren e zbatueshme për biznesin, pasurinë ose sendet pasurore të Huamarrësit

17.17 Informacioni

17.17.1 Çdo informacion i dhënë nga ose në emër të Huamarrësit për Palët Financuese në lidhje me negociimin dhe përgatitjen e Dokumentave Financiare është i vërtetë, i plotë dhe i saktë në të gjitha aspektet materiale në kohën që është dhënë ose bërë.

17.17.2 Nuk ka fakte, rrethana ose ndonjë informacion tjetër që mund ta bënte informacionin e dhënë Palëve Financuese të pavërtetë, të paplotë, të pasaktë ose ç'orientues në ndonjë aspekt material.

17.17.3 Informacioni i dhënë Palëve Financuese nuk përjashton diçka që mund ta bënte informacionin të pavërtetë, të paplotë, të pasaktë ose ç'orientues në ndonjë aspekt material.

17.17.4 Të gjitha mendimet, përshkrimet, parashikimet ose shprehjet e synimit në përmbajtje të informacionit dhe supozimeve mbi të cilat ato bazohen, kanë mbërritur pas analizës dhe shqyrtimit të duhur dhe të kujdesshëm nga ose në emër të [Ministrit të Financave dhe/ose Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë] dhe besohen vërtet të jenë të arsyeshme nga ta dhe Huamarrësi që nga data në të cilën ato janë dhënë ose bërë; dhe ishin bazuar në informacionin më të mirë në dispozicion të tyre dhe Huamarrësit në atë kohë dhe janë të drejta dhe të arsyeshme në të gjitha rrethanat.

17.17.5 Për qëllimet e klauzolës 0, Informacion nënkupton çdo informacion të dhënë nga ose në emër të Huamarrësit për Palët Financuese në lidhje me këtë Marrëveshje.

17.18 Taksat

Ai ka depozituar të gjitha deklaratat tatimore dhe informacionin mbështetës që kërkohet të depozitohet nga Huamarrësi në një juridiksion përkatës dhe ka paguar ose shlyer të gjitha Taksat e kërkueshme dhe të pagueshme nga ai në ose para datës së duhur me përjashtim të atyre që janë refuzuar në mirëbesim nga procedime të përshtatshme dhe për të cilat janë dhënë rezerva të mjaftueshme, në përputhje me IFRS dhe në shkallën që Taksat nuk janë ende të kërkueshme dhe të pagueshme, ka dhënë rezerva të mjaftueshme për pagesën e atyre Taksave në përputhje me IFRS.

17.19 Përdorimi i të Ardhurave

Të ardhurat nga Përdorimet do të përdoren nga Huamarrësi për qëllimet e përshkruara në Klauzolën 0 (Qëllimi).

17.20 Përsëritja

Përfaqësimet mendohet të përsëriten nga Huamarrësi duke iu referuar fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë ditë të çdo Kërkese për Përdorim dhe në ditën e parë të secilës Periudhë Interesi.

18 Sipërmarrjet për informacion

Sipërmarrjet në këtë Klauzolë 0 mbesin në fuqi nga data e kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që një shumë është e papaguar sipas Dokumentave Financiare ose ndonjë Detyrim Financiar është në fuqi.

18.1 Informacioni

Huamarrësi do t'i japë menjëherë Agjentit (në kopje të mjaftueshme për të gjithë Huadhënësit, nëse Agjenti e kërkon këtë) pasi të jetë vënë në dijeni për to, hollësisht në lidhje me një proces gjyqësor, arbitrazh ose procedurë administrative që janë aktuale, të synuara ose të mbartura kundër Huamarrësit ose ndonjë Subjekti Shtetëror dhe që ka të ngjarë në mënyrë të arsyeshme të ishin përcaktuar me ndikim negativ dhe nëse do të ishin përcaktuar kështu, mund të pritëshin në mënyrë të arsyeshme të kishin

Ndikim Material Negativ.

18.2 Njoftimi i mosplotësimit të detyrimeve

18.2.1 Menjëherë sapo të vihet në dijeni për këtë, Huamarrësi do të informojë Agjentin për çdo ngjarje të mosplotësimit të detyrimeve (dhe për masat, nëse ka, që duhet të merren për ta ndrequr atë).

18.2.2 Në bazë të një kërkesë nga Agjenti, Huamarrësi do t'i japë menjëherë Agjentit një certifikatë të nënshkruar nga një nënshkrues i autorizuar të Huamarrësit që vërteton se nuk vazhdon asnjë Mosplotësim Detyrimi (ose nëse vazhdon një Mosplotësim Detyrimi, që specifikon Mosplotësimin e Detyrimit dhe masat, nëse ka, të cilat duhet të merren për ta ndrequr atë).

18.3 Dorëzimi i pasqyrave

Brenda nëntëdhjet (90) ditësh pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Huamarrësi do t'i dorëzojë Agjentit, për t'ia shpërndarë Huadhënësve dhe në kopje të mjaftueshme për të gjithë Huadhënësit një pasqyrë të bilancit të pagesave të Huamarrësit për këtë periudhë, të përgatitur në formën standarde të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe një pasqyrë të përbërjes së zotërimeve të floririt, këmbimit valutor dhe Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes të Huamarrësit që nga përfundimi i kësaj periudhe;

18.4 Raporti vjetor

Menjëherë pas publikimit të tij, Huamarrësi do t'i dorëzojë Agjentit për ta shpërndarë tek Huadhënësit dhe në kopje të mjaftueshme për të gjithë Huadhënësit, raportin vjetor të Bankës së Shqipërisë.

18.5 Dhënia e informacionit shtesë

Huamarrësi do t'i japë Agjentit atë informacion tjetër në lidhje me gjendjen financiare dhe monetare të Huamarrësit ose gjendjen financiare të ndonjë Agjencie Shtetërore që Agjenti ose çdo Huadhënës (që vepron nëpërmjet Agjentit) mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

18.6 Miratimi i legjislacionit

Huamarrësi do të informojë menjëherë Agjentin për miratimin e çdo legjislacioni ose ndodhinë e një ngjarjeje tjetër si rezultat i të cilës, nëse janë dhënë mendime (të ndryshme nga paragrafi 4 (h) në lidhje me Taksat të Programit 7 (Formulari i Mendimit Ligjor të Huamarrësit) ose në kuptimin (të ndryshëm nga paragrafi 3 (h) në lidhje me Taksat e Programit 8 (Formulari i Mendimit Ligjor Shqiptar të Huamarrësve) menjëherë pas kësaj ndodhie, një mendim i tillë nuk do të ishte i vërtetë dhe i saktë në të gjitha aspektet

18.7 Kontrollat ose procedurat "Njihni klientin tuaj"

18.7.1 Nëse:

a) Prezantimi i ndonjë ndryshimi në (ose në interpretimin, administrimin ose zbatimin) e një ligji ose rregulloreje të bërë pas datës së kësaj Marrëveshjeje;

b) Ndonjë ndryshim në statusin e Huamarrësit pas datës së kësaj Marrëveshjeje; ose

c) Një transferim i propozuar nga një Huadhënës për ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje për një palë që nuk është Huadhënës para këtij transferimi,

Detyron Agjentin ose ndonjë Huadhënës (ose, në rastin e paragrafit (c) më sipër, ndonjë Huadhënës i ri i mundshëm) të pajtohet me procedurën -njihni klientin tuaj- ose procedura të ngjashme identifikimi në rrethana ku informacioni i nevojshëm nuk i është vënë tashmë në dispozicion, Huamarrësi, menjëherë pas kërkesës së Agjentit ose Huadhënësit, do të japë ose kërkojë dhënien e këtij dokumentacioni dhe prova të tjera që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Agjenti (për vete ose në emër të Huadhënësit) ose ndonjë Huadhënës (për vete ose në rastin e ngjarjes së përshkruar në paragrafin (c) më sipër, në emër të ndonjë Huadhënësi të ri të mundshëm) me qëllim që Agjenti, ky Huadhënës ose në rastin e ngjarjes së përshkruar në paragrafin (c) më sipër, ndonjë Huadhënës të ri të mundshëm, të kryejë dhe të sigurohet që ka përmbushur të gjitha procedurat e nevojshme -njihni klientin tuaj- ose kontrole të tjera të ngjashme sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme, në përputhje me tranzaksionet e parashikuara në Dokumentat Financiare.

18.7.2 Çdo Huadhënës, menjëherë pas kërkesës së Agjentit, do të japë ose kërkojë dhënien e këtij dokumentacioni dhe provave të tjera që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Agjenti (për vete) me qëllim që Agjenti të kryejë dhe të sigurohet që ka përmbushur të gjitha procedurat e nevojshme - njihni klientin tuaj- ose kontrole të tjera të ngjashme sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme, në përputhje me tranzaksionet e parashikuara në Dokumentat Financiare.

19 Sipërmarrje të përgjithshme

Sipërmarrjet në këtë Klauzolë 0 mbesin në fuqi nga data e kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që një shumë është e papaguar sipas Dokumentave Financiare ose ndonjë Detyrim Financiar është në fuqi.

19.1 Autorizimet

Huamarrësi menjëherë:

a) Do të përftojë, përmbushë dhe bëjë gjithçka që është e nevojshme për të ruajtur në fuqi dhe efekt të plotë; dhe

b) Nëse kërkohet, do t'i japë Agjentit kopje të vërtetuara të,

çdo Autorizimi të kërkuar sipas ndonjë ligji ose rregulloreje të Republikës së Shqipërisë apo Anglisë për t'i mundësuar atij të përmbushë detyrimet e tij sipas Dokumentave Financiare dhe për të siguruar ligjshmërinë, vlefshmërinë, egzekutueshmërinë ose pranueshmërinë e plotë në Republikën e Shqipërisë ose Angli të Dokumentave Financiare.

19.2 Pajtueshmëria me ligjet

Huamarrësi do të përmbushë dhe marrë masa që çdo Subjekt Qeveritar, funksionet kompetencat, operacionet dhe aktivitetet e të cilit lidhen me qëllimin ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, të pajtohen në të gjitha drejtimit me të gjitha ligjet, dekretet, rregulloret dhe çdo rregull të cilit mund t'i nënshtrohen, nëse pamundësia për t'u pajtuar do të çenonte materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Dokumentave Financiare.

19.3 Renditja pari passu; detyrimet e drejtëpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara

Huamarrësi do të sigurojë që pagesat e detyrimeve të tij sipas Dokumentave Financiare të jenë kurdoherë detyrime të drejtëpërdrejta, të përgjithshme dhe të pakushtëzuara të Huamarrësit dhe të renditen të paktën me të njëjtën preferencë si të gjithë detyrimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar dhe jo të varura.

19.4 Banka e Shqipërisë

19.4.1 Huamarrësi do të sigurojë që Banka e Shqipërisë do t'i ofrojë Huamarrësit kurdoherë fonde lehtësisht të transferueshme dhe të disponueshme në Euro dhe çdo miratim që mund të jetë i nevojshëm për t'u marrë nga Banka e Shqipërisë, me qëllim që t'i mundësohet Huamarrësit të përmbushë të gjitha detyrimet e tij për pagesa në Euro sipas Dokumentave Financiare, siç dhe kur ato bëhen të kërkueshme

19.4.2 Huamarrësi do të sigurojë që Banka e Shqipërisë ka kurdoherë të drejta të plota të pronësisë mbi sendet pasurore dhe rezervat monetare ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe merr masa që Banka e Shqipërisë të ushtrojë kurdoherë autoritet, kompetencë dhe kontroll të plotë mbi to.

19.5 Përdorimi i të ardhurave

Huamarrësi do të përdorë të ardhurat e Shfrytëzimeve sipas kësaj Marrëveshjeje ekskluzivisht për qëllimet e specifikuar në Klauzolën 3.1 (Qëllimi).

19.6 Taksat

Huamarrësi do të :

19.6.1 Depozitohë të gjitha deklaratat tatimore që kërkohen për t'u depozituar nga ai në ndonjë juridiksion; dhe

19.6.2 Do të paguajë menjëherë të gjitha Taksat kur janë të kërkueshme dhe të pagueshme (ose brenda periudhave të zbatueshme për shtyrjen e afatit, të lejuara nga ndonjë rregullore) të ndryshme nga ato që kundërshtohen nga ai në mirëbesim dhe për të cilat rezerva të mjaftueshme janë bërë ose duhet të bëhen në përputhje me IFRS.

19.7 Pengu Negativ

Huamarrësi nuk do të lejojë:

19.7.1 asnjë Rëndim Barrësor nga Huamarrësi të ekzistojë, lindë, krijohet ose zgjerohet mbi të gjithë ose një pjesë të ndërmarrjes, sendeve pasurore, të drejtave, ose të ardhurave së tyre përkatëse të tashme dhe të ardhshme, të Huamarrësit, për të siguruar ose preferuar ndonjë qenie në borxh të tashme ose të ardhshme të Huamarrësit; ose

ansjë nga detyrimet e Huamarrësit të garantohet nga ndonjë person tjetër,

19.7.2 përveç rasteve kur ky Rëndim Barrësor ose përfitim nga kjo garanci, apo mjet tjetër për sigurimin e kredisë që Huadhënësit e Shumicës mund ta konsiderojnë ekuivalente me të, shtrihet në të njëjtën kohë në mënyrë të barabartë dhe proporcionale me detyrimet e Huamarrësit sipas Dokumentave Financiare që pranohen nga Agjenti.

20 Ngjarje të Mosplotësimit të Detyrimeve

Secila prej ngjarjeve ose rrethanave të përcaktuara në Klauzolën 20 është një Ngjarje e Mosplotësimit të Detyrimeve (me përjashtim të Klauzolës 20.19 (Përshpejtimi)).

20.1 Mospagesa

Mospagesa: Huamarrësi nuk paguan në datën e kërkueshme një shumë të pagueshme sipas një Dokumenti Financimi në vendin dhe në monedhën në të cilën është shprehur për të qënë e pagueshme nëse pagesa nuk bëhet brenda 3 Ditëve Pune nga data e saj e kërkueshme.

20.2 Detyrime të tjera

20.2.1 Huamarrësi nuk pajtohet me ndonjë dispozitë të Dokumentave Financiare (të ndryshme nga ato të përmendura në Klauzolën 0 (Mospagesa)).

20.2.2 Asnjë Ngjarje e Mosplotësimit të Detyrimeve sipas pikës 0 më sipër, nuk do të ndodhë nëse mospajtueshmëria mund të ndreqet dhe ndreqet brenda 10 Ditësh Pune nga koha më e hershme e (a) dhënies së njoftimit nga Agjenti për Huamarrësin ose (b) Huamarrësi vihet në dijeni për mospërbushjen.

20.3 Kepërfaqësimi

Çdo përfaqësim ose deklaratë e bërë ose që mendohet të jepet nga Huamarrësi në Dokumentet Financiare ose në ndonjë dokument tjetër të dorëzuar nga ose në emër të Huamarrësit sipas ose në lidhje me ndonjë Dokument Financimi, është ose rezulton të ketë qenë e pasaktë ose e gabuar në një aspekt material kur është bërë ose është menduar të jetë bërë.

20.4 Vonesa e dyfishtë

20.4.1 çdo borxh i jashtëm i Huamarrësit ose Subjektit Qeveritar nuk paguhet kur është i kërkueshëm, as brenda periudhës fillimisht të zbatueshme të shtyrjes së afatit.

20.4.2 Çdo borxh i jashtëm i Huamarrësit ose ndonjë Subjekti Shtetëror deklarohet të jetë ose ndryshe bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm para maturitetit të tij të specifikuar si rezultat i një ngjarjeje të mosplotësimit të detyrimit (megjithatë i përshkruar).

20.4.3 Çdo kontribut për një Borxh të Jashtëm të Huamarrësit ose ndonjë Subjekti Shtetëror anulohet ose pezullohet nga një kreditor i Huamarrësit ose ndonjë Subjekt Shtetëror si rezultat i një ngjarjeje të mosplotësimit të detyrimit (megjithatë të përshkruar).

20.4.4 Çdo kreditor i Huamarrësit ose ndonjë Subjekti Shtetëror autorizohet për të deklaruar ndonjë Borxh të Jashtëm të Huamarrësit ose ndonjë Subjekti Shtetëror, të kërkueshëm dhe të pagueshëm para maturitetit të tij të specifikuar si rezultat i një ngjarjeje të mosplotësimit të detyrimeve (megjithatë të përshkruar).

20.4.5 Asnjë Ngjarje e Mosplotësimit të Detyrimeve nuk do të ndodhë sipas kësaj Klauzole 0 nëse shuma e përgjithshme e Qënies në Borxh të Jashtëm ose detyrimi financiar për Qënien në Borxh të Jashtëm që futet brenda klauzolave **Error! Reference source not found.** deri 0 më sipër, është më pak se 1 0,000,000 €(ose ekuivalenti i tij në ndonjë monedhë ose monedha të tjera).

20.5 Paaftësia paguese

Huamarrësi ose ndonjë Subjekt Shtetëror nuk është i aftë ose pranon paaftësinë për të paguar borxhet e tij kur ato bëhen të kërkueshme, pezullon bërjen e pagesave mbi ndonjë prej borxheve të tij ose për shkak të vështirësive faktike ose të mundshme financiare, fillon bisedime me një ose më shumë kreditorë, me synim riplanifikimin e qënies së tij në borxh.

20.6 Procedimet e paaftësisë paguese

20.6.1 Çdo padi, procedim ligjor ose procedurë tjetër ose masë merret në lidhje me:

- Pezullimin e pagesave, një ngrirje të ndonjë qënieje në borxh të Huamarrësit;
- Një marrëveshje, kompromis, transferim ose rregullim me ndonjë kreditor të Huamarrësit;

ose

- Egzekutim të një Rëndimi Barrësor mbi ndonjë prej sendeve pasurore të Huamarrësit,

Ose ndonjë procedurë të ngjashme ose masë është marrë në ndonjë juridiksion.

20.6.2 Çdo Subjekt Shtetëror funksionet, kompetencat, operacionet ose aktivitetet e të cilit kanë lidhje me qëllimin e përmbushjes së kësaj Marrëveshjeje, bën ndonjë padi ose janë filluar procedime ligjore ose janë marrë masa të tjera:

- Që ky Subjekt Shtetëror të gjykohet ose të shpallet i falimentuar ose me paaftësi paguese;

- likuidimi ose shpërndarja e ndonjë Subjekti Shtetëror; ose

c) emërimi i një likuiduesi, administratori, kujdestari, marrësi ose nëpunësi të ngjashëm të një Subjekti të tillë Qeveritar ose e gjitha ose ndonjë pjese e sipërmarrjeve, sendeve pasurore, të drejtave ose

të ardhurave të tij,

ose ndojë procedurë e ngjashme ose masë është marrë në ndonjë juridiksion.

20.7 Ngrirja

Një ngrirje deklarohet ose hyn në fuqi de facto mbi pagesën e të gjitha ose një pjese të konsiderueshme të qënies në borxh të Huamarrësit ose ndonjë Subjekti Shtetëror ose Huamarrësi apo ndonjë Subjekt Qeveritar fillon bisedime me një ose më shumë prej kreditorëve të tij, me synim ripërshatjen e përgjithshme, ristrukturimin ose riplanifikimin e të gjithë ose një pjese të konsiderueshme të qënies së tij në borxh.

20.8 Procesi i kreditorit

Çdo shpronësim, konfiskim, sekuestrim ose egzekutim cënon ndonjë send pasuror ose sendet pasurore të Huamarrësit ose ndonjë Subjekti Shtetëror që ka një vlerë të përgjithshme prej të paktën €25,000,000 dhe nuk është përmbushur brenda 7 ditësh.

20.9 Paligjshmëria

Është ose bëhet e paligjshme për Huamarrësin për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve sipas Dokumentave Financiare.

20.10 Refuzimi

Huamarrësi refuzon një Dokument Financiar ose verifikon një synim për të refuzuar një Dokument Financiar.

20.11 Ndryshimi material negativ

Çdo ngjarje ose një sërë ngjarjesh ndodhin (përfshirë një ndryshim ndaj ndonjë rregulloreje) që, sipas mendimit të Huadhënësve të Shumicës, ka ose ka të ngjarë të kenë në mënyrë të arsyeshme ndryshim material negativ.

20.12 Imuniteti

Huamarrësi është ose bëhet i autorizuar për të pretenduar për vete ose (në shkallën që ato investohen nga Huamarrësi ose Banka e Shqipërisë në aktivitete financiare, tregtare ose industriale ose depozitohen pranë bankave) ndonjë prej sendeve të tij pasurore, imunitetit nga padia, egzekutimi, sekuestrimi ose procesi tjetër ligjor.

20.13 Kufizimet e këmbimit valutor

Huamarrësi:

a) Nuk është i aftë të transferojë ose ruajë fonde në Euro në ose në vendin e pagesës të specifikuar në ndonjë Dokument Financiar si rezultat i refuzimit të ndonjë lejeje ose vendosjes së një kufizimi nga ndonjë autoritet përkatës që çon në paaftësinë e Huamarrësit për të ruajtur të ardhurat e tij të këmbimit valutor jashtë Republikës së Shqipërisë ose për të çelur, ruajtur, financiar dhe operuar llogaritë e tij bankare jashtë Republikës së Shqipërisë; ose

b) Parandalohet nga ndonjë autoritet përkatës të përdorë të ardhurat e këmbimit të tij valuator ose bilancet e llogarive jashtë Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të të gjithë ose ndonjë pjese të detyrimeve të tij sipas ose në lidhje me Dokumentat Financiare,

Dhe si rezultat i këtyre rrethanave, Huamarrësi, sipas mendimit të Huadhënësve të Shumicës, do të kishte të ngjarë në mënyrë të arsyeshme të ishte i paaftë të përmbushte detyrimet e tij të pagesës sipas ndonjë Dokumenti Financiar.

20.14 Anëtarësia e institucioneve ndërkombëtare

Huamarrësi pushon së qënuri anëtar i rregullt i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ose ndonjë pasardhësi të secilit prej tyre, ose do të pushojë të ketë të drejtën për të shfrytëzuar burimet e secilit prej këtyre institucioneve (ose ndonjë pasardhësi të secilit prej tyre).

20.15 Legjislacioni, padia ose paditë

çdo legjislacion propozohet ose miratohet ose një ankim ose procedim para një autoriteti gjyqësor, administrativ, qeveritar ose një autoriteti tjetër fillohet për të parandaluar ose kufizuar përmbushjen nga Huamarrësi të një prej Dokumenteve Financiare ose për të testuar ligjshmërinë, vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e një Dokumenti Financiar nga ana e Huamarrësit.

20.16 Rreziku politik

Republika e Shqipërisë përfshihet në veprimet ushtarake ose luftë civile ose në Republikën e Shqipërisë ka një marrje pushteti nga mjete jokushtetuese ose trazira civile nëse, në një rast të tillë, kjo ngjarje ose rrethanë, sipas mendimit të arsyeshëm të Huadhënësve të Shumicës, ka ose mund të ketë në mënyrë të arsyeshme Ndikim Material Negativ.

20.17 Klasifikimi

Shërbimi i Investitorëve të Moody, Inc klasifikon nën "B3" Qënien në Borxh të Jashtëm afatgjatë të rritur pa kredi dhe të pasiguruar të Republikës së Shqipërisë.

20.18 Ngjarje Materiale

Ndodh një ngjarje tjetër ose lind një rrethanë që, sipas mendimit të Huadhënësve të Shumicës, mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur të gjitha ose ndonjë nga detyrimet sipas ose në pajtim me kushtet e një prej Dokumenteve Financiare.

20.19 Përshpejtimi

Në momentin pas Ngjarjes së Mosplotësimit të Detyrimeve dhe në çdo kohë pas kësaj që vazhdon, dhe nëse kjo kërkohet nga Huadhënësit e Shumicës, me një njoftim drejtuar Huamarrësit, agjenti mund :

20.19.1 Të anulojë Detyrimet e Përgjithshme Financiare pas të cilave do të anulohen menjëherë;

20.19.2 Të deklarojë se të gjitha ose pjesë të Huave, së bashku me interesin e shtuar dhe të gjitha shumat e tjera të rritura ose të papaguara sipas Dokumentave të Financimit të jenë bërë menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, pas të cilave do të bëhen menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme; dhe/ose

20.19.3 Të deklarojë se të gjitha ose pjesë të Huave të jenë të pagueshme sipas kërkesës, pas të cilës do të bëhen menjëherë të pagueshme sipas kërkesës së Agjentit mbi udhëzimet e Huadhënësve të Shumicës.

SEKSIONI 8 NDRYSHIME TEK PALËT

21 Ndryshime tek Huadhënësit

21.1 Kalimi dhe transferimi i të drejtave nga Huadhënësit

Në bazë të kësaj Klauzole 0, një Huadhënës (Huadhënësi Egzistues) mund:

21.1.1 T'i kalojë ndonjë prej të drejtave të tij; ose

21.1.2 T'i transferojë me anë të shtyrjes ndonjë prej të drejtave dhe detyrimeve të tij,

një banke ose institucioni tjetër financiar ose një trusti, fondi ose subjekti tjetër që është i angazhuar rregullisht ose është krijuar për qëllimin e bërjes, blerjes ose investimit në hua, rëndimit barrësor ose aseteve të tjera financiare (Huadhënësi i Ri).

21.2 Kushtet e kalimit ose transferimit të të drejtave

21.2.1 Pëlqimi i Huamarrësit nuk kërkohet për kalimin ose transferimin e të drejtave nga një Huadhënës Egzistues.

21.2.2 Një kalim të drejtash do të jetë efektiv vetëm:

a) Me marrjen nga Agjenti të konfirmimit me shkrim nga Huadhënësi i Ri (në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Agjentin) që Huadhënësi i Ri do të marrë përsipër të njëjtat detyrime ndaj Palëve të tjera Financiare siç do të kishte qënë nëse do të ishte një Huadhënës Fillestar; dhe

b) Me përmbushjen nga Agjenti të të gjithë procedurës së nevojshme "njihni klientin tuaj" ose kontroleve të tjera të ngjashme sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në lidhje me këtë kalim të drejtash ndaj një Huadhënësi të Ri, përfundimin e të cilës Agjenti do t'ia njoftojë menjëherë Huadhënësit Egzistues dhe Huadhënësit të Ri.

21.2.3 Një transferim do të jetë efektiv vetëm nëse është përmbushur procedura e parashtruar në Klauzolën 0 (Procedura për transferim).

21.2.4 Nëse:

a) Një Huadhënës kalon ose transferon ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas Dokumentave Financiare ose ndryshon Zyrën e Shërbimit të tij; dhe

b) Si rezultat i rrethanave egzistuese në datën që ndodh kalimi i të drejtave, transferimi ose ndryshimi, Huamarrësi do të ishte i detyruar t'i bënte një pagesë Huadhënësit të Ri ose Huadhënësit që vepron përmes Zyrës së tij të re të Shërbimit sipas Klauzolës 0 (Shuma Shtesë e Taksave dhe zhdëmtimet) ose Klauzolës 0 (Kostot e Rritura).

Atëherë, Huadhënësi i Ri ose Huadhënësi që vepron përmes Zyrës së tij të re të Shërbimit, ka të drejtë të marrë vetëm pagesat sipas atyre klauzolave në të njëjtën shkallë që Huadhënësi Egzistues ose Huadhënësi që vepron përmes Zyrës së tij të mëparshme të Shërbimit, do të kishte qënë nëse kalimi i të

drejtave, transferimi ose ndryshimi nuk do të kishte ndodhur.

21.3 Tarifa e kalimit ose transferimit të të drejtave

Huadhënësi i ri, në datën në të cilën një kalim ose transferim të drejtash hyn në fuqi, do t'i paguajë Agjentit (për llogari të tij) një tarifë prej €5,000.

21.4 Kufizimi i përgjegjësisë së Huadhënësve Egzistues

21.4.1 Nëse nuk bihet dakord shprehimisht për të kundërtën, një Huadhënës Egzistues nuk bën asnjë përfaqësim ose garanci dhe nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi ndaj një Huadhënësi të Ri për:

a) Ligjshmërinë, vlefshmërinë, efektivitetin, mjaftueshmërinë ose egzekutueshmërinë e Dokumentave Financiare ose ndonjë dokumenti tjetër;

b) Gjendjen financiare të Huamarrësit;

c) Përmbushjen dhe respektimin nga ana e Huamarrësit të detyrimeve të tij sipas Dokumentave Financiare ose ndonjë dokumenti tjetër; ose

d) Saktësinë e ndonjë deklarate (qoftë me shkrim apo me gojë) të bërë në ose në lidhje me ndonjë Dokument Financiar ose ndonjë dokument tjetër,

Dhe çdo përfaqësim ose garanci e nënkuptuar nga ligji, përjashtohet.

21.4.2 Çdo Huadhënës i Ri i konfirmon Huadhënësit Egzistues dhe Palëve të tjera Financuese që ai:

a) Ka bërë (dhe do të vazhdojë të bëjë) hetimin e vet të pavarur dhe vlerësimin e gjendjes financiare dhe punëve të Huamarrësit dhe subjekteve të tij të ngjashme në lidhje me kontributin e tij në këtë Marrëveshje dhe nuk është mbështetur ekskluzivisht në një informacion të dhënë atij nga Huadhënësi Egzistues në lidhje me ndonjë Dokument Financiar; dhe

b) Do të vazhdojë të bëjë vlerësimin e tij të pavarur të vlerësimit të kredisë së Huamarrësit dhe subjekteve të tij të ngjashme ndërsa ndonjë shumë është ose mund të jetë e papaguar sipas Dokumentave Financiare ose ndonjë Detyrim Financiar është në fuqi.

21.4.3 Asgjë në një Dokument Financiar nuk detyron një Huadhënës Egzistues:

a) Të pranojë një ritransferim nga një Huadhënës i Ri të ndonjë prej të drejtave dhe detyrimeve të kaluara ose të transferuara sipas kësaj Klauzole 0; ose

b) Të mbështesë ndonjë humbje drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt të shkaktuar nga Huamarrësi i Ri për shkak të mospërmbushjes nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas Dokumentave Financiare ose në ndonjë formë tjetër.

21.5 Procedura për transferim

21.5.1 Në bazë të kushteve të parashtruara në Klauzolën 0 (Kushtet e kalimit ose transferimit) një transferim bëhet në përputhje me Klauzolën 0 më poshtë kur Agjenti egzekuton një Çertifikatë Transferimi të plotësuar rregullisht në ndonjë formë tjetër, të dorëzuar atij nga Huadhënësi Egzistues dhe Huadhënësi i Ri. Në bazë të Klauzolës 21.5.2 më poshtë, sa më parë që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme pas marrjes nga ai të një Çertifikate Transferimi të plotësuar rregullisht që haptazi pajtohet me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe të jetë dorëzuar në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, Agjenti do ta egzekutojë atë Çertifikatë Transferimi.

21.5.2 Agjenti do të jetë i detyruar të egzekutojë një Çertifikatë Transferimi që i është dorëzuar atij nga Huadhënësi Egzistues dhe Huadhënësi i Ri nëse sigurohet që përmbush të gjitha procedurat e nevojshme -njihni klientin tuaj- ose kontrole të tjera të ngjashme sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në lidhje me transferimin ndaj atij Huadhënësi të Ri.

21.5.3 Në Datën e Transferimit:

a) Në shkallën që në Çertifikatën e Transferimit, Huadhënësi Egzistues kërkon të transferojë me anë të shtyrjes të drejtat dhe detyrimet e tij sipas Dokumentave Financiare. Huamarrësi dhe Huadhënësi Egzistues, secili do të çlirohen nga detyrime të mëtejshme ndaj njëri tjetrit sipas Dokumentave Financiare dhe të drejtat e tyre përkatëse ndaj njëri tjetrit sipas Dokumentave Financiare do të anulohen (që janë Të Drejta dhe Detyrime të Përmbushura);

b) Huamarrësi dhe Huadhënësi i Ri do të marrin përsipër detyrime ndaj njëri tjetrit dhe/ose përftojnë të drejta ndaj njëri tjetrit që ndryshojnë nga Të drejtat dhe Detyrimet e Përmbushura vetëm nëse Huamarrësi dhe Huadhënësi i Ri kanë marrë përsipër dhe/ose përftuar ato në vend të Huamarrësit dhe Huadhënësit Egzistues;

c) Agjenti, Rregulluesi, Huadhënësi i Ri dhe Huadhënësit e tjerë do të përftojnë të drejta të njëjta dhe do të marrin përsipër të njëjtat detyrime midis tyre që ata do të kishin përftuar dhe marrë përsipër nëse Huadhënësi i Ri do të kishte qënë një Huadhënës Fillestar me të drejtat dhe/ose detyrimet e

përfuara ose të marra përsipër nga ai si rezultat i transferimit dhe në shkallën që Agjenti, Rregulluesi dhe Huadhënësi Egzistues do të çlirohen secili nga detyrime të mëtejshme ndaj njëri tjetrit sipas Dokumentave Financiare; dhe

d) Huadhënësi i Ri bëhet Palë si Huadhënës.

21.5.4 Huamarrësi dhe Palët e tjera Financuese autorizojnë në mënyrë të pakthyeshme Agjentin të egzekutojë një Çertifikatë Transferimi në emër të tyre, pa u konsultuar me ta.

21.6 Kopje e Çertifikatës së Transferimit për Huamarrësin

Sa më parë që të jetë e zbatueshme në mënyrë të arsyeshme, pasi të ketë egzekutuar një Çertifikatë Transferimi, Agjenti do t'i dërgojë Huamarrësit një kopje të asaj Çertifikate Transferimi.

21.7 Zbulimi i informacionit

Çdo Huadhënës mund t'i zbulojë ndonjë prej Filialeve të tij dhe çdo personi tjetër:

21.7.1 Të cilit (ose përmes të cilit) ai Huadhënës kalon ose transferon të drejta (ose mund të ketë të ngjarë të kalojë ose transferojë) të gjitha ose ndonjë prej të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

21.7.2 Me (ose përmes të cilit) ai Huadhënës angazhohet në (ose mund të ketë të ngjarë të angazhohet në) ndonjë nënkontribut në lidhje me ose një tranzaksion tjetër sipas të cilit pagesat duhet të bëhen duke iu referuar kësaj Marrëveshjeje ose Huamarrësit; ose

21.7.3 Me (ose përmes të cilit) ai Huadhënës angazhohet në (ose mund të ketë të ngjarë të angazhohet në) ndonjë marrëveshje kontraktuale, kontratë ose marrëdhënie në lidhje me ose për këtë Marrëveshje ose çfarëdolloj tipi ose forme (duke përfshirë produkte artificiale ose të prejardhura ose transferime); ose

21.7.4 Të cilit dhe në shkallën që informacioni kërkohet të zbulohet nga ndonjë ligj ose rregullore e zbatueshme,

çdo informacion rreth Huamarrësit, ndonjë Subjekti Shtetëror dhe Dokumentave Financiare që Huadhënësi e çmon të përshtatshëm.

22 Ndryshime tek Huamarrësi

22.1 Kalimi dhe transferimi i të drejtave nga Huamarrësi

Huamarrësi mund të mos kalojë ndonjë prej të drejtave të tij ose transferojë ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas Dokumentave Financiare.

SEKSIONI 9 PALËT FINANCUESE

23 Roli i Agjentit dhe Rregulluesit

23.1 Caktimi i Agjentit

23.1.1 Çdo Palë tjetër Financiare cakton Agjentin të veprojë si agjentin e saj sipas dhe në lidhje me Dokumentat Financiare.

23.1.2 Çdo Palë tjetër Financuese autorizon Agjentin të ushtrojë të drejtat, kompetencat, autoritetet dhe liritë e veprimit specifikisht të dhëna Agjentit sipas ose në lidhje me Dokumentat Financiare së bashku me ndonjë të drejtë, kompetencë, autoritet dhe liri tjetër veprimi të rastësishme.

23.2 Detyrat e Agjentit

23.2.1 Agjenti do t'i japë menjëherë një Pale originalin ose një kopje të ndonjë dokumenti që i dorëzohet Agjentit për atë Palë nga një Palë tjetër.

23.2.2 Me përjashtim të rasteve kur një Dokument Financiar parashikon specifikisht ndryshe, Agjenti nuk është i detyruar të rishikojë ose kontrollojë mjaftueshmërinë, saktësinë ose plotësinë e ndonjë dokumenti që i paraqet një Pale tjetër.

23.2.3 Nëse Agjenti merr njoftim nga një Palë duke iu referuar kësaj Marrëveshjeje, duke përshkruar një Mosplotësim Detyrimesh dhe deklaruar se rrethana e përshkruar është një Mosplotësim Detyrimi, ai do të njoftojë menjëherë Palët Financuese.

23.2.4 Nëse Agjenti është në dijeni të mospagesës së një principali, interesi, tarife detyrimi financiar ose tarifë tjetër të pagueshme për një Palë Financuese (të ndryshme nga Agjenti ose Rregulluesi) sipas kësaj Marrëveshjeje, ai do të njoftojë menjëherë Palët e tjera Financuese.

23.2.5 Detyrat e Agjentit sipas Dokumentave Financiare janë vetëm të një natyre mekanike dhe administrative.

23.3 Roli i Rregulluesit

Përveç rasteve të parashikuara specifikuara në Dokumentat Financiare, Rregulluesi nuk ka asnjë detyrim të ndonjë lloji ndaj një Pale tjetër sipas ose në lidhje me një Dokument Financiar.

23.4 Mungesa e detyrave të lëna në mirëbesim

23.4.1 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk e bën Agjentin ose Rregulluesin si administrator ose kujdestar të besuar të një personi tjetër.

23.4.2 As Agjenti, as Rregulluesi nuk do të jenë të detyruar t'i llogarisin një Huadhënësi ndonjë shumë ose element përfitues të ndonjë shume të marrë nga ai për llogari të vet.

23.5 Aktiviteti me Huamarrësin dhe Subjektet Shtetërore

Agjenti dhe Rregulluesi mund të pranojnë depozita, të japin para hua dhe në përgjithësi të angazhohen në çdo lloj aktiviteti bankar ose aktivitet tjetër me Huamarrësin ose ndonjë Subjekt Shtetëror.

23.6 Të Drejtat dhe liritë e veprimit të Agjentit

23.6.1 Agjenti mund të mbështetet në:

a) Çdo përfaqësim, njoftim ose dokument që ai beson se është i vërtetë, i saktë dhe i autorizuar në mënyrën e duhur; dhe

b) Çdo deklaratë të bërë nga një drejtor, nënshkrues i autorizuar ose punonjës i një personi në lidhje me ndonjë çështje që mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme të jetë sipas dijenisë së tij ose brenda kompetencës së tij për verifikim.

23.6.2 Agjenti mund të supozojë (nëse nuk ka marrë njoftim për të kundërtën në cilësinë e tij si agjent për Huadhënësit) se:

a) Nuk ka ndodhur asnjë Mosplotësim Detyrimi (nëse nuk ka dijeni faktike të një Mosplotësimi Detyrimi që lind sipas Klauzolës 0 (Mospagesa)); dhe

b) Nuk është ushtruar asnjë e drejtë, kompetencë, autoritet ose diskrecion që i vishet ndonjë Pale ose Huadhënësve të Shumicës.

23.6.3 Agjenti mund të angazhojë, paguajë për dhe mbështetet në këshillat ose shërbimet e avokatëve, kontabilistëve, kontrollorëve ose ekspertëve të tjerë.

23.6.4 Agjenti mund të veprojë në lidhje me Dokumentat Financiare nëpërmjet personelit ose agjentëve të tij.

23.6.5 Agjenti mund t'i zbulojë ndonjë Pale tjetër çdo informacion që beson në mënyrë të arsyeshme që ka marrë si agjent sipas kësaj Marrëveshjeje.

23.6.6 Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të një Dokumenti Financiar për të kundërtën, as Agjenti, as Rregulluesi nuk janë të detyruar të bëjnë ose të mos bëjnë diçka nëse sipas mendimit të tyre të arsyeshëm, do të përbënte ose mund të përbënte shkelje të një ligji ose rregulloreje ose shkelje të një detyre të lënë në mirëbesim ose detyre konfidencialiteti.

23.7 Udhëzimet e Huadhënësve të Shumicës

23.7.1 Nëse nuk shfaqet një tregues për të kundërtën në një Dokument Financiar, Agjenti do të (1) ushtrojë çdo të drejtë, kompetencë, autoritet ose diskrecion që i vishet atij si Agjent, në përputhje me ndonjë udhëzim të dhënë atij nga Huadhënësit e Shumicës (ose, nëse udhëzohet në këtë mënyrë nga Huadhënësit e Shumicës, shmanget nga ushtrimi i ndonjë të drejte, kompetence, autoriteti ose diskrecioni të veshur atij si Agjent) dhe (ii) nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë veprim (ose mosveprim) nëse vepron (ose shmanget nga marrja e ndonjë mase) në përputhje me një udhëzim të Huadhënësve të Shumicës.

23.7.2 Nëse nuk shfaqet një tregues për të kundërtën në një Dokument Financiar, çdo udhëzim i dhënë nga Huadhënësit e Shumicës do të jetë detyrues për të gjitha Palët Financuese.

23.7.3 Agjenti mund të shmanget nga të vepruarit në përputhje me udhëzimet e Huadhënësve të Shumicës (ose, sipas rastit, Huadhënësit) derisa të ketë marrë këtë rëndim barrësor që mund të kërkojë për një kosto, humbje ose përgjegjësi (së bashku me ndonjë TVSH shoqëruese) që mund të shkaktojë gjatë përbushjes së udhëzimeve.

23.7.4 Në mungesë të udhëzimeve nga Huadhënësit e Shumicës (ose, sipas rastit, Huadhënësit), Agjenti mund të veprojë (ose të shmanget nga marrja e masave) siç e konsideron që të jetë në interesin më të mirë të Huadhënësve.

23.7.5 Agjenti nuk është i autorizuar të veprojë në emër të një Huadhënësi (pa marrë më parë pëlqimin e Huadhënësit) në ndonjë procedim ligjor ose arbitrazhi në lidhje me një Dokument Financiar.

23.8 Përgjegjësia për dokumentacionin

As Agjenti, as Rregulluesi:

23.8.1 Nuk janë përgjegjës për mjaftueshmërinë, saktësinë dhe/ose plotësinë e ndonjë informacioni (qoftë me gojë ose me shkrim) të dhënë nga Agjenti, Rregulluesi, Huamarrësi, ndonjë Subjekt Shtetëror ose person tjetër, i dhënë në ose në lidhje me një Dokument Financiar; ose

23.8.2 Nuk janë përgjegjës për ligjshmërinë, vlefshmërinë, efektivitetin, mjaftueshmërinë ose egzekutueshmërinë e ndonjë Dokumenti Financiar ose marrëveshjeje, kontrate ose dokumenti tjetër të lidhur, bërë ose egzekutuar në pritje të ose në lidhje me një Dokument Financimi.

23.9 Përjashtimi i përgjegjësisë

23.9.1 Pa kufizuar Klauzolën 0 më poshtë, Agjenti nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë veprim të marrë nga ai sipas ose në lidhje me një Dokument Financiar, nëse nuk shkaktohet drejtpërdrejt nga neglizhenca e tij flagrante ose sjellja e keqe me dashje.

23.9.2 Asnjë Palë (e ndryshme nga Agjenti) nuk mund të bëjë ndonjë procedim kundër një nëpunësi, zyrtari ose agjenti të Agjentit në lidhje me ndonjë pretendim që mund të ketë kundër Agjentit ose në lidhje me një veprim ose mosveprim të ndonjë lloji nga ai nëpunës, zyrtar ose agjent në lidhje me një Dokument Financiar dhe çdo nëpunës, zyrtar ose agjent i Agjentit mund të mbështetet në këtë Klauzolë në bazë të Klauzolës 0 (Të Drejtat e Palëve të Treta) dhe dispozitat e Ligjit mbi Palët e Treta.

23.9.3 Agjenti nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë vonesë (ose pasojë të ngjashme) në kreditimin e një llogarie me një shumë të kërkuar sipas Dokumentave Financiare që duhet të paguhet nga Agjenti, nëse Agjenti ka marrë të gjitha masat e nevojshme sa më parë që të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme për t'u pajtuar me rregulloret ose procedurat operuese të ndonjë sistemi të njohur likuidimi ose shlyerjeje të përdorur nga Agjenti për atë qëllim.

23.9.4 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të detyrojë Agjentin ose Rregulluesin të kryejë procedurën -njihni klientin tuaj- ose kontrole të tjera në lidhje me ndonjë person në emër të një Huadhënësi dhe çdo Huadhënës i konfirmon Agjentit dhe Rregulluesit që është individualisht përgjegjës për çdo kontroll të tillë që kërkohet të kryejë dhe që mund të mos mbështetet në ndonjë deklaratë mbi këto kontrole të kryera nga Agjenti ose Rregulluesi.

23.10 Zhdëmtimi i Huadhënësve ndaj Agjentit

Çdo Huadhënës (në përpjesëtim me pjesën e tij të Detyrimeve të Përgjithshme Financiare ose, nëse Detyrimet e Përgjithshme Financiare reduktohen më pas në zero, me pjesën e tij të Detyrimeve të Përgjithshme Financiare menjëherë para reduktimit të tyre në zero) do të zhdëmtojë Agjentin, brenda tre (3) Ditësh Pune nga kërkesa, kundrejt çdo kostoje, humbjeje ose përgjegjësie të shkaktuar nga Agjenti (për arsye të ndryshme nga ato të neglizhencës flagrante të Agjentit ose sjelljes së keqe me dashje) gjatë veprimit si Agjent sipas Dokumentave Financiare (nëse Agjenti nuk është riimbursuar nga Huamarrësi sipas një Dokumenti Financiar).

23.11 Dorëheqja e Agjentit

23.11.1 Agjenti mund të japë dorëheqjen dhe të caktojë një prej Filialeve tij që vepron përmes një zyre në Mbretërinë e Bashkuar si pasardhës, duke i dhënë njoftim Palëve të tjera Financuese dhe Huamarrësit.

23.11.2 Nga ana tjetër, Agjenti mund të japë dorëheqjen, duke i dhënë njoftim Palëve të tjera Financuese dhe Huamarrësit dhe në këtë rast, Huadhënësit e Shumicës (pas konsultimit me Huamarrësin) mund të caktojnë një Agjent pasardhës.

23.11.3 Nëse Huadhënësit e Shumicës nuk kanë caktuar një Agjent pasardhës në përputhje me Klauzolën 0 më sipër brenda 30 ditësh pasi është dhënë njoftimi i dorëheqjes, Agjenti (pas konsultimit me Huamarrësin) mund të caktojë një Agjent pasardhës (që vepron përmes një zyre në Mbretërinë e Bashkuar).

23.11.4 Agjenti që largohet, me shpenzimet e veta, do të vërë në dispozicion të Agjentit pasardhës ato dokumenta dhe të dhëna dhe do të ofrojë ndihmën që Agjenti pasardhës mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për qëllimet e përmbushjes së funksioneve të tij si Agjent sipas Dokumentave Financiare.

23.11.5 Njoftimi i dorëheqjes së Agjentit do të hyjë në fuqi vetëm pas caktimit të një pasardhësi.

23.11.6 Pas caktimit të një pasardhësi, Agjenti që largohet do të çlirohet nga çdo detyrim i mëtejshëm në lidhje me Dokumentat Financiare por do të vazhdojë të ketë të drejtën e përfitimeve të kësaj Klauzole 23. Pasardhësi i tij dhe secila prej Palëve të tjera do të kenë të njëjtat të drejta dhe

detyrime mes tyre që do të kishin patur nëse ky pasardhës do të kishte qënë Palë fillestare.

23.11.7 Pas konsultimit me Huamarrësin, Huadhënësit e Shumicës, me njoftim për Agjentin, mund t'i kërkojnë të japë dorëheqjen në përputhje me Klauzolën 0 më sipër. Në këtë rast, Agjenti do të japë dorëheqjen në përputhje me Klauzolën 0 më sipër.

23.12 Konfidencialiteti

23.12.1 Kur vepron si agjent për Palët Financiare, Agjenti do të konsiderohet që vepron nëpërmjet drejtorisë së degës së tij që do të trajtohet si subjekt i ndarë nga ndonjë prej drejtorive ose departamenteve të tjera.

23.12.2 Nëse informacioni merret nga një drejtori ose department tjetër i Agjentit, mund të trajtohet si konfidencial për atë drejtori ose department dhe Agjenti nuk do të konsiderohet të ketë marrë njoftim për të.

23.13 Marrëdhënia me Huadhënësit

23.13.1 Agjenti mund të trajtojë çdo Huadhënës si Huadhënës, të autorizuar për pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje dhe që vepron përmes Zyrës së tij të Shërbimit nëse nuk ka marrë një njoftim paraprak jo më pak se pesë (5) Ditë Pune nga ai Huadhënës për të kundërtën, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

23.13.2 Çdo Huadhënës do t'i japë Agjentit çdo informacion të kërkuar nga Agjenti, me qëllim që të llogarisë Koston e Detyrueshme në përputhje me Programin 4 (Formula e Kostos së Detyrueshme).

23.14 Vlerësimi i kredisë nga Huadhënësit

Pa cënuar përgjegjësinë e Huamarrësit për informacionin e dhënë nga ai ose në emër të tij në lidhje me një Dokument Financiar, çdo Huadhënës i konfirmon Agjentit dhe Rregulluesit që ka qënë dhe do të vazhdojë të jetë individualisht përgjegjës për të kryer vlerësimin dhe hetimin e tyre të pavarur të të gjitha rreziqeve që lindin sipas ose në lidhje me ndonjë Dokument Financiar, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

23.14.1 Gjendjen financiare, statusin dhe natyrën e Huamarrësit dhe të një Subjekti Shtetëror;

23.14.2 Ligjshmërinë, vlefshmërinë, efektivitetin, mjaftueshmërinë ose egzekutueshmërinë e ndonjë Dokumenti Financiar dhe çdo marrëveshjeje, kontratë ose dokument tjetër të lidhur, bërë ose egzekutuar në pritje të, sipas ose në lidhje me një Dokument Financiar;

23.14.3 Nëse ai Huadhënës ka të drejtë tërheqjeje, dhe natyra dhe shkalla e asaj të drejte tërheqjeje kundër një Pale ose ndonjë prej sendeve të saj pasurore përkatëse sipas ose në lidhje me një Dokument Financimi, tranzaksionet e parashikuara nga Dokumentat Financiare ose ndonjë marrëveshjeje tjetër, kontratë ose dokument të lidhur, bërë ose egzekutuar në pritje të, sipas ose në lidhje me një Dokument Financiar; dhe

23.14.4 Mjaftueshmëria, saktësia dhe/ose plotësia e Memorandumit të Informacionit dhe çdo informacion tjetër i dhënë nga Agjenti, nga një Palë ose nga ndonjë person tjetër sipas ose në lidhje me një Dokument Financiar, tranzaksionet e parashikuara nga Dokumentat Financiare ose nga një marrëveshjeje, kontratë ose dokument tjetër të lidhur, bërë ose egzekutuar në pritje të, sipas ose në lidhje me një Dokument Financiar.

23.15 Koha e Menaxhimit të Agjentit

Çdo shumë e pagueshme për Agjentin sipas Klauzolës 0 (Zhdëmtimi ndaj Agjentit), Klauzolës 0 (Kostot dhe shpenzimet) dhe Klauzolës 0 (Zhdëmtimi i Huadhënësve ndaj Agjentit) do të përfshijë koston e shfrytëzimit të kohës së menaxhimit të Agjentit ose burimet e tjera dhe do të llogaritet mbi bazën e këyre normave të arsyeshme ditore ose mbi bazë orësh që Agjenti mund t'i njoftojë Huamarrësit dhe Huadhënësve, dhe është shtesë e ndonjë tarife të paguar ose të pagueshme ndaj Agjentit sipas Klauzolës 0 (Tarifat).

23.16 Zbritja nga shumata e pagueshme nga Agjenti

Nëse një Palë i detyrohet një shumë Agjentit sipas Dokumentave Financiare, Agjenti, pasi t'i japë njoftim asaj Pale, mund të zbrisë një shumë që nuk tejkalon atë shumë nga ndonjë pagesë për atë Palë që Agjenti do të ishte ndryshe i detyruar të bënte sipas Dokumentave Financiare dhe do të aplikojë shumën e zbritur në ose kundrejt plotësimit të shumës që detyrohet. Për qëllimet e Dokumentave Financiare, ajo Palë do të konsiderohet sikur të ketë marrë një shumë të zbritur në këtë mënyrë.

24 Kryerja e aktivitetit nga Palët Financuese

24.1 Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje:

24.1.1 Nuk do të ndërhyjë në të drejtën e një Pale Financuese për të rregulluar aktivitetin e saj (tatimor ose të ndonjë forme tjetër) në çdo lloj mënyre që e çmon të përshtatshme;

24.1.2 Nuk do të detyrojë një Palë Financuese të hetojë ose pretendojë kredi, ndihmë, lehtësim ose shlyerje që i vihet në dispozicion ose shkallën, rendin dhe mënyrën e një pretendimi; ose

24.1.3 Nuk do të detyrojë një Palë Financuese të zbulojë informacion në lidhje me aktivitetin e saj (tatimor ose të ndonjë forme tjetër) ose ndonjë llogaritje në lidhje me Taksat.

25 Ndarja mes Palëve Financuese

25.1 Pagesat për Palët Financuese

Nëse një Palë Financuese (një Palë Financuese Rikuperuese) merr ose kthen ndonjë shumë nga Huamarrësi ndryshe sesa në përputhje me Klauzolën 0 (Mekanizmi i Pagesave) dhe aplikon atë shumë ndaj një pagese të kërkueshme sipas Dokumentave Financiare, atëherë:

25.1.1 Pala Financuese Rikuperuese, brenda tre ditësh pune, do t'i njoftojë Agjentit hollësisht e marrjes ose kthimit;

25.1.2 Agjenti do të përcaktojë nëse marrja ose kthimi e tejkalojnë shumën që Pala Financuese Rikuperuese do të kishte paguar nëse marrja apo kthimi do të ishin marrë ose bërë nga Agjenti dhe do të ishin shpërndarë në përputhje me Klauzolën 0 (Mekanizmi i Pagesës), pa marrë parasysh ndonjë Taksë që do të vendosej mbi Agjentin në lidhje me marrjen, kthimin ose shpërndarjen; dhe

25.1.3 Pala Financuese Rikuperuese, brenda tre Ditësh Pune nga kërkesa e Agjentit, do t'i paguajë Agjentit një shumë (Pagesa Aksionere) të barabartë me atë marrje ose kthim më pak se shuma që Agjenti përcakton se mund të mbahet nga Pala Financuese Rikuperuese si pjesa e saj e ndonjë pagese që duhet bërë në përputhje me Klauzolën 0 (Pagesa të pjesshme).

25.2 Rishpërndarja e pagesave

Agjenti do të trajtojë Pagesat Aksionere sikur të ishin paguar nga Huamarrësi dhe do t'i shpërndajë ato midis Palëve Financuese (të ndryshme nga Pala Financuese Rikuperuese), në përputhje me Klauzolën 0 (Pagesa të pjesshme).

25.3 Të drejtat e Palëve Financuese Rikuperuese

25.3.1 Me një rishpërndarje nga Agjenti sipas Klauzolës 0 (Rishpërndarja e Pagesave) Pala Financuese Rikuperuese do të zëvendësohet ndaj të drejtave të Palëve Financuese që kanë ndarë në rishpërndarje.

25.3.2 Nëse dhe në shkallën që Pala Financuese Rikuperuese nuk është e aftë të mbështetet në të drejtat e saj sipas Klauzolës 0 më sipër, Huamarrësi do të jetë përgjegjës ndaj Palës Financuese Rikuperuese për një borxh të barabartë me Pagesën Aksionere që është menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme.

25.4 Anullimi i rishpërndarjes

Nëse një pjesë e Pagesës Aksionere të marrë ose të kthyer nga një Palë Financuese Rikuperuese bëhet e shlyeshme dhe shlyhet nga ajo Palë Financiare Rikuperuese, atëherë:

25.4.1 Çdo Palë Financuese që ka marrë një pjesë të Pagesës përkatëse Aksionere sipas Klauzolës 0 (Rishpërndarja e pagesave), me kërkesë të Agjentit, do t'i paguajë Agjentit për llogari të asaj Pale Financuese Rikuperuese, një shumë të barabartë me pjesën e duhur të aksionit të saj të Pagesës Aksionere (së bashku me një shumë që është e nevojshme për të riimbursuar atë Palë Financuese Rikuperuese për pjesën e saj të interesit mbi Pagesën Aksionere që asaj Pale Financuese Rikuperuese i kërkohet të paguajë); dhe

25.4.2 Të drejtat e zëvendësimit të asaj Pale Financuese Rikuperuese në lidhje me një riimbursim do të anulohen dhe Huamarrësi do të jetë përgjegjës ndaj Palës Financuese riimbursuese për shumën e riimbursuar.

25.5 Përjashtimet

25.5.1 Kjo Klauzolë 0 nuk do të zbatohet në shkallën që Pala Financuese Rikuperuese, pas kryerjes së një pagese sipas kësaj Klauzole 25, nuk do të kishte një pretendim të vlefshëm dhe të zbatueshëm ndaj Huamarrësit.

25.5.2 Një Palë Financuese Rikuperuese nuk është e detyruar të ndajë me një Palë tjetër Financuese ndonjë shumë që Pala Financuese Rikuperuese ka marrë ose kthyer si rezultat i bërjes së procedimeve ligjore ose të arbitrazhit, nëse:

a) Ka njoftuar atë Palë tjetër Financuese për procedimet ligjore ose të arbitrazhit; dhe

b) Ajo Palë tjetër Financuese kishte mundësi për të marrë pjesë në ato procedime ligjore ose arbitrazhi por pas marrjes së njoftimit, nuk e bëri këtë sa më parë që të ishte e mundur në mënyrë të arsyeshme dhe nuk bëri procedime të ndara ligjore ose arbitrazhi.

SEKSIONI 10 ADMINISTRIMI

26 Mekanizmat e pagesës

26.1 Pagesat për Agjentin

26.1.1 Në çdo datë në të cilën Huamarrësit ose Huadhënësit i kërkohet të bëjë një pagesë sipas një Dokumenti Financiar, Huamarrësi ose Huadhënësi do ta vërë këtë pagesë në dispozicion të Agjentit (nëse nuk shfaqet një tregues për të kundërtën në një Dokument Financiar) për vlerën në datën e kërkueshme në kohën dhe në fonde të tilla të specifikuara nga Agjenti si të zakonshme në kohën për shlyerjen e tranzaksioneve në valutën përkatëse në vendin e pagesës.

26.1.2 Pagesa do të bëhet në këtë llogari në qendrën kryesore financiare të vendit të asaj valute (ose në lidhje me Euron, në një qendër kryesore financiare në një Shtet Anëtar Pjesëmarrës ose Londër) me atë bankë që cakton Agjenti.

26.2 Shpërndarjet nga Agjenti

Çdo pagesë e marrë nga Agjenti sipas Dokumentave Financiare për një Palë tjetër, në bazë të Klauzolës 26.3 (Shpërndarjet për Huamarrësin) dhe Klauzolës 26.4 (Marrja e shumave financiare) do të vihet në dispozicion nga Agjenti sa më parë që të jetë e mundur pas marrjes, ndaj Palës së autorizuar për të marrë pagesa në përputhje me këtë Marrëveshje (në rastin e një Huadhënësi, për llogari të Zyrës së tij të Shërbimit) në atë llogari që ajo Palë mund t'i njoftojë Agjentit me një njoftim prej jo më pak se pesë Ditë Pune me një bankë në qendrën kryesore financiare të vendit të asaj valute (ose në lidhje me euron, në qendrën kryesore financiare të një Shteti Anëtar Pjesëmarrës ose Londër).

26.3 Shpërndarjet për Huamarrësin

Agjenti (me pëlqimin e Huamarrësit ose në përputhje me Klauzolën **Error! Reference source not found.** (Kompensimi)) mund të aplikojë ndonjë shumë të marrë nga ai për Huamarrësin për ose kundrejt pagesës (në datën dhe në monedhën dhe fondet e marrjes) të ndonjë shume të kërkueshme nga Huamarrësi sipas Dokumentave Financiare ose për ose kundrejt blerjes së ndonjë shume të ndonjë valute që duhet të aplikohet në këtë mënyrë.

26.4 Marrja e shumave financiare

26.4.1 Kur një shumë duhet t'i paguhet Agjentit sipas Dokumentave Financiare për një Palë tjetër, Agjenti nuk është i detyruar t'ia paguajë atë shumë asaj Pale tjetër (ose të lidhë ose përmbushë ndonjë kontratë të ngjashme shkëmbimi) derisa të ketë qënë i aftë për të vendosur sipas bindjes së tij se në të vërtetë e ka marrë atë shumë.

26.4.2 Nëse Agjenti i paguan një shumë një Pale tjetër dhe ndodh që Agjenti në të vërtetë nuk e kishte marrë atë shumë, atëherë Pala të cilës ajo shumë (ose të ardhurat e një kontrate të ngjashme shkëmbimi) ishte paguar nga Agjenti, sipas kërkesës, do t'ia kompensojë atë Agjentit së bashku me interesin mbi atë shumë nga data e pagesës deri në datën e marrjes nga Agjenti, të llogaritur nga Agjenti për të reflektuar koston e tij të fondeve.

26.5 Pagesat e pjeshme

26.5.1 Nëse Agjenti merr një pagesë që është e pamjaftueshme për të plotësuar të gjitha shumat në atë kohë të kërkueshme dhe të pagueshme nga Huamarrësi sipas Dokumentave Financiare, Agjenti do të aplikojë atë pagesë kundrejt detyrimeve të Huamarrësit sipas Dokumentave Financiare në rendin e mëposhtëm:

a) Së pari, për ose ndaj pagesës, me bazë proporcionale, të çdo tarife, shpenzimi ose kostoje të papaguar të Agjentit në pajtim me Dokumentat Financiare;

b) së dyti, për ose ndaj pagesës me bazë proporcionale, të çdo interesi të shtuar, tarife ose komisioni të kërkueshëm por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) së treti, për ose ndaj pagesës me një bazë proporcionale, të çdo principali të kërkueshëm por të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

d) së katërti, për ose ndaj pagesës me një bazë proporcionale, të çdo shume tjetër të kërkueshme por të papaguar sipas Dokumentave Financiare.

26.5.2 Agjenti, nëse urdhërohet nga Huadhënësit e Shumicës, mund të ndryshojë rendin e përcaktuar në Klauzolën 0 deri 0 më sipër.

26.5.3 Klauzolat 0 dhe 0 më sipër nuk do të pranojnë asnjë përvetësim të bërë nga Huamarrësi.

26.6 Moskompensimi nga Huamarrësi

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas Dokumentave Financiare do të llogariten dhe bëhen pa (dhe të lira dhe pa zbritje për) kompensim ose kundërpretendim.

26.7 Ditët e Punës

26.7.1 Çdo pagesë që është e kërkueshme për t'u bërë në datën që nuk është Ditë Pune, do të bëhet në Ditën pasuese të Punës në të njëjtin muaj kalendarik (nëse ka) ose në Ditën pararendëse të Punës (nëse nuk ka).

26.7.2 Gjatë ndonjë shtyrjeje të datës së kërkueshme për pagesën e një principali ose Shume të Papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje, interesi është i pagueshëm mbi principalin ose Shumën e Papaguar në normën e pagueshme në datën e kërkueshme fillestare.

26.8 Monedha e llogarisë

26.8.1 Në bazë të Klauzolave 0 dhe 0 më poshtë, euro është monedha e llogarisë dhe pagesës për çdo shumë të kërkueshme nga Huamarrësi sipas Dokumentave të Financimit.

26.8.2 Çdo pagesë në lidhje me kostot, shpenzimet ose Taksat do të bëhet në monedhën në të cilën kanë lindur kostot, shpenzimet ose Taksat.

26.8.3 Çdo shumë e shprehur për t'u paguar në një monedhë të ndryshme nga euro do të paguhet në atë monedhë tjetër.

26.9 Ndryshimi i monedhës

26.9.1 Nëse nuk ndalohet ndryshe me ligj, nëse më shumë se një monedhë ose njësi monedhe njihen njëkohësisht nga banka qendrore e një vendi si monedhë e ligjshme e atij vendi, atëherë:

a) Çdo referencë ndaj Dokumentave të Financimit dhe çdo detyrim që lind sipas Dokumentave Financiare në monedhën e atij vendi, duhet të konvertohet ose paguhet në monedhën ose njësinë e monedhës së atij vendi të caktuar nga Agjenti (pas konsultimit me Huamarrësin); dhe

b) Çdo konvertim nga një monedhë ose njësi monedhe në një tjetër do të jetë në normën zyrtare të këmbimit të njohur nga banka qendrore për konvertimin e asaj monedhe ose njësie monedhe në një tjetër, e rrumbullakosur për lart ose poshtë nga Agjenti (që vepron në mënyrë të arsyeshme).

26.9.2 Nëse ndodh ndonjë ndryshim në monedhën e një vendi, në shkallën që Agjenti (që vepron në mënyrë të arsyeshme dhe pas konsultimit me Huamarrësin) specifikon të jetë e nevojshme, kjo Marrëveshje do të amendohet për të qënë në pajtim me një konventë të pranuar përgjithësisht dhe praktikën e tregut në Tregun përkatës Ndërbankar dhe ndryshe të reflektojë ndryshimin në monedhë.

27 Kompensimi

Një Palë Financuese mund të kompensojë çdo detyrim të maturuar të kërkueshëm nga Huamarrësi sipas Dokumentave Financiare (në shkallën që zotërohet me përfitim nga ajo Palë Financuese) kundrejt çdo detyrimi të maturuar që ajo Palë Financuese i detyrohet Huamarrësit, pavarësisht vendit të pagesës, degës së regjistrimit ose monedhës së ndonjë detyrimi. Nëse detyrimet janë në monedha të ndryshme, Pala Financuese mund të konvertojë çdo detyrim në një normë këmbimi të tregut në këmbimin e saj në vazhden normale të biznesit për qëllim të kompensimit.

28 Njoftimet

28.1 Komunikimet me shkrim

Çdo komunikim që duhet të bëhet sipas ose në lidhje me Dokumentat Financiare do të bëhet me shkrim dhe nëse nuk deklarohet ndryshe, mund të bëhet me faks ose letër.

28.2 Adresat

28.2.1 Adresa dhe numri i faksit (dhe departamenti ose nëpunësi, sipas rastit, të cilëve u drejtohet komunikimi) i secilës Palë për çdo komunikim ose dokument që duhet të bëhet ose dorëzohet sipas ose në lidhje me Dokumentat Financiare, janë ato të njoftuara me shkrim nga ajo Palë për Agjentin në ose para datës në të cilën bëhet Palë.

28.2.2 Hollësitat e kontaktit të Huamarrësit për këtë qëllim janë:

Ministria e Financave
Bulevardi "Deshmoret e Kombit" Nr 1
Tirana
Albania

Telefaks: +355 422 8494
Në vëmendje të: Ministrit të Financave

28.2.3 Hollësitat e kontaktit të Agjentit për këtë qëllim janë:

Alpha Bank A.E., London Branch
66 Cannon Street
London EC4N 6EP

Telefaks: +44 207 236 1003
Në vëmendje të: Znj Rena Karagianni

28.2.4 Çdo Palë mund të ndryshojë hollësitat e kontakteve të tyre duke i dhënë Agjentit një njoftim pesë (5) Ditë Pune ose (në rastin e Agjentit) ndaj Palëve të tjera.

28.2.5 Kur një Palë cakton një departament ose nëpunës të veçantë të marrë një komunikim, një komunikim nuk do të jetë efektiv nëse nuk identifikon atë departament ose nëpunës.

28.3 Dorëzimi

28.3.1 Çdo komunikim ose dokument i bërë ose i dorëzuar nga një person ndaj një tjetri sipas ose në lidhje me Dokumentat e Financimit do të jetë efektiv vetëm:

a) Nëse bëhet me anë të faksit, kur merret në formë të lexueshme; ose

b) Nëse bëhet me anë të letrës, kur është lënë në adresën përkatëse ose pesë (5) Ditë Pune pasi të depozitohet në tarifën postare të parapaguar në një zarf të drejtuar atij në atë adresë,

dhe, nëse një departament ose nëpunës i veçantë specifikohet si pjesë e hollësirave të adresës së tij të parashikuar sipas Klauzolës 0 (Adresat), nëse i drejtohen atij departamenti ose nëpunësi.

28.3.2 Çdo komunikim ose dokument që duhet të bëhet ose t'i dorëzohet Agjentit do të jetë efektiv vetëm kur në të vërtetë merret nga Agjenti dhe vetëm nëse është shënuar shprehimisht në vëmendje të departamentit ose nëpunësit të identifikuar me nënshkrimin e Agjentit më poshtë (ose ndonjë departamenti ose nëpunësi zëvendësues që Agjenti do të specifikojë për këtë qëllim).

28.3.3 Të gjitha njoftimet nga ose për Huamarrësin do të dërgohet përmes Agjentit.

28.4 Njoftimi i adresës, numrit të faksit dhe numrit të teleksit

Menjëherë pas marrjes së njoftimit të një adrese ose numri faksi ose ndryshimit të adresës ose numrit të faksit sipas Klauzolës 28.2 (Adresat) ose ndryshimit të adresave, numrit të faksit ose numrit të tyre të teleksit, Agjenti do të njoftojë Palët e tjera.

28.5 Komunikimi elektronik

28.5.1 Çdo komunikim që duhet të bëhet ndërmjet Agjentit dhe një Huadhënësi sipas ose në lidhje me Dokumentat Financiare mund të bëhet me anë të postës elektronike ose mjeteve të tjera elektronike, nëse Agjenti dhe Huadhënësi përkatës:

a) Bien dakord që nëse nuk dhe deri kur të njoftohen për të kundërtën, kjo duhet të jetë një formë e pranuar e komunikimit;

b) Njoftojnë njëri tjetrin me shkrim për adresën e postës së tyre elektronike dhe/ose çdo informacion tjetër të kërkuar për të mundësuar dërgimin dhe marrjen e informacionit me anë të atij mjeti; dhe

c) Njoftojnë njëri tjetrin për çdo ndryshim të adresave të tyre ose ndonjë informacion tjetër të tillë të dhënë nga ta.

28.5.2 Çdo komunikim elektronik i bërë midis Agjentit dhe një Huadhënësi do të jetë efektiv kur në të vërtetë merret në një formë të lexueshme dhe në rastin e ndonjë komunikimi elektronik të bërë nga një Huadhënësi për Agjentin, vetëm nëse i drejtohet në mënyrë të tillë që Agjenti do ta specifikojë për këtë qëllim.

28.6 Përkthimet në gjuhën angleze

28.6.1 Çdo njoftim i dhënë sipas ose në lidhje me një Dokument Financimi duhet të jetë në gjuhën angleze.

28.6.2 Të gjitha dokumentet e tjera të parashikuara sipas ose në lidhje me një Dokument Financimi duhet të jenë:

a) në gjuhën angleze; ose

b) nëse nuk janë në gjuhën angleze dhe nëse kjo kërkohet nga Agjenti, do të jenë të shoqëruara nga një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze dhe në këtë rast do të ketë përparësi përkthimi në gjuhën angleze, nëse dokumenti nuk është një dokument kushtetues, statutor ose dokument tjetër zyrtar.

29 Llogaritjet dhe vërtetimet

29.1 Llogaritë

Në çdo çështje gjyqësore ose procedim arbitrazhi që lind nga ose në lidhje me një Dokument Financiar, regjistrimet e bëra në llogari të ruajtura nga një Palë Financuese janë prova prima facie të çështjeve me të cilat kanë lidhje.

29.2 Vërtetimet dhe përcaktimet

Çdo vërtetim ose përcaktim nga një Palë Financuese i një norme ose shume sipas ndonjë Dokumenti Financiar është, në mungesë të një gabimi të dukshëm, provë përfundimtare e çështjeve me të cilat ka lidhje.

29.3 Marrëveshja e llogaritjes së ditëve

Çdo interes, komision ose tarifë që rritet sipas një Dokumenti Financimi do të rritet ditë pas dite dhe do të llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve të kaluara dhe një vit me 360 ditë ose, në çdo rast kur praktika në Tregun Ndërbankar Përkates ndryshon, në përputhje me praktikën e atij tregu.

30 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse në një kohë të caktuar, ndonjë dispozitë e Dokumentave Financiare është e ligjshme ose bëhet e ligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në ndonjë aspekt sipas një ligji ose juridiksioni, as ligjshmëria, vlefshmëria ose moszbatueshmëria e dispozitave të mbetura, as ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e kësaj dispozite sipas ligjit të ndonjë juridiksioni tjetër, nuk do të çenohet ose dëmtohet në ndonjë mënyrë.

31 Kompensimet dhe heqjet dorë

Asnjë dështim për të ushtruar dhe as ndonjë vonesë në ushtrimin nga ana e ndonjë Pale Financuese e një të drejte ose kompensimi sipas Dokumentave Financiare, nuk do të operojë si heqje dorë, as ushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte ose kompensimi nuk do të pengojë ndonjë ushtrim tjetër të mëtejshëm ose ushtrimin e ndonjë të drejte ose kompensimi tjetër. Të drejtat dhe kompensimet e parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe jo ekskluzive për ndonjë të drejtë ose kompensim të parashikuar me ligj.

32 Amendimet dhe heqjet dorë

32.1 Pëlqimet e kërkuara

32.1.1 Në bazë të Klauzolës 0 (Përrjashtimet) çdo kusht i Dokumentave Financiare mund të amendohet ose hiqet dorë vetëm me pëlqimin e Huadhënësve të Shumicës dhe Huamarrësit dhe ky amendim ose heqje dorë do të jenë detyrues për të gjitha Palët.

32.1.2 Agjenti mund të bëjë në emër të ndonjë Pale Financuese çdo amendim ose heqje dorë të lejuar nga kjo Klauzolë.

32.2 Përrjashtime

32.2.1 Një amendim ose heqje dorë që ka fuqinë e ndryshimit ose që ka lidhje me:

a) Përkufizimin e Huadhënësve të Shumicës në Klauzolën 0 (Përkufizime);

b) Një shtyrje të datës së pagesës të ndonjë shume sipas Dokumentave Financiare;

c) Një ulje të Marzhit ose ulje në shumën e ndonjë pagese principali, interesi, tarifash ose komisioni të pagueshëm;

d) Një rritje ose zgjerim të ndonjë Detyrimi Financiar;

e) Një ndryshim tek Huamarrësi përveç atyre në përputhje me Klauzolën 0 (Ndryshime tek Huamarrësit);

f) Çdo dispozitë që kërkon shprehimisht pëlqimin e të gjithë Huadhënësve;

g) Klauzola 2.3 (të drejtat dhe detyrimet e Palëve Financuese), Klauzola 0 (Ndryshime tek Huadhënësit), Klauzola 0 (Ndarja mes Palëve Financuese) ose kjo Klauzolë 0; ose

h) Një shtyrje të Periudhës së Disponueshmërisë;

i) Një ndryshim në monedhën në të cilën ndonjë shumë është e pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe/ose ndonjë Dokumenti tjetër Financiar; ose

j) Një ndryshim ndaj urdhrin të shpërndarjes sipas Klauzolës 0 (Pagesa të Pjesshme),

Nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të të gjithë Huadhënësve (që, me efekt në dhe nga Data e Detyrimit Financiar të Shërbimit B (por jo më parë) do të përfshijë Huadhënësit e Shërbimit B).

32.2.2 Çdo amendim ose heqje dorë që ka lidhje me të drejtat ose detyrimet e Agjentit ose Rregulluesit mund të mos bëhet pa miratimin e Agjentit ose Rregulluesit.

32.2.3 Me efekt në dhe nga Data e Detyrimit Financiar të Shërbimit B (por jo më parë) referencat në këtë Marrëveshje dhe Dokumenta të tjera Financiare për “të gjithë Huadhënësit” ose shprehje të ngjashme do të përfshijnë Huadhënësit e Shërbimit B.

33 Numri i Kopjeve

Secili Dokument Financiar mund të përfundohet në çdo numër kopjesh dhe ka të njëjtën fuqi sikur nënshkrimet në kopje të ishin në një kopje të vetme të Dokumentit Financiar.

SEKSIONI 11 LIGJI RREGULLUES DHE ZBATIMI

34 Ligji Rregullues

Kjo Marrëveshje (duke përfshirë çdo detyrim kontraktual në lidhje me këtë Marrëveshje) rregullohet nga ligji anglez.

35 Arbitrazhi

35.1 Arbitrazhi

Në bazë të Klauzolës 0 (zgjedhja e Agjentit), çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me egzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje ose pasojat e anulimit të saj dhe çdo detyrim jokontraktual në lidhje me këtë Marrëveshje) (një Mosmarrëveshje) i referohet dhe zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi sipas Rregullave të Arbitrazhit (Rregullat) të Gjykatës LCIA .

35.2 Procedura për arbitrazh

a) Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre arbitruer. Kërkuesi (t) pavarësisht nga numri, do të caktojë bashkërisht një arbitruer; i/të paditurit, pavarësisht nga numri, do të caktojë bashkërisht arbitruesin e dytë dhe një arbitruer të tretë i cili do të shërbejë si Kryetar, do të emërohet nga Gjykata LCIA brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga emërimi i arbitruesit të dytë.

b) Në rast se kërkuesit (kërkuesve) ose të paditurit (të paditurve) do të dështojnë në caktimin e një arbitruer brenda afateve kohore të specifikuar në Rregullore, ky arbitruer do të emërohet nga Gjykata LCIA brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga kjo pamundësi veprimi. Në rast se si kërkuesi (t) dhe i/të paditurit dështojnë në caktimin e një arbitruer brenda afateve kohore të specifikuar në Rregullore, të tre arbitruerit do të emërohen nga Gjykata LCIA brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga kjo pamundësi veprimi që do të caktojë një prej tyre si kryetar.

c) Nëse të gjitha palët e një arbitrazhi bien dakord për këtë, do të ketë një arbitruer të vetëm të emëruar nga Gjykata LCIA brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga kjo marrëveshje.

d) Selia e arbitrazhit do të jetë Londër, Angli dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

e) Kur Mosmarrëveshjet që lindin sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Dokumenti tjetër Financiar, i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të gjykatës së parë të arbitrazhit, duhet të caktohet në ndonjë prej mosmarrëveshjeve, janë të lidhura aq ngushtë saqë është e përshtatshme që ato të zgjidhen në të njëjtat procedime, ajo gjykatë arbitrazhi do të ketë kompetencën për të urdhëruar që procedimet të zgjidhin atë mosmarrëveshje, do të bashkohen me to për të zgjidhur ndonjë nga mosmarrëveshjet e tjera (nëse procedime për të zgjidhur ato mosmarrëveshje të tjera janë nisur apo jo), me kusht që të mos jetë caktuar asnjë datë për seancën përfundimtare të arbitrazhit të parë. Nëse gjykata e arbitrazhit urdhëron kështu, palët e secilës mosmarrëveshje që i nënshtrohet urdhrit do të trajtohen sikur të kishin rënë dakord që ajo mosmarrëveshje të zgjidhej përfundimisht:

i) Nga gjykata e arbitrazhit e cila urdhëroi bashkimin e procedimeve, nëse Gjykata LCIA nuk vendos që nuk do të ishte e përshtatshme ose e paanshme; dhe

ii) Në përputhje me procedurën, në selinë dhe në gjuhën e specifikuar në marrëveshjen e arbitrazhit në kontratë sipas të cilës u caktua gjykata që urdhëroi bashkimin e procedimeve, përveç rasteve të rëna dakord ndryshe nga të gjitha palët e procedimeve të lidhura ose të bashkuara ose, në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, të urdhëruar nga gjykata e arbitrazhit në procedimet e lidhura ose të bashkuara.

35.3 Rekursi ndaj gjykatave

Me përjashtim të rasteve të parashikura në Klauzolën 0 (zgjedhja e Agjentit), palët përjashtojnë juridiksionin e gjykatave sipas Seksioneve 45 dhe 69 të Ligjit të Arbitrazhit 1996.

35.4 Zgjedhja e agjentit

Para se një arbitrues të caktohet nga një Palë Financuese për të përcaktuar një Mosmarrëveshje, Agjenti (dhe nëse udhëzohet nga Shumica e Huadhënësve) me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të kërkojë që të gjitha Mosmarrëveshjet ose një Mosmarrëveshje specifike të dëgjohet nga një gjykatë. Nëse Agjenti jep këtë njoftim, Mosmarrëveshja të cilës i referohet ky njoftim do të përcaktohet në përputhje me Klauzolën 0 (Juridiksion).

36 Zbatimi

36.1 Juridiksioni

36.1.1 Gjykatat e Anglisë kanë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo Mosmarrëveshje.

36.1.2 Palët bien dakord që gjykatat e Anglisë janë gjykatat më të përshtatshme dhe të duhura për të zgjidhur Mosmarrëveshjet dhe për pasojë, asnjë Palë nuk do të argumentojë për të kundërtën.

36.1.3 Kjo Klauzolë 0 është vetëm në interes të Palëve Financuese. Si rezultat, asnjë Palë Financuese nuk do të parandalohet nga fillimi i procedimeve në lidhje me një Mosmarrëveshje në ndonjë gjykatë tjetër me juridiksion. Në shkallën e lejuar me ligj, Palët Financuese mund të nisin procedime të njëkohshme në disa juridiksione.

36.2 Njoftimi

Pa çenuar ndonjë mënyrë tjetër njoftimi të lejuar sipas ndonjë ligji përkatës, Huamarrësi:

36.2.1 cakton në mënyrë të pakthyeshme Saville & Co. aktualisht në One Carey Lane, London EC2V 8AE, Angli, si agjentin e tij për njoftimin mbi ndonjë procedim para gjykatave angleze në lidhje me ndonjë Dokument Financimi;

36.2.2 bie dakord se dështimi nga ana e një agjenti procesi për të njoftuar Huamarrësin për procesin nuk do të zhvleftësojë procedimet përkatëse; dhe

36.2.3 bie dakord të caktojë një agjent tjetër me adresë në Angli, sipas rastit, menjëherë sipas kërkesës së Agjentit, dhe autorizon Agjentin të caktojë një agjent tjetër procesi nëse Huamarrësi dështon të caktojë një agjent pas asaj kërkesë.

Kjo Marrëveshje është lidhur në datën e përcaktuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

36.3 Heqja dorë

Huamarrësi bie dakord që, me përjashtim të sendeve pasurore që rregullohen nga dispozitat e Nenit 11, paragrafi 2 i Kushtetutës shqiptare dhe dispozitat e ligjit shqiptar nr 8743, datë 22 shkurt 2001 "Mbi Pasuritë e Paluajtshme Shqiptare" në lidhje me pasurinë publike dhe regjimin e saj pasuror: (a) në çdo padi ose procedim që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje kundër Huamarrësit ose një prej sendeve pasurore të tij, nuk pretendohet asnjë imunitet ndaj padisë ose procedimit (që përfshin, pa kufizim, paditjen, sigurimin e padisë, garanci të tjera, marrjen e vendimit, ekzekutimin ose një zbatim tjetër) nga ose në emër të Huamarrësit në lidhje me një prej sendeve pasurore të tij; (b) heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo e drejtë e tillë imuniteti që ai ose një prej sendeve pasurore të tij tashmë kanë ose mund të përftojnë më vonë ose që mund t'i vishet atij ose një prej sendeve pasurore të tij dhe (c) bie dakord përgjithësisht në lidhje me çdo padi ose procedim të tillë për dhënien e mundësisë ose nxjerrjen e vendimit në lidhje me një padi ose vendim të tillë duke përfshirë, pa kufizim, përpilimin, zbatimin ose ekzekutimin kundër çdo pasurie (pavarësisht nga përdorimi i saj ose përdorimi i synuar) i një vendimi ose urdhri që mund të bëhet ose jepet në lidhje me këtë padi ose procedim.

SEKSIONI 12
HYRJA NË FUQI

37 Hyrja në fuqi
Kjo Marreveshje do të hyjë në fuqi pas ekzekutimit nga palet dhe ratifikimit nga Parlamenti i Shqipërisë.

Programi 1
Huadhënësit Fillestarë

Emri i Huadhënësit Fillestar	Detyrimi Financiar i Shërbimit A (€)	Detyrimi Financiar i Shërbimit B (€)
Alpha Bank A.E., Dega Londer	50,000,000	0
Deutsche Bank AG, Dega Londer	[•]	0
National Bank of Greece S.A., Dega Londer	30,000,000	0
Piraeus Bank S.A., Dega Londer	20,000,000	0
[•]	[•]	0
[•]	[•]	0
Totali	[•]	0

Programi 2
Kushte Paraprake

1. Huamarrësi

a) Një kopje, e Ligjit të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë të publikuar në Gazetën Zyrtare që provon ratifikimin e Dokumenteve të nënshkuara Financiare pa ndryshime të bashkëlidhura mendimit të përmendur në paragrafin 2(a) më poshtë.

b) Një kopje të vërtetuar me origjinalin të Autorizimit të Kryeministrit të Huamarrësit, të nënshkruar nga ky i fundit dhe gjithashtu nga Ministri i Punëve të Jashtme, që autorizon Ministrin e Financave të Huamarrësit për të përfunduar dhe dorëzuar Dokumentet Financiare, çdo Kërkesë Shfrytëzimi, Kërkesën për Shtyrje dhe çdo Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit .

c) Nëse Ministri i Financave të Huamarrësit ka autorizuar ndonjë person tjetër në vendin e tij për të egzekutuar Kërkesat e Shfrytëzimit, Kërkesën për Shtyrje ose ndonjë Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letrën e Pranimit në emër të Huamarrësit, një kopje të vërtetuar të Prokurës përkatëse të egzekutuar rregullisht nga Ministri i Financave të Huamarrësit (dhe të noterizuar).

1 Mendimet ligjore

a) Një mendim të Ministrit të Drejtësisë të Huamarrësit, të datës jo më parë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune para datës së Shfrytëzimit të parë, në formë ose kryesisht në formën e përcaktuar në programin 7 (Formulari i Mendimit Ligjor të Huamarrësit) që bashkëlidh dhe vërteton me origjinalin një kopje të ligjit të përmendur në paragrafin 1(a) më sipër .

b) Një mendim i Kalo&Associates, këshilltarë të veçantë ligjorë në Republikën e Shqipërisë për Huadhënësit i datës jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para Datës së parë të Shfrytëzimit, në formë ose kryesisht në formën e përcaktuar në programin 8 (Formulari i Mendimit Ligjor Shqiptar të Huamarrësve).

c) Një mendim i këshilltarëve të veçantë ligjorë për Huadhënësit mbi çështjet e ligjit anglez të datës jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para Datës së parë të Shfrytëzimit, në një formë të pranueshme për Rregulluesit dhe Agjentin në të gjitha drejtimet.

Agjenti do të udhëzojë Kalo & Associates dhe këshilltarët e veçantë ligjorë për Huadhënësit mbi çështjet e ligjit anglez, për të dhënë mendimet e tyre ligjore të përmendura në paragrafët 2 (b) dhe (c) më sipër, përkatësisht brenda një (1) Dite pune nga dhënia e mendimit ligjor të Ministrit të Drejtësisë së Huamarrësit të përmendur në paragrafin 2(a) më sipër (por jo para se Ligji i Parlamentit të Republikës së Shqipërisë të përmendur në paragrafin 1(a) më sipër të ketë hyrë në fuqi, sipas mendimit të këshilltarëve ligjorë të Agjentit) me kusht që ky mendim ligjor i Ministrit të Drejtësisë së Huamarrësit të

jetë i plotë dhe në formë të pranueshme për Agjentin dhe avokatët dhe të gjitha kushtet e tjera paraprake të përmendura në këtë Grafik 2, t'i jenë dorëzuar Agjentit dhe avokatëve të tyre në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

2 Dokumenta dhe prova të tjera

a) Prova që çdo agjent procesi i përmendur në Klauzolën 0 (Njoftimi) ka pranuar caktimin e tij.

b) Një kopje të ndonjë Autorizimi tjetër (duke përfshirë çdo Autorizim nga organe përkatëse ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar) ose ndonjë dokument, mendim ose garanci tjetër që Agjenti e konsideron të nevojshme ose të dëshirueshme (nëse ka njoftuar Huamarrësin në mënyrën e duhur) në lidhje me angazhimin në të dhe kryerjen e tranzaksioneve të parashikuara nga ndonjë Dokument Financiar ose për vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e ndonjë Dokumenti Financiar.

c) Çdo Letër Tarifore e përmendur në Klauzolën 0 (Tarifat) e egzekutuar rregullisht nga Huamarrësi dhe palët e tjera për to dhe që provon se tarifat, kostot dhe shpenzimet në atë kohë të kërkueshme nga Huamarrësi sipas Klauzolës 0 (Tarifat) dhe Klauzolës 0 (Kostot dhe Shpenzimet) janë paguar ose do të paguhen nga Data e parë e Shfrytëzimit.

PROGRAMI 3

Kërkesat

PJESA 1

KËRKESË SHFRYTËZIMI

Nga: Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave duke vepruar nëpërmjet Ministrisë së Financave)

Për: Alpha Bank A.E., Dega e Londrës
si Agjente

Datë:

Të nderuar zotërinj

Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave duke vepruar nëpërmjet Ministrisë së Financave) - Marrëveshje Shërbimi prej deri në 250,000,000 € të datës [•] 2009 (Marrëveshja)

1. Ne i referohemi Marrëveshjes. Kjo është një Kërkesë Shfrytëzimi. Kushtet e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në këtë Kërkesë Shfrytëzimi nëse nuk jepet një kuptim i ndryshëm në këtë Kërkesë Shfrytëzimi.

2. Ne dëshirojmë të japim një Hua në bazë të kushteve të mëposhtme:

Data e Propozuar e Shfrytëzimit:	[•] (ose, nëse ajo nuk është Ditë Pune, Dita pasuese e Punës)
Shërbimi që duhet të shfrytëzohet	Shërbimi [A]/[B]*
Shuma:	€[•] ose, nëse është më pak, Available Facility
Periudha e Interesit:	[•]

3. Ne konfirmojmë se çdo kusht i specifikuar në Klauzolën 0 (kushte të mëtejshme paraprake) përmbushet në datën e kësaj Kërkesë Shfrytëzimi.

4. Të ardhurat e kësaj Huaje duhet të kreditohen në [llogaria].

5. Kjo Kërkesë Shfrytëzimi është e pakthyeshme.

Me respekt

.....

nënshkruesi i autorizuar për

REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave duke vepruar nëpërmjet Ministrisë së Financave)

* Fshini nëse është e papërshtatshme

PJESA 2
KËRKESE PËR SHTYRJE

Nga: Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave duke vepruar nëpërmjet Ministrit të saj të Financave)

Për: Alpha Bank A.E., Dega e Londrës
si Agjente

Datë:

Të nderuar zotërinj

Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) -Marrëveshje Shërbimi prej derri ne 250,000,000 € të datës [●] 2009 (Marrëveshja)

1. Ne i referohemi Marrëveshjes. Kjo është një Kërkesë Shtyrjeje për qëllim të Klauzolës 6.2 (Opsioni i Shtyrjes) të Marrëveshjes. Kushtet e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në këtë Kërkesë Shtyrjeje.

2. Ne kërkojmë që Data e Maturimit të shtyhet për njëzet e katër (24) muaj të tjerë në përputhje me kushtet e Klauzolës 6.2 (Opsioni i Shtyrjes) të Marrëveshjes.

3. Kjo Kërkesë Shtyrjeje është e pakthyeshme dhe rregullohet nga ligji anglez.

Me respekt

.....

nënshkruesi i autorizuar për

REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave)

PJESA 3
NJOFTIM PËRGJIGJEJE PËR SHTYRJE

Nga: [●] [Huadhënësi Shtyrës]

Për: Alpha Bank A.E., Dega e Londrës
si Agjente

Për: Republikën e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave)

Datë:

Të nderuar zotërinj

Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave)- Marrëveshje Shërbimi prej deri ne 250,000,000 € të datës [●] 2009 (Marrëveshja)

1. Ne i referohemi Marrëveshjes. Ky është një Njoftim Përgjigjeje për Shtyrje për qëllim të Klauzolës 6.2 (Opsioni i Shtyrjes) të Marrëveshjes. Kushtet e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në këtë Njoftim të Përgjigjes për Shtyrje.

2. Ne jemi dakord që Data e Maturimit të shtyhet për njëzet e katër (24) muaj të mëtejshëm në përputhje me kushtet e Klauzolës 0 (Opsioni i Shtyrjes) të Marrëveshjes në lidhje me [shumën e përgjithshme të kontributit tonë në Huatë (që është €[●])/ [pjesë vetëm e kontributit tonë në Huatë, e barabartë me €[●]]*. Rrjedhimisht, miratimi ynë jepet dhe është në fuqi pa kërkesë për ndonjë tarifë të parashikuar për të dhe në ndonjë formë tjetër, në përputhje me kushtet e klauzolës 0 (Opsioni i Shtyrjes).

3. Ky Njoftim për Përgjigjen për Shtyrje është i pakthyeshëm dhe rregullohet nga ligji anglez.

Me respekt

.....

nënshkruesi i autorizuar për

[●]

[Huadhënësi Shtyrës]

- Per tu fshire nese eshte e pershtatshme

PROGRAMI 4
FORMULA E KOSTOS SË DETYRUESHME

1. Kostoja e detyrueshme është një shtesë ndaj normës së interesit për të kompensuar Huadhënësit për koston e pajtueshmërisë me (a) kërkesat e Bankës së Anglisë dhe/ose Autoritetit të Shërbimeve Financiare (ose, në çdo rast, një autoritet tjetër që zëvendëson të gjitha ose ndonjë prej funksioneve të tij ose (b) kërkesat e Bankës Qendrore Europiane.

2. Në ditën e parë të çdo Periudhe Interesi (ose sa më shpejt që të jetë e mundur më pas), Agjenti do të llogarisë si normë përqindjeje, një normë (Norma e Kostos Shtesë) për secilin Huadhënës, në përputhje me paragrafët e parashtruar më poshtë. “Kostoja e Detyrueshme” është norma e llogaritur nga Agjenti si mesatare e vlerësuar e Normave të Kostove Shtesë të Huadhënësve (e vlerësuar në raport me kontributin e përqindjes së secilit Huadhënës në Huanë përkatëse) dhe do të shprehet si normë përqindjeje në vit.

3. Norma e Kostos Shtesë për çdo Huadhënës që jep hua nga një Zyrë Shërbimi në një Shtet Anëtar Pjesëmarrës do të jetë përqindja e njoftuar nga ai Huadhënës për Agjentin. Kjo përqindje do të vërtetohet nga ai Huadhënës në njoftimin e tij për Agjentin që të jetë përcaktimi i tij i arsyeshëm i koston (të shprehur si përqindje të atij kontributi të Huadhënësit në të gjitha Huatë e dhëna nga ajo Zyrë Shërbimi) për pajtimin me kërkesat rezervë minimale të Bankës Qendrore Europiane në lidhje me huatë e dhëna nga ajo Zyrë Shërbimi.

4. Norma e Kostos Shtesë për çdo Huadhënës që jep hua nga një Zyrë Shërbimi në Mbretërinë e Bashkuar do të llogaritet nga Agjenti si më poshtë:

$$\frac{E \times 0.01}{300}$$

300 për qind në vit.

Ku:

E planifikohet të kompensojë Huadhënësit për shumat e pagueshme sipas Rregullave Tarifore dhe llogaritet nga Agjenti sikur të ishte mesatarja e normave më të fundit të tarifës së dhënë nga Bankat e Referencës ndaj Agjentit, sipas paragrafit 7 më poshtë dhe shprehur në stërlina për £1,000,000.

5. Për qëllimet e këtij programi:

a) Rregullat Tarifore nënkuptojnë rregullat mbi tarifa periodike në Manualin e Mbikqyrjes së FSA-së ose ndonjë ligj apo rregullore tjetër të tillë që mund të jetë në fuqi herë pas here në lidhje me pagesën e tarifave për pranimin e depozitave;

b) Tarifat e Detyrimeve nënkuptojnë tarifat e detyrimeve të specifikuara në Rregullat e Tarifave sipas grupit të aktivitetit A.1 të pranuesve të Depozitës (duke injoruar çdo shumë minimale ose tarifë të kuotuar me zero, të kërkuar sipas Rregullave Tarifore por duke marrë në konsideratë çdo normë të zbatueshme të zbritjes); dhe

c) Baza e Tarifës ka kuptimin që i është dhënë dhe do të llogaritet në përputhje me Rregullat Tarifore.

6 Shifra rezultuese do të rumbullakoset në katër vende dhjetore.

7 Nëse kërkohet nga Agjenti, çdo Bankë Reference, sa më parë që të jetë e mundur pas publikimit nga Autoriteti i Shërbimeve Financiare, do t'i japë Agjentit normën tarifore të pagueshme nga ajo Bankë Reference për Autoritetin e Shërbimeve Financiare sipas Rregullave Tarifore në lidhje me vitin përkatës financiar të Autoritetit të Shërbimeve Financiare (llogaritur për këtë qëllim nga ajo Bankë Reference si mesatare e Tarifave të Detyrimeve të zbatueshme për atë Bankë Reference për atë vit financiar) dhe shprehur në stërlina për £1,000,000 të Bazës së Tarifës së asaj Banke Reference.

8 Secili Huadhënës do të japë çdo informacion të kërkuar nga Agjenti për qëllim të llogaritjes së Kostos së tij Shtesë. Në veçanti, por pa u kufizuar, çdo Huadhënës do të japë informacionin e mëposhtëm në ose para datës në të cilën bëhet Huadhënës:

a) Juridiksionin e Zyrës së tij të Shërbimit; dhe

b) çdo informacion tjetër që Agjenti mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për këtë qëllim.

9 Çdo Huadhënës do të njoftojë menjëherë Agjentin për ndonjë ndryshim në informacionin e dhënë nga ai sipas këtij paragrafi.

10 Normat e tarifave të secilës Bankë Reference për qëllim të E më sipër do të përcaktohen nga Agjenti mbi bazën e informacionit të dhënë sipas paragrafëve 7 dhe 8 më sipër dhe mbi supozimin se nëse një Huadhënës nuk njofton Agjentin për të kundërtën, detyrimet e çdo Huadhënësi në lidhje me

raportet e depozitave në lekë dhe Depozitave të Veçanta janë të njëjta me ato të një banke tipike nga juridiksioni i saj i inkomporimit me një Zyrë Shërbimi në të njëjtin juridiksion si Zyra e saj e Shërbimit.

11 Agjenti nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ndonjë personi nëse ky përcaktim rezulton në një Normë Kostoje Shtesë që mbikompenson ose nënkompenson një Huadhënës dhe do të ketë të drejtë të supozojë që informacioni i dhënë nga ndonjë Huadhënës ose Bankë Reference sipas paragrafëve 3, 7 dhe 8 më sipër, është i vërtetë dhe i saktë në të gjitha drejtimit.

12 Agjenti do të shpërndajë shumat shtesë të marra si rezultat i Kostos së Detyrueshme për Huadhënësit mbi bazën e Normës së Kostos Shtesë për secilin Huadhënës, bazuar në informacionin e dhënë nga çdo Huadhënës dhe çdo Bankë Reference sipas paragrafëve 3, 7 dhe 8 më sipër.

13 Çdo përcaktim nga Agjenti sipas këtij programi në lidhje me një formulë, një Normë të Kostos Shtesë ose një shumë të pagueshme ndaj Huadhënësit, në mungesë të ndonjë gabimi të dukshëm, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjitha Palët.

14 Pas konsultimit me Huamarrësin dhe Huadhënësit, Agjenti mund të përcaktojë herë pas here dhe njoftojë të gjitha Palët për një amendim që kërkohet të bëhet në këtë grafik, me qëllim që të pajtohet me ndonjë ndryshim në ligj, rregullore ose kërkesë herë pas here të vendosur nga Banka e Anglisë, Autoriteti i Shërbimeve Financiare ose Banka Qendrore Europiane (ose, në çdo rast, ndonjë autoritet tjetër që zëvendëson të gjitha ose ndonjë prej funksioneve të saj) dhe çdo përcaktim i tillë, në mungesë të ndonjë gabimi të dukshëm, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjitha Palët.

PROGRAMI 5 FORMULARI I ÇERTIFIKATËS SË TRANSFERIMIT

Drejtuar: [•] si Agjent

Nga: [Huadhënësi Egzistues] (Huadhënësi Egzistues) dhe [Huadhënësi I Ri] (Huadhënësi i Ri)

Datë:

Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave duke vepruar nëpërmjet Ministrin të saj të Financave) Marrëveshje Shërbimi prej deri në 250,000,000 € datë [•] 2009 (Marrëveshja)

1. Ne i referohemi Marrëveshjes. Kjo është një Çertifikatë Transferimi. Kushtet e përcaktuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në këtë Çertifikatë Transferimi për sa kohë që nuk u jepet një kuptim i ndryshëm në këtë Çertifikatë Transferimi.

2. I referohemi Klauzolës 0 (Procedura për transferim):

a) Huadhënësi Egzistues dhe Huadhënësi i Ri bien dakord ndaj Huadhënësit Egzistues duke i transferuar Huadhënësit të Ri me anë të shtyrjes të gjithë ose pjesë të Detyrimit Financiar, të drejtave dhe detyrimeve të Huadhënësit Egzistues, të përmendura në Grafik në përputhje me Klauzolën 0 (Procedura për transferim).

b) Data e propozuar e Transferimit është [•].

c) Zyra e Shërbimit dhe adresa, numri i faksit dhe hollësitat e kontaktit për njoftime të Huadhënësit të Ri për qëllimet e Klauzolës 28.2 (Adresat) përcaktohen në Grafik.

3. Huadhënësi i Ri pranon shprehimisht kufizimet mbi detyrimet e Huadhënësit Egzistues, të përcaktuara në Klauzolën 0 (Kufizim i përgjegjësisë së Huadhënësve Egzistues).

4. Kjo Çertifikatë Transferimi mund të egzekutohet në disa kopje dhe kjo ka të njëjtiën fuqi sikur nënshkrimet në kopje të ishin në një kopje të vetme të kësaj Çertifikate Transferimi.

5. Kjo Çertifikatë Transferimi rregullohet nga ligji anglez.

PROGRAMI
ANGAZHIMI/TË DREJTAT DHE DETYRIMET QË DUHET TË TRANSFEROHEN

[vendosni hollësitat përkatëse]

[Adresa e Zyrës së Shërbimit, numri i faksit dhe hollësitat e kontaktit për njoftime dhe hollësira të llogarive për pagesat,]

[Huadhënësi Egzistues]

[Huadhënësi i Ri]

Nga:

Nga:

Kjo Çertifikatë Transferimi pranohet nga Agjenti dhe Data e Transferimit konfirmohet si [●].

[Agjenti]

Nga:

PROGRAMI 6
GRAFIQET KOHORE

Dorëzimi i një Kërkese U - 4
Shfrytëzimi të plotësuar 10.00 paradite.
siç duhet (Klauzola 0
(Dorëzimi i një Kërkese
Shfrytëzimi))

Agjenti njofton U - 3]
Huadhënësit për Huanë Mesditë
në përputhje me
Klauzolën 0 (kontributi
i Huadhënësve)

EURIBOR është Dita e Kuotimit me
vendosur orën 11 paradite të
kohës së Brukselit

“U” = data e Shfrytëzimit

“U - X” = Ditë Pune para datës së Shfrytëzimit

PROGRAMI 7
FORMULARI I MENDIMIT LIGJOR TË HUAMARRËSIT

PROGRAMI 8
FORMULARI PËR MENDIMIN LIGJOR SHQIPTAR TË HUADHËNËSVE

PROGRAMI 9
DETYRIMI FINANCIAR I SHËRBIMIT B DHE LETRA E PRANIMIT

Nga: Republika e Shqipërisë (e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrisë së Tregëtisë dhe Financave)

Nga: [●] [vendosni emrin e Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B]

Për: Alpha Bank A.E., Dega e Londrës
si Agjente

Per: Alpha Bank A.E.
si Rregullues

Per: Deutsche Bank AG, London Branch
si Rregullues

Datë:

Të nderuar zotërinj

Republika e Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrisë së Tregëtisë dhe Financave) – Marrëveshje Shërbimi prej €250,000,000 datë [●] 2009 (Marrëveshja)

1. Në referencën Marrëveshjes. Ky është një Detyrim Financiar i një Shërbimi B dhe Letër Pranimit. Termat e përkufizuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në këtë Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letër Pranimit, nëse nuk u jepet një kuptim i ndryshëm në këtë Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe Letër Pranimit.

2. Në referencën Klauzolës 2.2 (Shërbimi B) të Marrëveshjes:

a) Data e Pranimit të Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B është [●] 2009.

b) Me efekt nga Data e Pranimit të Huadhënësit të Shërbimit B, Detyrimi Financiar i Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B do të jetë €[●].

c) Monedha është Euro.

d) [Zyra e Shërbimit dhe adresa, numri i faksit dhe hollësia të kontaktit për njoftime të Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B, për qëllime të Klauzolës 28.2 (Adresa) të Marrëveshjes janë [●].]†

3. Huamarrësi konfirmon se shuma e përgjithshme e të gjitha Detyrimeve Financiare të Shërbimit B që propozohen të përdoren nga të gjithë Huadhënësit e Propozuar të Shërbimit B në Datën e Pranimit të Huadhënësit të propozuar të Shërbimit B, është €[●].

4. Huamarrësi konfirmon se asnjë Mosplotësim i Detyrimeve nuk po vazhdon ose do të rezultonte nga Shërbimi i kërkuar B që vihet në dispozicion mbi bazë përdorimi.

5. Me efekt nga Data e Pranimit e Huadhënësit të Shërbimit B, Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B merr përsipër të përmbushë, respektojë dhe bjerë dakord për të qënë i detyruar ligjërisht nga kushtet e Marrëveshjes dhe Dokumentave të tjera Financiare dhe merr përsipër të gjitha të drejtat, interesat dhe detyrimet (të tashme dhe të ardhshme, aktuale dhe të mundshme) që një Huadhënësi ka sipas dhe në bazë të Marrëveshjes dhe secilës prej Dokumentave të tjera Financiare në të cilat është palë në lidhje me Detyrimin Financiar të Shërbimit të saj B të specifikuar më sipër.

6. Huadhënësi i propozuar i Shërbimit B i konfirmon Agjentit dhe Palëve të tjera Financiare (por jo Huamarrësit) se:

a) Ka marrë një kopje të Marrëveshjes dhe secilit prej Dokumentave të tjera Financiare dhe të gjithë dokumentacionin tjetër dhe informacionin e kërkuar nga ai në lidhje me tranzaksionet e parashikuara nga ky Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit;

b) Ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë vlerësimin e vet të ligjshmërisë, vlefshmërisë, efektivitetit, mjaftueshmërisë dhe zbatueshmërisë së Marrëveshjes, Dokumentave të tjera Financiare dhe këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit dhe nuk është mbështetur dhe nuk do të mbështetet në ndonjë prej Huadhënësve, Rregulluesve, Agjentit ose në ndonjë deklaratë të bërë nga ndonjë prej tyre në këtë drejtim;

c) Ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë vlerësimin e vet të gjendjes financiare, sendeve pasurore

† Duhet të përfshihet nëse Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B nuk është një huadhënësi egzistues

dhe prospekteve të Huamarrësit dhe të zbatimit të ndonjë rregulloreje përkatëse për tranzaksionet e parashikuara nga Dokumentat Financiare dhe nuk është mbështetur dhe nuk do të mbështetet tek ndonjë prej Huadhënësve, Rregulluesve ose Agjenti ose në ndonjë deklaratë të bërë nga ndonjë prej tyre në lidhje me një nga ato çështje; dhe

d) Rrjedhimisht, asnjë prej Huadhënësve, Rregulluesve dhe Agjenti nuk kanë asnjë përgjegjësi ose detyrim ndaj Huadhënësit të propozuar të Shërbimit B në lidhje me ndonjë prej çështjeve të mësipërme.

7 Huamarrësi i Propozuar i Shërbimit B bie dakord dhe i konfirmon agjentit dhe Palëve të tjera Financiare (por jo Huamarrësit) se Huadhënësit, Rregulluesit dhe Agjenti nuk bëjnë asnjë përfaqësim ose garanci dhe nuk marrin përsipër asnjë përgjegjësi ose detyrim në lidhje me ligjshmërinë, vlefshmërinë, efektivitetin, mjaftueshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë prej Marrëveshjes, Dokumentave të tjera Financiare dhe këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit dhe nuk marrin përsipër asnjë përgjegjësi ose detyrim për gjendjen financiare, sendet pasurore dhe prospektet e Huamarrësit ose për përmbushjen nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas Dokumentave Financiare dhe ndonjë dhe të gjitha këtyre përfaqësimeve dhe garancive, qoftë të shprehura ose të nënkuptuara me ligj ose ndryshe, janë përjashtuar dhe hequr dorë në këtë mënyrë nga Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B.

8 Me anë të kësaj, Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B bie dakord në lidhje me secilin prej Huadhënësve, Huamarrësin, Agjentin dhe secilën prej Palëve të tjera që do të përmbushë në përputhje me kushtet e tyre të gjitha detyrimet që në bazë të termave përkatëse të Marrëveshjes, Dokumentave të tjera Financiare dhe këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit, do të merren përsipër nga ai pas pranimit (me kundërfirmosje) të këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit nga Agjenti dhe Rregulluesit, nëse një Huadhënës tashmë nuk cakton Agjentin të veprojë si agjentin e tij siç parashikohet dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes dhe Dokumentave të tjera Financiare dhe bie dakord të respektojë kushtet e Marrëveshjes dhe Dokumentave të tjera Financiare.

9 Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B pranon se asnjë Huadhënës tjetër nuk ka ndonjë detyrim për të blerë ose përftuar të gjitha ose ndonjë prej të drejtave, interesave dhe detyrimeve të përftuara në bazë të këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit për të dëmshpërblyer ose kompensuar Huadhënësin e Propozuar të Shërbimit B për ndonjë humbje të pësuar nga Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B si pasojë e pranimit të bërë në bazë të këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit ose për shkak të zbatimit të ndonjë rregulloreje për tranzaksionet e parashikuara nga Dokumentat Financiare ose ndryshe.

10 Huadhënësi i propozuar i Shërbimit B:

a) I garanton Agjentit dhe secilës prej Palëve të tjera Financiare që ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të autorizuar egzekutimin dhe dorëzimin e këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit; dhe

b) I garanton Agjentit dhe Rregulluesve që ky Detyrim i Shërbimit B dhe kjo Letër Pranimit janë detyruese mbi të sipas ligjeve (i) të Anglisë dhe Uellsit (ii) sipas të cilave Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B është inkorporuar, dhe (iii) të juridiksionit në të cilin ndodhet Zyra e tij e Shërbimit.

11 Me egzekutimin e këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit (duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, në emër të tyre nga Agjenti) dhe në mbështetje të përfaqësimeve dhe garancive të Huadhënësit të Propozuar të Shërbimit B dhe Huamarrësit në përmbajtje të saj, Huamarrësi, Agjenti, Huadhënësit dhe secila prej Palëve të tjera pranon Huadhënësin e Propozuar të Shërbimit B si një Palë (si një Huadhënës) në Marrëveshje dhe Dokumenta të tjera Financiare në lidhje me të gjitha të drejtat, interesat dhe detyrimet që në bazë të Marrëveshjes, Dokumentave të tjera Financiare dhe këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit do të merren përsipër nga Huadhënësi i Propozuar i Shërbimit B (duke përfshirë, pa kufizim, ato dispozita në lidhje me ndarjen mbi bazë proporcionale dhe përjashtimin e përgjegjësisë nga ana e dhe zhdëmtimin e Agjentit dhe Rregulluesve) pas pranimit (me kundërfirmosje) të këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimit nga Agjenti dhe Rregulluesit.

12 Huadhënësi i propozuar i Shërbimit B merr përsipër me secilën prej Palëve të tjera të Marrëveshjes që të përmbushë të gjitha ato detyrime që, në bazë të kushteve të Marrëveshjes, do të merren përsipër nga ai pas egzekutimit të kësaj certifikate nga Agjenti dhe Rregulluesit.

13 Ky Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe kjo Letër Pranimi janë të pakthyeshme.

14 Ky Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe kjo Letër Pranimi mund të egzekutohen në disa kopje dhe kjo ka të njëjtin efekt sikur nënshkrimet në kopje të ishin në një kopje të vetme të këtij Detyrimi Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimi.

Ky Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe kjo Letër Pranimi dhe çdo detyrim jokontraktual i lidhur me të rregullohen nga ligji anglez.

EGZEKUTUAR SI AKT

[duhet të përfshijnë bllokun e nënshkrimeve përkatëse për Huamarrësin dhe bllokun e nënshkrimeve për Huadhënësin e Propozuar të Shërbimit B]

Ky Detyrim Financiar i Shërbimit B dhe kjo Letër Pranimi pranohen nga Agjenti dhe Rregulluesit, dhe Data e Pranimit të Huadhënësit të Shërbimit B konfirmohet si [●].

[Agjenti]

[Rregulluesit]

Nga:

[Shënim: Huamarrësi i Propozuar i Shërbimit B duhet të sigurojë që të gjitha kërkesat rregullatore të përmbushen në lidhje me këtë Detyrim Financiar të Shërbimit B dhe kësaj Letre Pranimi.]

NËNSHKRUAR nga)
dhe nga) Nënshkrues i autorizuar
për dhe në emër të)
PIRAEUS BANK S.A., DEGA E LONDRES)
Si Huadhënës) Nënshkrues i autorizuar

NËNSHKRUAR nga)
dhe nga) Nënshkrues i autorizuar
për dhe në emër të)
[●])
Si Huadhënës) Nënshkrues i autorizuar

NËNSHKRUAR nga)
dhe nga) Nënshkrues i autorizuar
për dhe në emër të)
[●])
Si Huadhënës) Nënshkrues i autorizuar

Për Republikën e Shqipërisë
Ministria e Financave

Të nderuar zotërinj:

Letër tarifore

1. Kjo letër është shtojcë e marrëveshjes së shërbimeve të datës [●] 2009 (Marrëveshja) të bërë ndërmjet (i) Republikës së Shqipërisë (të përfaqësuar nga Këshilli i saj i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) si huamarrës (Huamarrësi), (ii) Alpha Bank A.E. dhe Deutsche Bank AG, Dega e Londrës si rregullues në këtë cilësi rregulluesit dhe rregulluesi nënkupton secilën prej tyre), (iii) bankat dhe institucionet financiare të përmendura në grafikun 1 të kësaj Marrëveshjeje si huadhënës (së bashku, Huadhënësit) dhe (iv) Alpha Bank A.E., Dega e Londrës si agjente (në këtë cilësi, Agjenti), sipas së cilës Huadhënësit kanë rënë dakord (ndër të tjera) të vënë në dispozicion të Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve në përmbajtje të saj, shumën e principalit deri në dyqind e pesëdhjetë milionë euro (€ 250,000,000). Kjo letër është një prej letrave tarifore të përmendura në marrëveshje.

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe ose nëse nuk janë përkufizuar ndryshe në të, kanë të njëjtat kuptime kur përdoren në këtë letër.

3. Në bazë të paragrafit 4 më poshtë, Huamarrësi do t'i paguajë Agjentit në datën e shfrytëzimit të parë:

a) për llogari të Rregulluesve (dhe për ndarjen dhe shpërndarjen midis Rregulluesve në ato pjesë që bihen dakord veçmas ndërmjet tyre në diskrecionin absolut të Rregulluesve), një tarifë rregullimi prej [●] euro (€ [●]) që përfaqëson 2.00% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit A, sipas Marrëveshjes; dhe

b) Për llogari të Huadhënësve të Shërbimit A me bazë proporcionale, në përputhje me Detyrimet Financiare të Shërbimit A, një tarifë reale të siguruar prej [●] euro (€ [●]) që përfaqëson 0.75% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit A, sipas Marrëveshjes.

4. Nëse Data e Shfrytëzimit të Parë nuk ka ndodhur deri në datën që bie dyzet e pesë (45) ditë kalendarike pas datës së Marrëveshjes (Data e Ndërprerjes), atëherë, tarifa e rregullimit dhe tarifa reale e siguruar, e përmendur në paragrafin 3 më sipër, nuk do të jetë më e pagueshme por Huamarrësi do t'i paguajë Agjentit në Ditën e Parë të Punës që bie menjëherë pas Datës së ndërprerjes:

a) Për llogari të Rregulluesve (dhe për ndarje dhe shpërndarje midis Rregulluesve në raporte të tilla që janë rënë dakord veçmas midis tyre në diskrecionin absolut të Rregulluesve), një tarifë bashkërendimi prej [●] euro (€ [●]) që përfaqëson 2.00% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit A, sipas Marrëveshjes; dhe

b) Për llogari të Huadhënësve të Shërbimit A me bazë proporcionale, në përputhje me Detyrimet Financiare të Shërbimit A, një tarifë reale të siguruar prej [●] euro (€ [●]) që përfaqëson 0.75% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit A, sipas Marrëveshjes.

5. Në bazë të paragrafit 6 më poshtë, huamarrësi do t'i paguajë Agjentit në datën e Shfrytëzimit të Dytë:

a) Për llogari të Rregulluesve (dhe për ndarje dhe shpërndarje midis Rregulluesve në raporte të tilla që janë rënë dakord veçmas midis tyre në diskrecionin absolut të Rregulluesve), një tarifë rregullimi prej [●] euro (€ [●]) që përfaqëson 2.00% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit B, sipas Marrëveshjes; dhe

b) Për llogari të Huadhënësve të Shërbimit B me bazë proporcionale, në përputhje me Detyrimet Financiare të Shërbimit B, një tarifë reale të siguruar prej [●] euro (€ [●]) që përfaqëson 0.75% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit B, sipas Marrëveshjes.

6. Nëse Data e Shfrytëzimit të Dytë nuk ka ndodhur deri në datën që bie pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas datës së Detyrimit Financiar të Shërbimit B, atëherë, tarifa e rregullimit dhe tarifa reale e siguruar, e përmendur në paragrafin 5 më sipër, nuk do të jetë më e pagueshme, por Huamarrësi do t'i paguajë Agjentit në Ditën e Parë të Punës që bie menjëherë pas Datës së Detyrimit Financiar të Shërbimit B:

a) Për llogari të Rregulluesve (dhe për ndarje dhe shpërndarje midis Rregulluesve në raporte të tilla që janë rënë dakord veçmas midis tyre në diskrecionin absolut të Rregulluesve), një tarifë bashkërendimi prej [●] euro (€ [●]) që përfaqëson 2.00% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit B, sipas Marrëveshjes; dhe

b) Për llogari të Huadhënësve të Shërbimit B me bazë proporcionale, në përputhje me Detyrimet Financiare të Shërbimit B, një tarifë e siguruar prej [•] euro (€ [•]) që përfaqëson 0.75% të shumës së përgjithshme të Detyrimeve Financiare të Shërbimit B, sipas Marrëveshjes.

7. Dëshmi nga ana juaj për të përmbushur tërësisht kushtet e kësaj letre do të përbëjë një Ngjarje të mosplotësimi të Detyrimeve sipas Marrëveshjes.

8. Ju lutem konfirmoni miratimin tuaj sa më sipër, duke kundërfirmosur dhe duke na kthyer kopjen e bashkëlidhur të kësaj letre.

9. Kjo letër rregullohet nga dhe do të interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

Me respekt

.....

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

ALPHA BANK A.E.

Si Rregulluesi

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

ALPHA BANK A.E, DEGA E LONDRËS

Si Agjenti

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

DEUTSCHE BANK A.G, DEGA E LONDRËS

Si Arranger

Datë: 2009

Ne konfirmojmë marrjen e kësaj letre dhe biem dakord plotësisht me termat dhe kushtet e parashtruara më sipër.

.....

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave,

Duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave)

si Huamarrësi

Datë 2009

Për Republikën e Shqipërisë

Ministria e Financave

Të nderuar zotërinj:

[•] 2009

Letër tarifore

1. Kjo letër është shtojcë e marrëveshjes së shërbimeve të datës [•] 2009 (Marrëveshja) të lidhur ndërmjet (i) Republikës së Shqipërisë (të përfaqësuar nga Këshilli i saj i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) si huamarrës (Huamarrësi), (ii) Alpha Bank A.E. dhe Deutsche Bank AG, Dega e Londrës si rregullues kryesor të mandatuar (në këtë cilësi rregulluesit dhe rregulluesi nënkupton secilën prej tyre), (iii) bankat dhe institucionet financiare të përmendura në grafikun 1 të këtij dokumenti si huadhënës (së bashku, të referuar si Huadhënësi) dhe (iv) Alpha Bank A.E., Dega e Londrës si agjent (në këtë cilësi, Agjenti), sipas së cilës Huadhënësit kanë rënë dakord (ndër të tjera) për të dhënë një paradhënie me anë të huasë Huamarrësit, në bazë të termave dhe kushteve në përmbajtje të saj, shumën e principalit deri në dyqind e pesëdhjetë milionë euro (€250,000,000). Kjo letër është një prej letrave tarifore të përmendura në marrëveshje.

2. Fjalët dhe shprehjet e përkufizuara në marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe ose nëse nuk përkufizohen ndryshe në të, do të kenë të njëjtat kuptime kur nuk përdoren në këtë letër.

3. Huamarrësi do t'i paguajë Agjentit një tarifë përfaqësimi prej [•] euro (€ [•]) në vit në datën e parë të shfrytëzimit dhe në çdo përvjetor të saj derisa të gjitha paratë që detyrohen sipas Marrëveshjes të jenë paguar plotësisht.

Kjo tarifë është tarifa e përfaqësimit e përmendur në klauzolën (11.3) të Marrëveshjes dhe do të jetë e pakthyeshme.

4. Dështimi nga ana juaj për të përmbushur tërësisht kushtet e kësaj letre do të përbëjë një Ngjarje të Mosplotësimit të Detyrimeve sipas marrëveshjes.

5. Ju lutem konfirmoni miratimin tuaj sa më sipër, duke kundërfirmosur dhe duke na kthyer kopjen e bashkëlidhur të kësaj letre.

6. Letra rregullohet dhe do të interpretohet në pajtim me ligjin anglez.

Me respekt

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

ALPHA BANK A.E, DEGA E LONDRËS

Si Agjente

Datë: 2009

Ne konfirmojmë marrjen e kësaj letre dhe biem dakord tërësisht me termat dhe kushtet e parashtruara më sipër.

.....

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave,

Duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave)

si Huamarrësi

Datë 2009

Për Republikën e Shqipërisë

Ministria e Financave

Të nderuar zotërinj

[•] 2009

Shërbimi i Huasë €250 m për Republikën e Shqipërisë- Kushtet Tregtare

1 Ne i referohemi:

a) Dokumentit përkatës të datës 10 mars 2009 (që mban gjithashtu datën 4 mars 2009 në shkresën përcjellëse të nënshkruar nga Ministri i Financave) të bërë ndërmjet Alpha Bank A.Edhe Deutsche Bank AG, Dega e Londrës si rregulluesit kryesorë të manaduar dhe juve, si huamarrës; dhe

b) Projekt marrëveshjes së Shërbimeve (Marrëveshja) që duhet të lidhet, ndër të tjera, ndërmjet (i) Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave) si huamarrës (Huamarrësi), (ii) Alpha Bank A.E. dhe Deutsche Bank AG, Dega e Londrës si rregullues (iii) Alpha Bank A.E., Dega e Londrës si agent (në këtë cilësi si Agjenti), në lidhje me shërbimet e huasë deri në dyqind e pesëdhjetë milionë euro (€250 000 000).

2. Pas diskutimeve tona të deritanishme dhe për lehtësinë tuaj, duke marrë në konsideratë negocimin e ardhshme të marrëveshjes dhe sigurimit të shërbimeve, do të dëshëronim të përmbledhnim këtu disa nga kushtet financiare që propozohen të zbatohen për shërbimet e mësipërme.

a) Shuma e shërbimit (që është shuma e panënshkruar e shërbimit, koncepti i propozuar:

deri në €250 000 000

b) Marzhi

9,65% në vit

c) Tarifa e rregullimit

2.00% mbi shumat e shërbimeve të përgjithshme të kryera, qoftë nëse detyrimet financiare ndodhin në një ose më shumë transhe së bashku ose tërthorazi.

d) Tarifa e bashkërendimit (në vënd të tarifës së rregullimit nëse nuk ka asnjë shfrytëzim brenda një muaji nga nënshkrimi.

2.00% mbi shumat e shërbimeve të përgjithshme të kryera, qoftë nëse detyrimet financiare ndodhin në një ose më shumë transhe së bashku ose tërthorazi.

e) Tarifa reale e siguruar

0.75% mbi shumën e përgjithshme të detyrimit financiar të secilit pjesëmarrës, qoftë nëse detyrimet financiare ndodhin në një ose më shumë transhe së bashku ose tërthorazi

3. Kjo letër rregullohet nga dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin anglez

Me respekt

.....

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

ALPHA BANK A.E.

Si Rregulluesi

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

DEUTSCHE BANK A.G, DEGA E LONDRËS

Si Rregullues

Datë: 2009

Ne konfirmojmë marrjen e kësaj letrë dhe biem dakord plotësisht me termat dhe kushtet e parashtruara më sipër.

.....

Nënshkruar nga:

Për dhe në emër të

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave,

Duke vepruar nëpërmjet Ministrit të tij të Financave)

si Huamarrësi

Datë 2009

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.**

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 14.5.2009
Doli nga shtypi më 14.5.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADELPRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 60 lekë